



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT
(Përfundimtar)**

PËR

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË LIDHJE ME PROCESIN E DEKLARIMIT TË
STATUSIT TË PUNËSIMIT TË PUNONJËSVE QË U GJENDËN NË POZICIONE
PUNE PJESË E SHËRBIMIT CIVIL NË DATËN 26.2.2014**

Bashkia e Tiranës dhe Komunat, aktualisht njësi administrative, në përbërje të saj:

***(Bashkia Tiranë, Njësitë Administrative Petrelë, Farkë, Dajt, Zall-Bastar, Bërzhitë, Krrabë,
Baldushk, Shëngjergj, Vaqarr, Kashar, Pezë, Ndroq dhe Zall-Herr)***

Tiranë, Prill 2017

RAPORT

Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve civilë të institucionit, Bashkia e Tiranës.

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, me vendimin nr. 88, datë 04.09.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia e Tiranës”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes tematike në institucionin e Bashkisë së Tiranës.

Për shkak të riorganizimit të organeve të qeverisjes vendore, të cilat janë konstituuar pas zgjedhjeve të vitit 2015, organizimi dhe funksionimi i tyre realizohet duke u bazuar në ndarjen e përcaktuar në ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Në rastin konkret, shtrirja territoriale e Bashkisë së Tiranës, si organ i qeverisjes vendore, përfshin edhe njësi vendore të organizuara më parë si njësi të pavarura të qeverisjes vendore (Komuna), të tilla si, Komuna Petrelë, Komuna Farkë, Komuna Dajt, Komuna Zall-Bastar, Komuna Bërzhitë, Komuna Krrabë, Komuna Baldushk, Komuna Shëngjergj, Komuna Vaqarr, Komuna Kashar, Komuna Pezë, Komuna Ndroq dhe Komuna Zall-Herr, të cilat, në bazë të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, do të jenë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë së Tiranës.

Në vendimin nr. 510, datë 10.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, kreu III, “Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve”, pika 1, përcaktohet se, bashkia është trashëgimtari ligjor i njërive të qeverisjes vendore që janë shkrire në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njërive të qeverisjes vendore që janë shkrire. Më tej, në kreun IV të këtij akti nënligjor, “Transferimi i personelit”, parashikohet se marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njërive që janë shkrire dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj.

Në këto rrethana, kryerja e mbikëqyrjes në këtë institucion, me objekt plotësimin e kushteve ligjore të statusit të punësimit, të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 116, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, është shtrirë edhe në njësitë administrative, pjesë përbërëse të strukturës së institucionit, Bashkia e Tiranës.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua sipas Programit të Mbikëqyrjes nr. 615/1 prot., datë 04.09.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 615/2 prot., datë 04.09.2015 “*Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes*”, i është njoftuar Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

Institucioni i mbikëqyrur, me shkresën nr. 12149/1 prot., datë 14.09.2015 “*Kërkesë për shtyrje të fillimit të mbikëqyrjes*”, kërkoi shtyrjen e afatit për fillimin e procesit të mbikëqyrjes, për shkak të ngarkesës së punës, që kishin në këtë moment dhe në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 615/4 prot., dt. 15.09.2015, Komisioneri njoftoi institucionin për miratimin e shtyrjes së afatit, duke caktuar si moment të fillimit të procesit, datën 21.09.2015, e cila shënon edhe kohën reale të fillimit të mbikëqyrjes.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është tematik dhe përfshin verifikimin e procesit të deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve, të cilët, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kanë qenë të punësuar në pozicione pune që përfshihen në fushën e shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes, në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Bashkinë e Tiranës gjatë zbatimit të institutit të deklarimit të statusit të punësimit, duke përfshirë njëkohësisht edhe Njësitë Administrative Petrelë, Farkë, Dajt, Zall-Bastar, Bërzhitë, Krrabë, Baldushk, Shëngjergj, Vaqarr, Kashar, Pezë, Ndroq dhe Zall-Herr, që aktualisht janë pjesë e kësaj bashkie.

Me shkresën nr. 615/6 prot., datë 09.06.2016 të Komisionerit, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 30 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Subjekti i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 34576 prot., datë 14.11.2016, “*Kthim përgjigje*”, njofton Komisionerin për masat e marra në zbatim të rekomandimeve të bëra nga grupi i mbikëqyrjes, duke mos paraqitur vërejtje lidhur me gjetjet e trajtuara në pjesët respektive të projektraportit. Nga ana e Komisionerit u analizua përmbajtja e këtij materiali, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes dhe qëndrimi në lidhje me të, është materializuar në pjesët përkatëse të raportit.

Në këto rrethana, duke u konsideruar si e plotësuar kërkesa për zbatimin e procedurës në këtë proces, u hartua edhe raporti përfundimtar i mbikëqyrjes.

✓ **Qëllimi i mbikëqyrjes:**

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.

- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

✓ **Objekti i mbikëqyrjes**

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:

- Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përkrahimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion.
- Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit Civil", apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit.
- Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese, ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune.
- Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës me institucionin.
- Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve, në përputhje me kërkesat specifike të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë këtë institut të ligjit.
- Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklaramit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, e aspekte të tjera, në përputhje me kërkesat ligjore specifike.

3. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

✓ **Metodologjia e mbikëqyrjes**

Për realizimin e kësaj mbikëqyrje, si për institucionin Bashkia e Tiranës ashtu edhe për Njësitë Administrative, është zgjedhur si metodë pune verifikimi në institucion i dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht, u realizua një takim me Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse, ***** , gjatë të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u

ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim.

- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës së Bashkisë së Tiranës, si dhe për të gjitha Njësitë Administrative që janë pjesë përbërëse e saj.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe dosjet individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme që duhet të përmbushin nëpunësit për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës, si niveli arsimor, përvoja në punë, etj.
- U administrua dokumentacioni i kërkuar, ku përfshihen listë prezencat e punonjësve për periudhën *shkurt 2014* dhe për periudhën *Gusht 2015*, si dhe evidenca e punonjësve, që njësitë administrative kanë dorëzuar pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë së Tiranës.
- U verifikuan aktet e deklaramit të statusit të nëpunësit civil për të gjithë nëpunësit e bashkisë dhe të njërive administrative, të lëshuara nga njësia përgjegjëse.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete (*Aneksi nr.1 dhe Aneksi nr.2*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti.

✓ **Përmbajtja e raportit:**

I. Si është kuptuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me procesin e deklaramit të statusit të punësimin.

a) Struktura organizative e Bashkisë së Tiranës, në datën e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendos rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij.

Në nenin 2 të këtij ligji, përcaktohet fusha e veprimit të tij, e cila përfshin çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore. Më tej, në mënyrë specifike, ky përkufizim detajohet në nenin 4, të ligjit në fjalë, ku përcaktohen në mënyrë të shprehur edhe mënyra se si e kryen funksionin e tij nëpunësi civil.

Institucioni i Bashkisë është krijuar dhe funksionon mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, i cili e përcakton atë, si njësi bazë të qeverisjes vendore, e si i tillë, ky subjekt përfshihet në fushën e shërbimit civil.

Nga analiza dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se, në datën e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (në dt. 26.02.2014), aparati i Bashkisë së Tiranës funksiononte në bazë të strukturës organizative të miratuar me vendimin nr. 8, datë 12.10.2011 të Këshillit Bashkiak Tiranë, “Për miratimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës”, të ndryshuar. (Ndryshuar me vendimin nr. 54,

datë 24.12.2012, të Këshillit Bashkiak Tiranë. - Ndryshuar me vendimin nr. 38, datë 18.11.2013, të Këshillit Bashkiak Tiranë).

Bazuar në këto akte, Këshilli Bashkiak Tiranë, për kryerjen e funksioneve administrative të institucionit ka miratuar numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, **617** punonjës gjithsej.

Në mënyrë të detajuar janë miratuar: Aparati i bashkisë **508** punonjës, Qendra e Rregjistrimit dhe Liçensimit **4** punonjës, Njësia e Menaxhimit të Projekteve **7** punonjës, Gjendja Civile **3** punonjës dhe Inspektoriati Ndërtimor e Urbanistik **95** punonjës.

Bazuar në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neni 4, shkronja "f" njësia e burimeve njerëzore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, paraqitet si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur. Ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij e ngarkojnë njësinë përgjegjëse me disa detyra dhe përgjegjësi nga ky ligj apo në bazë të tij.

Një nga detyrat që ligji i ngarkon njësisë përgjegjëse është deklarimi i statusit të punësimit për të gjithë nëpunësit dhe punonjësit të cilët në datën e shtrirjes së efekteve të ligjit ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, (neni 67, pika 6 e ligjit dhe kreu II, pika 2 e vendimit nr. 116, dt. 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar).

b) Pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se, sipas strukturës dhe organikës në fuqi institucioni i mbikëqyrur kishte **617** vende pune gjithsej, nga të cilat **469** prej tyre, janë konsideruar si pjesë e shërbimit civil dhe **148** pozicione pune, nuk janë konsideruar si të tilla, por janë vlerësuar si punonjës për të cilët marrëdhëniet e tyre të punësimit rregullohen me Kodin e Punës, sipas ligjit specifik, si dhe punonjës me funksione të natyrës ndihmëse administrative.

Më konkretisht, nuk janë konsideruar si pjesë e shërbimit civil:

- ✓ **95** vende pune që i përkasin njësisë organizative me emërtesën "Inspektoriati Ndërtimor e Urbanistik";
- ✓ **3** pozicione pune të Gjendjes Civile;
- ✓ **4** pozicione pune të Qendrës së Regjistrimit dhe Liçensimit, si funksion i deleguar; dhe,
- ✓ **46** pozicione pune të aparatit të bashkisë, nga të cilët **11** pozicione janë funksionarë politikë dhe **35** janë punonjës administrativë.

Pozicionet pjesë e shërbimit civil (**469**), klasifikohen në këtë mënyrë:

- **1** pozicion pune me emërtesën "Administrator i Përgjithshëm"
- **5** pozicione pune me emërtesën "Drejtore të Përgjithshme"
- **30** pozicione pune me emërtesën "Drejtore të Drejtorie"
- **80** pozicione pune me emërtesën "Përgjegjës sektori"
- **4** pozicione pune me emërtesën "Kryeinspektor"
- **6** pozicione pune me emërtesën "Përgjegjës zyre"
- **8** pozicione pune me emërtesën "Inspektor"
- **335** pozicione pune me emërtesën "Specialist".

Ashtu si e pasqyruam edhe më sipër, 4 pozicione pune të Qendrës së Regjistrimit dhe Liçensimit, megjithëse i përkasin aparatit të bashkisë, nuk janë konsideruar pjesë e shërbimit civil.

Ky përfundim është arritur për faktin se, nga verifikimi dhe shqyrtimi i strukturës organizative u konstatua se, njësia organizative me emërtesën “*Qendra e Regjistrimit dhe Liçensimit*”, është pjesë e aparatit të bashkisë dhe ka 9 pozicione pune të miratuara si organikë e bashkisë dhe 4 pozicione pune, si funksione të deleguara. Në lidhje me 9 punonjësit që i përkasin strukturës së bashkisë, njësia përgjegjëse ka bërë një ndarje ku, 5 prej tyre i emërton “*specialistë zyre*”, duke i konsideruar pjesë e shërbimit civil, ndërsa 4 punonjës të tjerë, i specifikon si “*punonjës sporteli*” dhe nuk i konsideron pjesë e shërbimit civil.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, struktura dhe organika në fuqi në momentin e mbikëqyrjes, në ndarjen ku pasqyrohet organizimi i Qendrës së Regjistrimit dhe Liçensimit nuk i evidenton ndarjet në pozicionet si “*Specialist liçensues*”/(*specialist zyre*) dhe “*Specialist regjistrues*”/(*punonjës sporteli*).

Po kështu, edhe rregullorja e institucionit në pikën 36.2.5, ku përcaktohet misioni dhe detyrat e Qendrës së Regjistrimit dhe Liçensimit, nuk parashikon detyra dhe përgjegjësi të veçuara për pozicione si “*Specialist liçensues*” dhe “*Specialist regjistrues*”, por kjo njësi organizative paraqitet si njësi unike dhe të gjithë specialistët kanë të njëjtat detyra dhe përgjegjësi.

Më tej, u verifikuan edhe përshkrimet e punës dhe konstatohet se, për pesë pozicionet e Qendrës së Regjistrimit dhe Liçensimit, të cilët njësia përgjegjëse i konsideron si pozicione të shërbimit civil, nuk janë hartuar përshkrimet e punës, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Duke marrë shkak nga gjithë sa parashtruam më sipër, njësia përgjegjëse e institucionit duhet të ketë parasysh që:

- Ndarja e pozicioneve të shërbimit civil nga pozicionet e punës ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil, duhet të bëhet e qartë që në përmbajtjen e strukturës dhe organikës së institucionit dhe më tej, ky dallim pasqyrohet në emërtesat e pozicioneve të punës, rregulloren e brendshme të institucionit dhe në përshkrimet e punës.
- Njësia përgjegjëse, bazuar në legjislacionin specifik të fushës, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë që realizojnë punonjësit e Qendrës së Regjistrimit dhe Liçensimit, të rivlerësojë situatën e tyre në raport me shërbimin civil.
- Njësia përgjegjëse, të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të reja të punës, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës, apo formatin standard të miratuar, siç përcaktohet në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar si dhe në udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të

Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, paraqiten në këtë raport:

Nr.	Pozicionet e shërbimit civil të klasifikuara sipas kategorisë dhe klasës	Emërtesa e pozicionit të punës sipas strukturës së miratuar	Numri i pozicioneve të punës sipas kategorisë dhe klasës
1	Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese	Administrator i Përgjithshëm Drejtor Drejtorie të Përgjithshme	1 5 <i>Ky grupim përbën 1.3 % të pozicioneve të shërbimit civil.</i>
2	Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese	Drejtor drejtorie	30 <i>Ky grupim përbën 6.3 % të pozicioneve të shërbimit civil.</i>
3	Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese	Përgjegjës Sektori Kryeinspektor Përgjegjës Zyre	80 4 6 <i>Ky grupim përbën 19.2 % të pozicioneve të shërbimit civil.</i>
4	Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive	Specialist Inspektorë	335 * 8 <i>Ky grupim përbën 73.2 % të pozicioneve të shërbimit civil.</i>
	Pozicione të shërbimit civil gjithsej		469 *

* Në numrin e nëpunësve civil me emërtesën “Specialist” dhe në numrin e përgjithshëm të pozicioneve të shërbimit civil nuk janë përfshirë 4 pozicionet e punës “Specialist” në Qendrën e Regjistrimit dhe Liçensimit, të cilat njësia përgjegjëse nuk i konsideron pjesë e shërbimit civil.

c) Nëpunës të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil, në datën e fillimit të efekteve të ligjit, procedura e ndjekur për punësimin e tyre.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, janë verifikuar dhe analizuar të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet e shërbimit civil, si struktura dhe organika e institucionit që ishte në fuqi në dt. 26.02.2014, listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve për muajin shkurt 2014; dosjet individuale për çdo punonjës të punësuar në pozicione të shërbimit civil (aktet e emërimit si dhe të dhënat lidhur me nivelin e diplomës dhe profilin e arsimit të lartë), si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Nga verifikimi i kryer rezultoi se:

Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, në datën 26.02.2014, Bashkia e Tiranës kishte **469** pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil ku, **458** prej tyre ishin të plotësuar dhe **11** pozicione të shërbimit civil ishin vende të lira.

Më konkretisht, në këtë moment, pozicione të shërbimit civil, vende të lira ishin:

- *Specialist në Sektorin e Shërbimit të Investitorëve, në Drejtorinë e Promovimit të Investimeve të Huaja, në Drejtorinë e Përgjithshme të Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja.*

- *Specialist në Sektorin e Planeve Vendore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.*
- *Specialist në Sektorin e Planeve të Detajuara Vendore, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.*
- *Specialist në Sektorin e Transportit Urban në Drejtorinë e Transportit dhe Lëvizshmërisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve.*
- *Specialist në Sektorin e Rrjetit Rrugor në Drejtorinë e Transportit dhe Lëvizshmërisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve.*
- *Specialist në Qendrën e Kontrollit të Trafikut, në Drejtorinë e Transportit dhe Lëvizshmërisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve.*
- *Specialist në Sektorin e Shërbimit Social, në Drejtorinë e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve.*
- *Specialist në Sektorin e Raportimit, Auditimit & Kontrollit të Sistemeve, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit.*
- *Specialist në Sektorin e Infrastrukturës TIK, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit.*
- *Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës dhe Pajisjeve, në Drejtorinë e Prokurimeve.*
- *Specialist në Sektorin e Shërbimeve dhe Mallrave, në Drejtorinë e Prokurimeve.*

Në momentin e mbikëqyrjes konstatohet se, **10** nga këto pozicione pune, janë të plotësuar (2 pozicione janë plotësuar nëpërmjet transferimit të përhershëm të dy nëpunësve brenda institucionit, 1 pozicion është plotësuar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë të një nëpunësi brenda institucionit dhe 8 pozicione janë plotësuar nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive). Ndërsa 1 pozicion pune vazhdon të jetë vend i lirë.

Për të arritur në një konkluzion lidhur me procedurat e ndjekura për marrjen në punë të **458** punonjësve, që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, ishin të punësuar në pozicione pune të shërbimit civil, për secilin punonjës u verifikuan aktet e emërimit, për të vërtetuar fillimin e marrëdhënies së punës me institucionin. Duke iu referuar procedurës së ndjekur për marrjen në punë, (të rekrutuar sipas procedurave konkurruese, të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, apo me akt emërimi të thjeshtë të nxjerrë nga drejtuesi i institucionit), konstatohet se:

- **278** nëpunës civilë ekzistues, ishin të rekrutuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil” që përbëjnë **61%** të të punësuarve në pozicione të shërbimit civil. Nëpunësit e këtij grupi, në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:
 - **33** nëpunës, ishin nëpunës ekzistues sipas përcaktimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, (ligji për shërbimin civil i mëparshëm).
 - **178** nëpunës ishin të emëruar nëpërmjet procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
 - **Për 66** nëpunës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, procedurat e konkurrimit ishin në proces. Në mbështetje të pikës 2, të nenit 68, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e cila parashikon se: “Çdo

procedurë tjetër në proces, nisur përpara shtrirjes së efekteve të këtij ligji, do të përfundohet sipas dispozitave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", në këtë rast, aktet e emërimit në shërbimin civil kanë dalë pas datës 26.02.2014, pra pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013.

- ***1** nëpunës civilë ekzistues, është i punësuar me transferim nga lista e pritjes e Departamentit të Administratës Publike. (Lista e pritjes e Ministrisë së Financave, shkresa nr. 405/3 prot., dt. 06.02.2014, e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, ku ky institucion shpreh dakordësinë për transferimin e detyrueshëm të nëpunëses, *****).*
- **180** punonjës ekzistues, janë të punësuar me akt emërimi të thjeshtë, të nxjerrë nga drejtuesi i institucionit. Këta punonjës përbëjnë **39 %** të të punësuarve në pozicione të shërbimit civil.

Duke parë të dhënat e evidentuara si më sipër, arrihet në konkluzionin se:

- Institucioni i mbikëqyrur ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*", por në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të ri, **39 %** e të punësuarve në pozicione të shërbimit civil, nuk ishin të rekrutuar sipas procedurave konkurruese të përcaktuara nga ky ligj.
- Gjithashtu, edhe për nëpunësit të cilët ishin të rekrutuar nëpërmjet konkurrimit konstatohet se, në shumicën e rasteve fillimisht janë punësuar me kontratë pune dhe më pas janë realizuar procedurat e konkurrimit, ku ata kanë fituar përsëri.
- Njësia e burimeve njerëzore, për shkak të moszbatimit të procedurave të pranimit, të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*", i cili ishte ligji i zbatueshëm për institucionin e qeverisjes vendore të mbikëqyrur, ka lejuar një situatë paligjshmërie lidhur me menaxhimin e shërbimit civil.
- Punonjësit e rekrutuar në kundërshtim me ligjin, nëpërmjet urdhërit të titullarit, nuk mund të përfitonin nga statusi i nëpunësit civil, apo të zhvillonin karrierën dhe nuk mund mbroheshin nga ligji i nëpunësit civil, pasi ishin të rekrutuar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga ky ligj.
- Në pikën 3, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar përcaktohet se: "*Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civil*".

Një grup punonjësish nuk kanë përfituar nga parashikimet e kësaj dispozite, pasi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, procedurat e konkurrimit sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*", ishin të papërfunduara, dhe periudha e punësimit iu është llogaritur nga data e emërimit me konkurrim, dhe për këtë arsye, pavarësisht periudhës faktike të punësimit që ishte më shumë se një vit, ata janë deklaruar "*Nëpunës civil në periudhë prove*".

(Të gjithë nëpunësit (458), që në dt. 26.02.2014 ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, si dhe procedurat e ndjekura për punësimin e tyre, janë pasqyruar në tabelën **Aneks nr. 1**: “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij).

II. Procedurat e ndjekura nga njësia përgjegjëse, për nxjerrjen e aktit të deklarimit të statusit të punësimit për çdo nëpunës që kryente funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nisur nga fakti që institucioni i mbikëqyrur është pjesë e shërbimit civil, deklarimi i statusit të punësimit “Nëpunës civil” apo “Nëpunës civil në periudhë prove”, për shkak të ligjit, për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- (pika 3), “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;
- (pika 4), “Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;
- (pika 6), “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.

Po kështu, vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, kreu II “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, pika 1, parashikon: “Nëpunës civilë”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Dispozitat e sipërpërmendura, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarimin e statusit të punësimit, pas verifikimit të procedurës së punësimit, për të gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarimin e statusit të punësimit, gjatë procesit të kontrollit u këqyren të gjitha materialet shkruese që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet e shërbimit civil, si organigrama dhe struktura e institucionit, që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit; listëprezenca dhe listëpagesa e

punonjësve për muajin shkurt 2014; dokumentacioni i plotë që vërteton procedurën e marrjes në punë, përfshirë aktin e emërimit me konkurrim apo aktin e emërimit me urdhër të titullarit; librezën e punës, si dokument që vërteton kohëzgjatjen e punësimit, si dhe të dhënat profesionale dhe çdo të dhënë tjetër lidhur me marrëdhëniet e punës në shërbimin civil.

Nga trajtimi dhe analiza e këtij dokumentacioni konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ashtu siç është përmendur edhe më sipër, subjekti i kontrolluar kishte 469 pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, ku 458 prej tyre ishin të zëna dhe 11 ishin vende të lira. Në procedurat e verifikimit e të deklarimit të statusit të punësimit janë përfshirë 436 punonjës ekzistues, ose e thënë ndryshe 95% e punonjësve të cilët ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil.

Pas kryerjes së këtyre verifikimeve, përgjatë muajit qershor 2014 njësia përgjegjëse ka konkluduar me nxjerrjen e akteve të deklarimit të statusit të punësimit, si më poshtë:

- 201 punonjës dhe nëpunës aktualë, janë deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil”.
- 227 punonjës dhe nëpunës aktualë, janë deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”.
- Për 8 punonjës dhe nëpunës aktualë, njësia përgjegjëse nuk e ka lëshuar aktin e deklarimit të statusit të punësimit me arsyetimin se nuk plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë.
- Ndërsa 22 punonjës, ose 5% e punonjësve, të cilët në datën e fillimit të efekteve të ligjit kryenin funksione të shërbimit civil, nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

a) Nëpunës civilë ekzistues dhe punonjës ekzistues të deklaruar “Nëpunës civil” për shkak të ligjit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për 201 punonjësit dhe nëpunësit aktualë, të cilët janë deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil”, vëmë re se:

- Për 197 punonjës dhe nëpunës të deklaruar me statusin “Nëpunës civil”, procedurat e deklarimit të statusit të punësimit janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në këtë grup përfshihen “nëpunës civilë ekzistues” dhe “punonjës ekzistues”, të cilët në dt. 26.02.2014, ishin të punësuar në të njëjtin vend pune, të konsideruar pjesë e shërbimit civil, për një periudhë më shumë se një vit.

Në momentin e verifikimit të kryer në subjekt, gjatë mbikëqyrjes, është konstatuar se për 4 punonjës, njësia përgjegjëse, në procedurat e ndjekura për deklarimin e statusit të punësimit, nuk ka respektuar kërkesat e ligjit. Më konkretisht këta punonjës janë:

- Punonjësja ******, me aktin nr. 392, dt. 11.06.2014 është deklaruar “Nëpunës civil” në pozicionin “Drejtor i Auditit”. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit u konstatua se, marrëdhënia e punësimit me këtë pozicion pune i ka filluar me urdhrin nr. 12, dt. 13.01.2014 të titullarit të institucionit. Pra, në datën

26.02.2014 kjo punonjëse ishte e punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më pak se një vit. Për këtë arsye, deklarimi i statusit të punësimit, duhet të ishte “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.

- Punonjësi ***** me aktin nr. 620, dt. 24.06.2014 është deklaruar “*Nëpunës civil*” në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit u konstatua se, marrëdhënia e punësimit me këtë pozicion pune i ka filluar me urdhrin nr. 898, dt. 06.11.2013 të titullarit të institucionit. Pra, në datën 26.02.2014 ky punonjës ishte e punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më pak se një vit. Për këtë arsye, deklarimi i statusit të punësimit, duhet të ishte “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.
- Punonjësi ***** me aktin nr. 357, dt. 11.06.2014 është deklaruar “*Nëpunës civil*” në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Turizmit dhe Promovimit të Qytetit*”, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit u konstatua se, marrëdhënia e punës në këtë pozicion, i ka filluar me urdhrin nr. 917, dt. 06.12.2013 të titullarit të institucionit. Pra punonjësi në fjalë, në datën 26.02.2014, periudhën e punësimit në të njëjtin vend pune e kishte më pak se një vit. Për këtë arsye, deklarimi i statusit të punësimit, duhet të ishte “*Nëpunës civil në periudhë prove*”. Ndërkohë, nga verifikimet e kryera rezulton se, nëpunësi ka kryer detyrimet e periudhës së provës siç është trajnimi i detyrueshëm në ASPA dhe më tej edhe institucioni e ka trajtuar atë si nëpunës civil në periudhë prove duke i bërë vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës dhe konfirmimin e tij si nëpunës civil, (*vendim konfirmimi nr. 4885/2, datë 23.04.2015*).
- Punonjësi ***** me aktin nr. 4923/1 prot., dt. 03.04.2015, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve i është deklaruar statusi “*Nëpunës civil*” në kategorinë e ulët drejtuese.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit të këtij nëpunësi, u konstatua se, në dt. 26. 02.2014 ai kryente detyrën “*Kryeinspektor*” në Drejtorinë e Auditit. Periudha e punësimit në këtë vend pune ishte më pak se një vit (*emëruar me urdhrin nr. 373, dt. 01.04.2013 të drejtuesit të institucionit*). Pra, në datën 26.02.2014, punonjësi në fjalë ishte i punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më pak se një vit. Për këtë arsye, deklarimi i statusit të punësimit, duhet të ishte “*Nëpunës civil në periudhë prove*”. Ndërkohë, nga verifikimet e kryera rezulton se, nëpunësi ka kryer detyrimet e periudhës së provës siç është trajnimi i detyrueshëm në ASPA, dhe më tej edhe institucioni e ka trajtuar atë si nëpunës civil në periudhë prove duke i bërë vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës, si dhe konfirmimin e tij si nëpunës civil, (*shkresë e eprorit direkt nr. 4923 prot., dt. 31.03.2015*).

Në lidhje me konstatimet e mësipërme, për të rregulluar ligjshmërinë në projektraportin dërguar institucionit është kërkuar që njësia përgjegjëse të kryejë këto veprime ligjore:

- Në zbatim të nenit 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, nëntitulli “*Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative*”, referuar nenit 185 të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshojë aktin nr. 392, datë 11.06.2014

për deklarimin statusit të punësimit “Nëpunës civil” për punonjësen *****; aktin nr. 620, dt. 24.06.2014 për deklarimin statusit të punësimit “Nëpunës civil” për punonjësin ***** dhe të bëjë deklarimin e statusit të punësimit për këta punonjës “Nëpunës civil në periudhë prove”.

- Njësia e burimeve njerëzore si njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji për nëpunësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASP), caktimin e një punonjësi më të vjetër për t`u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori pas përfundimit të periudhës së provës dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.
- Për punonjësin *****, në zbatim të nenit 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nëntitulli “Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative”, referuar nenit 185 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshojë aktin nr. 357, dt. 11.06.2014 për deklarimin statusit të punësimit “Nëpunës civil” duke i bërë plotësimin “Nëpunës civil në periudhë prove”.
- Për punonjësin *****, në zbatim të nenit 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nëntitulli “Ndryshimi dhe zëvendësimi i akteve administrative”, referuar nenit 185 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshojë aktin nr. 4923/1 prot., dt. 03.04.2015 “Akt konfirmimi për statusin e nëpunësit civil” duke i bërë deklarimin e statusit “Nëpunës civil në periudhë prove”.

Ndërkohë, nisur nga observacionet e dërguara nga institucioni me shkresën nr. 34576 prot., datë 14.11.2016 “Kthim përgjigje”, si dhe aktet administrative bashkëlidhur tij, dërguar nga subjekti i kontrolluar, Komisioneri konstaton se, për përmirësimin e situatës ligjore, në këtë rast, në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit ***** dhe ***** , institucioni i ka kryer veprimet administrative të nevojshme për rregullimin e momentit të konstatuar me parregullsi.

Në mënyrë më të detajuar, duke specifikuar edhe aktet konkrete që kanë dalë për të rivendosur ligjshmërinë, konstatohet se:

- Me aktin nr. 33162 prot., dt. 01.11.2016 “Për revokim të aktit të deklarimit të statusit si nëpunës civil”, është vendosur revokimi i aktit nr. 620, dt. 24.06.2014 për deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civil dhe deklarimi i punonjësit ***** , nëpunës civil në periudhë prove.
- Me aktin nr. 33161 prot., dt. 01.11.2016 “Për revokim të aktit të deklarimit të statusit si nëpunës civil”, është vendosur revokimi i aktit nr. 357, dt. 11.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civil dhe deklarimi i punonjësit ***** , nëpunës civil në periudhë prove.
- Me aktin nr. 33176 prot., dt. 01.11.2016 “Për revokim të aktit “Deklarim të statusit si si nëpunës civil”, është vendosur revokimi i aktit nr. 4923/1, dt. 03.04.2015 “Konfirmim për statusin si nëpunës civil”, dhe deklarimi i punonjësit ***** , nëpunës civil në periudhë prove.

Ndërkohë, gjatë procesit të mbikëqyrjes, në momentin e përgatitjes së raporti përfundimtar, rezultojnë se: punonjësi ***** me aktin nr. 17639/1, dt. 24.11.2015, është liruar nga shërbimi civil, si rezultat i ristrukturimit të institucionit; punonjësi ***** me aktin nr. 17804/3, dt. 24.11.2015, është liruar nga shërbimi civil si rezultat i ristrukturimit të institucionit; punonjësi ***** me aktin nr. 17815/3, dt. 24.11.2015, është liruar nga shërbimi civil, si rezultat i ristrukturimit të institucionit; punonjësja ***** me aktin nr. 22377, datë 19.07.2016, ka përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil nëpërmjet largimit nga shërbimi civil, si masë disiplinore. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, në këto raste, është bërë mbështetur në parashikimet e nenit 66, pika 1, shkronja a/1 dhe nenit 63 shkronja "b" të ligjit.

Për shkak të numrit të madh të personelit, që ka struktura dhe organika e Bashkisë së Tiranës, aktet e deklaramit të statusit të punësimit si "*Nëpunës civil*", të nxjerra në mbështetje të kërkesave të nenit 67, pika 3 dhe 4, për të gjithë ata nëpunës, që në momentin e mbikëqyrjes vazhdojnë marrëdhëniet e punës me institucionin, nuk janë paraqitur nominalisht në këtë rubrikë të raportit, por janë materializuar në tabelën nr. 1.1 "*Nëpunës të deklaruar me statusin e punësimit "Nëpunës civil"*". Tabela i bashkëlidhet raportit, si pjesë e tij.

b) Nëpunës civilë ekzistues dhe punonjës ekzistues të deklaruar "Nëpunës civil në periudhë prove", për shkak të ligjit.

Nga verifikimet e kryera rezultojnë se **227 punonjës dhe nëpunës aktualë**, njëzia përgjegjëse i ka deklaruar me statusin e punësimit "*Nëpunës civil në periudhë prove*".

- Për **226** punonjës të deklaruar me statusin "*Nëpunës civil në periudhë prove*", procedurat e deklaramit të statusit të punësimit janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.

Në këtë grup përfshihen "*nëpunës civilë ekzistues*" dhe "*punonjës ekzistues*", të cilët në dt. 26.02.2014, ishin të punësuar në të njëjtin vend pune, pjesë e shërbimit civil, për një periudhë më pak se një vit.

Ndërkohë, konstatohet se në **1 rast**, njëzia e burimeve njerëzore nuk ka respektuar kërkesat e ligjit. Më konkretisht, rezultojnë se, për 1 punonjës, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit kishte dalë urdhri i titullarit të institucionit "*Për emërim në detyrë*" ndërsa, marrëdhëniet faktike dhe ajo financiare me pozicionin e punës, ka filluar pas hyrjes në fuqi të ligjit. Bëhet fjalë për punonjësen ***** e cila me aktin nr. 392/1, dt. 11.06.2014 është deklaruar me statusin e punësimit "*Nëpunës civil në periudhë prove*" në pozicionin "*Inspektor në Drejtorinë e Auditit*". Nga këqyrja e akteve konstatohet se, për këtë punonjëse urdhri i titullarit të institucionit "*Për emërim në detyrë*" ka dalë në dt. 19.02.2014 (urdhër nr. 91/1, dt. 19.02.2014), ndërsa marrëdhëniet faktike dhe ajo financiare me pozicionin e punës i ka filluar në dt. 24.03.2014.

Punonjësen në fjalë, data 26.02.2014, që është edhe data e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, nuk e ka gjetur realisht në pozicionin "*Inspektor në Drejtorinë e Auditit*". Ky konstatim mbështetet në faktin që, pavarësisht se urdhri "*Për emërim në detyrë*" ka dalë në datën 19.02.2014, në pikën 3 të tij është përcaktuar se marrëdhëniet e punës fillon në dt. 24.03.2014. Pra vetë akti i emërimit, në pikën 3, ka parashikuar se fuqia juridike e tij, fillon pas datës në të cilën është miratuar akti. Kështu, nga data e nxjerrjes

së aktit të emërimit deri në datën e fillimit të efekteve juridike të tij është parashikuar një afat, më shumë se një muaj.

Ligji nr. 8485, dt. 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” në nenin 111, ka përcaktuar se “Aktet administrative hyjnë në fuqi nga dita e miratimit të tyre me përjashtim të rasteve kur ligji ose vetë akti i jep atij fuqi prapavepruese ose të vonuar”.

(Procedurat administrative që kanë lidhje me rastin e mësipërm kanë nisur para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Për këtë arsye mbështetur në nenin 185, të këtij Kodi këto procedura të nisura, do të vijojnë sipas dispozitave të ligjit të mëparshëm).

Për të rregulluar situatën e ligjshmërisë, në projektraportin dërguar institucionit është kërkuar që, për punonjësën ***** të revokohet akti nr. 392/1 prot., datë 11.06.2014 për deklarimin e statusit të punësimit, si “Nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Inspektor në Drejtorinë e Auditit”. Më tej, është kërkuar që pozicioni i punës të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurave të konkurrimit, të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Në observacionet e dërguara nga institucioni, konstatohet se, me aktin nr. 17825/3, dt. 24.11.2015, të drejtuesit të Bashkisë Tiranë punonjësja ***** është liruar nga shërbimi civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit. Më tej, me aktin nr. 33177, dt. 01.11.2016, institucioni ka vendosur revokimin e aktit nr. 91/1, dt. 19.02.2014, për emërimin e kësaj punonjëseje në pozicionin “Inspektor në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm” në Bashkinë e Tiranës, me arsyetimin se ky akt ka dalë në kundërshtim me ligjin. Vlerësojmë, se në këtë rast institucioni ka vepruar për përmirësimin e situatës dhe rivendosjen e ligjshmërisë.

- Verifikimi i akteve të konfirmimit për nëpunësit e deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove”.

Sipas përcaktimeve të vendimit nr. 116, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pika 2, e kreut III, “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunat”, punonjësve të rekrutuar vetëm me urdhër të titullarit dhe që e kanë periudhën e punësimit më pak se 1 vit, periudha e provës iu fillon në dt. 26.02.2014. Ndërsa sipas përcaktimeve të kreut IV, “Dispozita tranzitore”, pika 4, të aktit nënligjor të mësipërm, nëpunësve të rekrutuar sipas procedurave konkurruese të parashikuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, dhe që janë në periudhë prove, e vazhdojnë periudhën e provës sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj.

Gjatë mbikëqyrjes, u konstatua se **30** nëpunës të deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”, kanë ndërprerë marrëdhënien e punësimit me institucionin. Këta nëpunës janë trajtuar në mënyrë të detajuar në pikën IV, të raportit “Institute të ligjit të zbatuara nga momenti i fillimit të efekteve të ligjit, deri në momentin e mbikëqyrjes”.

Për nëpunësit e deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove” dhe që në momentin e mbikëqyrjes vazhdojnë marrëdhënien e punësimit me institucionin, u verifikuan aktet e konfirmimit në përfundim të periudhës së provës. Në këtë proces u konstatua se:

- Në të gjitha rastet e përfundimit të periudhës së provës, të finalizuara me vendim konfirmimi të eprorit direkt, nuk është marrë mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër.
- Në 5 raste, u konstatuan nëpunës që iu ka përfunduar periudha e provës, e cila zgjat një vit nga data e aktit të emërimit, por për këto raste nuk ka vendim të eprorit direkt në lidhje me konfirmimin e nëpunësit, zgjatjen një herë të vetme deri në 6 (*gjashtë*) muaj të periudhës së provës, apo moskonfirmimin e nëpunësit. Më konkretisht këto raste paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabelë: Raste të evidentuara me probleme gjatë periudhës së provës

Nr.	Nëpunësi në periudhë prove	Akti i deklarimit në periudhë prove, nr./dt.	Procedura e ndjekur për punësim	Shkaku i moskonfirmimit
1	***** Përgjegjës zyre, Zyra për Barazinë Gjinore	Akti nr. 473, dt. 18.06.2014	Konkurrim sipas procedurave të ligjit nr. 8549/1999. (<i>Akt emërimi nr. 235, dt. 27.03.2014</i>).	- Në dhjetor 2016, ka përfunduar trajnimin e detyrueshëm në ASPA, vlerësuar në testim me 23/26 pikë.
2	***** Specialist, Sektori i Imazhit të Qytetit	Akti nr. 579, dt. 23.06.2014	Akt i thjeshtë emërimi (<i>urdhër i titullarit nr. 871, dt. 01.10.2013</i>).	- Nuk ka përfunduar trajnimin e detyrueshëm në ASPA. (<i>Nga dt. 05.01.2016-27.12.2016, ka qenë me leje lindje</i>).
3	***** Specialist, Sektori i Zhvillimit të Projekteve	Akti nr. 613, dt. 24.06.2014	Akt i thjeshtë emërimi (<i>urdhër i titullarit nr. 880, dt. 16.10.2013</i>).	- Ka përfunduar trajnimin e detyrueshëm në ASPA me rezultatin 16/26 pikë. - Nuk ka vlerësim pune. - Nuk ka vendim konfirmimi. (<i>Me urdhrin nr. 14236/1, dt. 06.10.2015, ka përfunduar marrëdhënien e punës nëpërmjet dorëheqjes</i>).
4	***** Specialist Sektori i Standartizimit	Akti nr. 480/1, dt. 18.06.2014	Konkurrim sipas procedurave të ligjit nr. 8549/1999. (<i>Akt emërimi nr. 263, dt. 02.04.2014</i>).	- Ka përfunduar trajnimin e detyrueshëm në ASPA me rezultatin 26/26 pikë. - Vlerësimi i rezultateve në pune me notën 2. - Me shkresën nr. 36943, dt. 02.12.2016 të eprorit direkt konfirmohet nëpunës civil.
5	***** Drejtor, Drejtoria e Monitorimit të Ndërmarrjeve	Akti nr. 694, dt. 26.06.2014	Akt i thjeshtë emërimi (<i>urdhër i titullarit nr. 850, dt. 16.09.2013</i>).	- Nuk ka përfunduar trajnimin e detyrueshëm në ASPA. (<i>Me urdhrin nr. 17834, dt. 24.11.2015, është liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit</i>).

Komisioneri çmon se, në rastin e këtyre nëpunësve, eprori direkt nuk ka realizuar procedurat e parashikuara në vendimin nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, kreun V, me nëntitull “*Periudha e provës*”, pikat nga 6 deri në 12.

Në këto pika, janë përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurat që duhet të kryejë eprori direkt në përfundim të periudhës së provës. Në pikën 7 është përcaktuar në mënyrë të shprehur se eprori direkt bazuar në rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA dhe vlerësimin e rezultateve individuale në punë është i detyruar të vendosë:

- “*konfirmimin e nëpunësit civil nëse ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm në ASPA dhe është vlerësuar të paktën “kënaqshëm”*”;

- b) zgjatjen një herë të vetme deri në 6 (gjashtë) muaj të periudhës së provës, në rast të mospërfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm në ASPA, ...;
- c) moskonfirmimin e nëpunësit civil”.

Në projektraportin dërguar institucionit i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që, për nëpunësit ***** , ***** , ***** , ***** , dhe ***** , të realizojë procedurat ligjore të përcaktuara në kreun V, pikat nga 6 deri në 12 të vendimit nr. 143, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, (i shfuqizuar por që në rastin konkret ishte i zbatueshëm).

Duke parë përmbajtjen e observacioneve të dërguara nga subjekti i kontrolluar, rezulton se njësisë përgjegjëse e institucionit, në rastin e nëpunëses ***** , ka vepruar për të zbatuar rekomandimet e lëna në projektraport. Më konkretisht, për rastin në fjalë, me shkresën nr. 33673 prot., datë 04.11.2016, i është kërkuar eprorit direkt që të nxjerrë vendimin për përfundimin e periudhës së provës. Më tej, me shkresën nr. 36943, dt. 02.12.2016 të eprorit direkt, është vendosur konfirmimi nëpunës civil në pozicionin “Specialist në Sektorin e Mikroplanifikimit”, duke u përbyllur në këtë mënyrë periudha e provës për këtë punonjëse.

Punonjësja ***** , në periudhën 5 – 9 dhjetor 2016, ka përfunduar kursin e trajnimit të detyrueshëm në ASPA dhe në testimin përfundimtar është vlerësuar me 23 nga 26 pikë të mundshme. Ndërsa punonjësja ***** , nuk e ka kryer trajnimin e detyrueshëm për periudhën e provës. Përgjatë periudhës 05.01.2016 - 27.12.2016, punonjësja në fjalë ka qenë me leje lindje.

Ndërsa, punonjësit ***** dhe ***** , kanë përfunduar marrëdhëniet e punës me Bashkinë e Tiranës, pa u konfirmuar si nëpunës civil, pasi nuk kishin kryer trajnimin e detyrueshëm në ASPA, (***** , *liruar nga detyra me urdhrin nr. 14236/1, dt. 06.10.2015, me dorëheqje, dhe ***** liruar nga detyra me urdhrin nr. 17834, dt. 24.11.2015, për shkak të ristrukturimit të institucionit*).

Konkluzion: Për përmirësimin e situatës në lidhje me aktet që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për nëpunësit ***** dhe ***** , i lihet detyrë njësisë përgjegjëse që të njoftojë zyrtarisht eprorin direkt përkatës mbi detyrimin për kryerjen e procedurës së përcaktuar në pikën 7, të kreut V, me nëntitull “Periudha e provës”, të vendimit nr. 143, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, (i shfuqizuar por që në rastin konkret është i zbatueshëm sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut IX, të VKM nr. 243, dt. 18.3.2015). Në këtë rast, njoftimit drejtuar eprorit direkt, duhet t’i bashkëlidhen rezultati i testimit në përfundim të trajnimit të detyrueshëm në ASPA; vlerësimi i rezultateve individuale në punë për periudhën e provës; si dhe mendimi me shkrim i nëpunësit civil më të vjetër, nën kujdesin e të cilit ka qenë nëpunësi gjatë periudhës së provës.

Në vështrim të parashikimeve të pikës 8, të aktit nënligjor të cituar më sipër, “Mosrealizimi i procedurës së përcaktuar në pikën 7, më sipër konsiderohet “mospërmbyllje detyrë” nga eprori direkt”. Siç shihet, kuadri ligjor në këtë rast, ndër të tjera i ngarkon eprorit direkt detyrën që, në përfundim të periudhës së provës për nëpunësit në varësi të tij, të vendosë konfirmimin si nëpunës civil, zgjatjen e periudhës së provës, apo moskonfirmimin e tij. Në rastin kur eprori

direkt nuk e përmbush këtë detyrë brenda afateve të caktuara, vlerësohet si shkak për fillim të ecurisë disiplinore ndaj tij.

Për shkak të numrit të madh të personelit, që ka struktura dhe organika e Bashkisë së Tiranës, aktet e deklarimit të statusit të punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”, të nxjerra në mbështetje të kërkesave të nenit 67, pika 3 dhe 4, për të gjithë ata nëpunës, që në momentin e mbikëqyrjes vazhdojnë marrëdhëniet e punës me institucionin, nuk janë specifikuar në këtë rubrikë, por janë pasqyruar në Tabelën 1.2 “Nëpunës të deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”, e cila i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij.

c) Nëpunës, të cilëve nuk i është deklaruar statusi i punësimit për shkak të mosplotësimit të kriterit të nivelit të diplomës së arsimit të lartë.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se, për 8 punonjës, të cilët në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk e ka deklaruar statusin e punësimit, për shkak se ata nuk e plotësonin kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, për pozicionin e punës ku ata ishin të punësuar.

Sa më sipër, punonjësit e përfshirë në këtë kategori, niveli i diplomës së arsimit të lartë që ata zotëronin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, si dhe njoftimi i njësisë përgjegjëse për mosplotësimin e kriterit të nivelit të arsimit, janë evidentuar në këtë tabelë:

Tabelë: Punonjës të cilëve nuk i është deklaruar statusi i punësimit

Nr.	Nëpunësi, emër, mbiemër, detyra që kryente në dt. 26.02.2014.	Niveli i diplomës së arsimit të lartë që zotëron, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.	Njoftimi mbi mosplotësimin e kriterit të nivelit të diplomës së arsimit të lartë.	Gjendja e marrëdhënies së punësimit në momentin e mbikëqyrjes.
1	*****/Inspektor në Drejtorinë e Auditit Kategoria III-b	Diplomë “Bachelor” në “Financë-Bank”, nr. 592, dt. 19.10.2012, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti “Albanian University”	Shkresa nr. 13412 prot., dt. 08.10.2014 e DBNJSH	“Specialist” në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme, konkurrim sipas ligjit 152/2013. (Me urdhrin nr. 17818/1, dt. 24.11.2015 ka përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të ristrukturimit).
2	*****/ Specialist në Sektorin e Publikimeve Zyrtare Kategoria III-b	Diplomë “Bachelor” në “Shkenca Komunikimi”, nr. 74, dt. 12.04.2013, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, Universiteti “Kristal”	Shkresa nr. 13418 prot., dt. 08.10.2014 e DBNJSH	(Me urdhrin nr. 17791/1, dt. 24.11.2015 ka përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të ristrukturimit).
3	*****/ Përgjegjës i Sektorit të Programeve Sociale Kategoria III-a	Diplomë “Bachelor” në “Psikologji të Përgjithshme”, nr. 176, dt. 19.07.2012, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Universiteti “Albanian University” (Ka kryer Masterin në 02.07.2015)	Shkresa nr. 13405 prot., dt. 08.10.2014 e DBNJSH	(Me aktin nr.17927, dt. 12.11.2015, është transferuar Specialist në Sektorin e Programeve Sociale, kategoria e pagës III-b)
4	*****/ Specialist në Sektorin e Organizimit	Diplomë “Bachelor”, nr. 3260, dt. 26.10.2013 në “Drejtesia”, Fakulteti i	Shkresa nr. 13406 prot., dt. 08.10.2014 e DBNJSH	Me urdhrin nr. 10015/1, dt. 27.07.2015, ka përfunduar marrëdhënien e punës me

	të Aktiviteteve <i>Kategoria III-b</i>	Drejtesisë, Universiteti <i>"Kristal"</i>		dorëheqje.
5	*****/Specialist në Sektorin e Statistikave <i>Kategoria III-b</i>	Diplomë " <i>Bachelor</i> ". nr.165, dt. 10.10.2011 në " <i>Psikologji të Përgjithshme</i> ", Universiteti " <i>Albanian University</i> ". (<i>Ka kryer Master Profesional në dt. 15.10.2015</i>).	Shkresa nr. 13410 prot., dt. 08.10.2014 e DBNJSH	Me aktin nr. 17861/3, dt. 20.11.2015, është transferuar Specialist në Sektorin e Statistikave, për shkak të ristrukturimit, kategoria e pagës III-b
6	*****/Përgjegjës Sektori, Sekretaria e Këshillit Teknik <i>Kategoria III-a</i>	Diplome " <i>Bachelor</i> " në " <i>Inxhinieri Mjedisi</i> " nr.B-559, dt. 26.06.2012, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës. (<i>Ka kryer Master Profesional në dt. 08.09.2014</i>).	Shkresa nr. 13409 prot., dt. 08.10.2014 e DBNJSH	Me aktin nr. 17653, dt. 12.11.2015, është transferuar Përgjegjës në Sektorin e Politikave të Shërbimeve, kategoria e pagës III-a.
7	*****/Specialist në Sektorin e Raportimit, Auditimit & Kontrollit të Sistemeve <i>Kategoria III-b</i>	Diplomë " <i>Bachelor</i> në " <i>Inxhinieri Informatike</i> ", Universiteti i Firences, njohur nga MASH me shresën nr. 942 regj., dt.04.09.2012.	Shkresa nr. 13411 prot., dt. 08.10.2014 e DBNJSH	Me urdhrin nr. 25544, dt. 23.08.2016 ka ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak se në momentin e fillimit të efekteve juridik etë ligjit nuk plotësonte kriterin e nivelit të diplomës.
8	*****/Specialist në Sektorin e Raportimit, Auditimit & Kontrollit të Sistemeve <i>Kategoria III-b</i>	Diplomë " <i>Bachelor</i> në " <i>Inxhinieri Telekomunikacioni</i> ", Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës (<i>Vërtetim dt. 25.06.2015 se ka përfunduar Master i Shkencave</i>).	Shkresa nr. 13415 prot., dt. 08.10.2014 e DBNJSH	Me aktin nr. 19536, dt. 23.6.2016 transferohet Specialist në Sektorin e Raportimit, kategoria e pagës III-b.

Gjatë mbikëqyrjes u konstatua se në dosjen e personelit të punonjësve si më sipër, është administruar shkresa me lëndë: "*Njoftim për plotësimin e kriterit të nivelit të diplomës së kërkuar, për pozicionin tuaj të punës*". Me anë të kësaj shkrese njësia përgjegjëse njofton punonjësit se: "*Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 6.8.2014, "Për disa shtesa në vendimin nr. 116, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", brenda një afati 2 vjeçar, duhet të plotësoni kriterin e nivelit të diplomës së kërkuar për pozicionin tuaj të punës (Master Profesional)"*".

Vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave "*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"*", ka miratuar procedurat e hollësishme që do të ndiqen për deklarimin e statusit të punonjësve dhe nëpunësve aktualë. Procedurat që duhet të ndjekë njësia përgjegjëse për njësitë e qeverisjes vendore, siç janë bashkitë, janë të përcaktuara në kreun III "*Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet*". Në pikën 2 të këtij kreu, në mënyrë të shprehur është përcaktuar se:

"*DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore, apo njësia përgjegjëse, për institucionet e pavaruar, bashkitë dhe qarqet, verifikon procedurën e rekrutimit dhe lëshon për çdo nëpunës*

aktin e deklaratimit të statusit të punësimit, sipas ligjit nr. 152/2013, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi”.

Pra, në realizimin e këtij procesi, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në cilësinë e njësisë përgjegjëse të institucionit të mbikëqyrur, kishte për detyrë që:

- të verifikonte nëse nëpunësi kryente ose jo një funksion të shërbimit civil;
- të verifikonte procedurën e rekrutimit, nëse nëpunësi ishte rekrutuar ose jo, sipas procedurave konkurruese të pranimit, të parashikuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”; si dhe,
- të verifikonte periudhën e punësimit në të njëjtin vend pune nëse ishte më shumë apo më pak se një vit.

Ndërsa, për ata punonjës të bashkisë që nuk plotësojnë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, në asnjë rast të parashikuar në aktin nënligjor si më sipër, nuk është parashikuar që të vazhdojnë punën me kushtin që brenda një afati 2-vjeçar, të plotësojnë këto kritere. Kjo për faktin se punonjësit e bashkive të vendit, kanë qenë edhe më parë subjekt i ligjit për nëpunësit civilë dhe nuk kanë hyrë rishtaz në këtë fushë. Kushti për të plotësuar kriterin arsimor, është vendosur përjashtimisht, për institucionet e varësishë, në administratën shtetërore, të cilat hynë për herë të parë në fushën e veprimit të këtij ligji.

Në këto rrethana, për punonjësit e listuar më sipër, duhet të ishte vendosur përfundimi i marrëdhënies së punësimit për shkak se nuk plotësojnë kërkesat për nivelin e arsimit, për pozicionin e punës ku ata janë të emëruar.

Konstatohet se, në rastin e nëpunësve *****, **, ***, **, *****, **, **, *****, **, **, ***** dhe *****, njësisia përgjegjëse nuk ka respektuar procedurat e përcaktuara në vendimin nr. 116, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, kreu III “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”.

Vlerësohet se, punonjësit e trajtuar në këtë rast, bazuar në dokumentet që përmban dosja personale, *në momentin e fillimit të efekteve të ligjit*, nuk i plotësonin kërkesat e posaçme lidhur me nivelin e arsimit të kërkuar për pozicionin përkatës. Plotësimi i kërkesave të posaçme për pozicionin e punës, në të cilin një punonjës është i emëruar, është i renditur në listën e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, të parashikuara nga shkronja “e”, e nenit 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar .

Nga verifikimet e mëtejshme lidhur me nivelin arsimor të këtyre punonjësve u konstatua se:

- Punonjësja *****, zotëron Diplomë “Master i Shkencave” në Psikologji e Përgjithshme, me numër diplome 166, numër diplome Universitare 176, dt. 02.07.2015, lëshuar nga Universiteti “Albanian University”.
- Punonjësja *****, zotëron Diplomë “Master Profesional” në Marketing me profil “Inovacion dhe tregje strategjike”, me numër diplome 000312E, data e lëshimit 15.10.2015, lëshuar nga Universiteti European i Tiranës.

- Punonjësja *****, zotëron Diplomë “*Master Profesional*” në Inxhinieri Mjedisi me numër diplome MP-150, data e lëshimit 08.09.2014, lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës. Gjithashtu me vërtetimin datë 16.12.2016, të lëshuar nga Zyra e Studimeve dhe Studentëve e Universitetit Bujqësor të Tiranës, vërtetohet se në dt. 07.12.2016, ajo ka mbrojtur diplomën Master i Shkencave, në profilin “*Menaxhim i Ujitjes, Kullimit dhe Mekanizimit në Bujqësi*”.
- Punonjësja *****, me vërtetimin nr. 3484 prot., dt. 25.11.2015, të lëshuar nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, i Universitetit “*Albanian University*”, provon se ka përfunduar studimet e larta në programin “*Master i Shkencave*”, në “*Teknologji informacioni*”.
- Punonjësi *****, me vërtetimin e datës 11.01.2016, lëshuar nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Politeknik i Tiranës, provon se ndjek studimet, pranë këtij fakulteti në ciklin e dytë në Inxhinieri Informatike.

Bazuar në faktet e përmendura si më sipër, duke parë datën në të cilën universiteti përkatës ka lëshuar diplomën e nivelit të dytë “*Master Profesional*”/ “*Master i Shkencave*”, rezulton se këta punonjës, në momentin e fillimit të marrëdhënies së punës me Bashkinë e Tiranës, kanë qenë në kushte paligjshmërie, lidhur me plotësimin e kërkesave të posaçme për nivelin e arsimit. Institucioni i bashkisë ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, dhe ky ligj, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, parashikonin kërkesa të përgjithshme dhe të posaçme për pranimin në shërbimin civil.

Konstatohet se, në momentin e përgatitjes së raportit përfundimtar, punonjësit ***** , ***** , ***** dhe ***** , kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me institucionin, fakt i cili provohet me aktet, si më poshtë:

- ***** , ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin nr. 17818/1, dt. 24.11.2015, në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së re të institucionit.
- ***** , ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me urdhrin nr. 17791/1, dt. 24.11.2015, në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së re të institucionit.
- ***** , me urdhrin nr. 10015/1, dt. 27.07.2015, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës, nëpërmjet dorëheqjes.
- ***** , me aktin nr. 25544, dt. 23.08.2016, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me arsyetimin se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, nuk plotësonte kërkesat për nivelin e diplomës së arsimit të lartë. Çmohet se, në këtë rast, janë zbatuar rekomandimet e lëna në projektraport.
- Punonjësit ***** , ***** , ***** dhe ***** vazhdojnë marrëdhëniet e punës me institucionin.

Nisur nga përmbajtja e materialit sqarues të dërguar nga institucioni, si dhe aktet bashkëlidhur tij, rezulton se, komisioni i ristrukturimit, i ngritur në kuadër të ristrukturimit të institucionit, punonjësit në fjalë i ka trajtuar si nëpunës civil. Më tej, njësia përgjegjëse ka konkluduar me nxjerrjen e akteve individuale të transferimit, si më poshtë:

- Akti nr. 17927, dt. 12.11.2015 “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, për transferimin e punonjësës ***** në pozicionin “*Specialist në Sektorin për Barazinë Gjinore dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, kategoria e pagës III-b;

- Akti nr. 17861/3, dt. 20.11.2015 “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, për transferimin e punonjësës ***** në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Statistikave”, kategoria e pagës III-b;
- Akti nr. 17653, dt. 12.11.2015 “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit” për transferimin e punonjësës ***** në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Politikave të Shërbimeve”, kategoria e pagës III-a;
- Akti nr. 17991, dt. 12.11.2015 “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, për transferimin e punonjësës ***** në pozicionin “Specialist në Sektorin e Raportimit Auditimit dhe Kontrollit të Sistemeve”, kategoria e pagës III-b.

Çmohet se, për 4 nëpunësit si më sipër, njësia përgjegjëse e institucionit ka zbatuar gabim ligjin pasi, për ata janë shtyrë procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, me pretendimin se duhet të plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, për të përmbushur kërkesat e pozicionit të punës ku ishin të emëruar. Gjatë kryerjes së procesit të mbikëqyrjes, rezultoi se konstatimet e njësisë përgjegjëse, përputhen me të dhënat individuale të nëpunësve të administruara në dosjet e personelit. Për këtë arsye, duhet të ishte vendosur përfundimi i marrëdhënies së punës për këta punonjës dhe jo të vendoseshin në pozita të cilat nuk i parashikon as ligji dha as aktet nënligjore që rregullojnë institutin e deklarimit të statusit të punësimit.

Nga ana tjetër, punonjësit e analizuar në këtë rast, tashmë që i kanë plotësuar kriteret e veçanta, nuk kanë asnjë pengesë për të konkurruar për pranimin në shërbimin civil, sipas procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, kur këto pozicione të shpallen si të lira, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin.

Konkluzion:

Për të gjitha sa analizuam me sipër, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, për punonjësit, *****, *****, ***** dhe *****, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punës, duke theksuar faktin se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ata nuk e plotësonin kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, për pozicionin e punës ku ata ishin të emëruar. Më tej, njësia përgjegjëse duhet të anulojë aktet individuale të transferimit për shkak të ristrukturimit. Këta punonjës, nuk kanë asnjë pengesë që të konkurrojnë për pranimin në shërbimin civil, sipas procedurave të konkurrimit të parashikuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

d) Punonjës që nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit, u konstatua se **në 22 raste**, nëpunësit të cilët në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, ishin të punësuar në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

- Në 5 raste nëpunësit nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit dhe për këta nëpunës nuk u gjet asnjë akt administrativ, apo provë tjetër shkresore, që të justifikojë mosveprimin e njësisë përgjegjëse për këto raste.

Në këtë grupim përfshihen punonjësit:

1. *****, e cila me urdhrin nr. 829/1, dt. 02.07.2013 “Për emërim në detyrë”, të titullarit të institucionit është emëruar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Imazhit Qytetar*”, Drejtoria e Turizmit dhe Promovimit. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, periudha e punësimit në këtë pozicion është më pak se një vit, marrëdhënia e punësimit në këtë funksion vazhdon edhe në momentin e mbikëqyrjes. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se, njësia përgjegjëse këtë punonjëse nuk e ka përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Për këtë arsye, në projektraportin dërguar institucionit, është lënë detyrë që, për punonjësen *****, njësia përgjegjëse, duhet të verifikojë procedurën e punësimit, kohëzgjatjen e periudhës së punësimit si dhe plotësimin kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil. Në përfundim të procedurës së verifikimit të lëshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit sipas përcaktimeve të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ndërkohë, gjatë procesit të mbikëqyrjes, në momentin e përgatitjes së raportit përfundimtar, njësia përgjegjëse informon Komisionerin se punonjësja në fjalë, me urdhrin nr. 14094/1, dt.05.10.2014, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me institucionin me kërkesë të saj.

2. *****, e cila me urdhrin nr. 455, dt. 18.04.2013 “Për emërim në detyrë”, të titullarit të institucionit, është emëruar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e GIS Kadastrës*”, Drejtoria e Planifikimit të Territorit. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, periudha e punësimit në këtë pozicion është më pak se një vit, marrëdhënia e punësimit në këtë funksion vazhdon edhe në momentin e mbikëqyrjes. Njësia përgjegjëse, këtë punonjëse nuk e ka përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se, në dosjen personale të kësaj nëpunëse është administruar diploma e përfundimit të arsimit të lartë, e nxjerrë nga Universiteti Politeknik i Tiranës, me nr. M-U021, data e daljes së aktit është 24.11.2014. Titulli i diplomës është “*Diplomë Master i Shkencave në Arkitekturë*”, Profili: “*Urbanist*”.

Në certifikatën e notave bashkëlidhur diplomës është përcaktuar programi i studimit: Master Shkencor (MSH), program studimi i integruar 5-vjeçar me kohë të plotë. Pra, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, kjo punonjëse ishte e punësuar në një pozicion të shërbimit civil, periudha e punësimit në këtë pozicion ishte më pak se një vit, por nuk zotëronte një diplomë të arsimit të lartë pasi nuk kishte përfunduar programin e studimeve. Njësia përgjegjëse nuk e ka përfshirë atë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, por ndërkohë punonjësja ka kryer kursin e trajnimit të detyrueshëm në ASPA (vlerësuar me 22/26 pikë), i është kryer edhe vlerësim vjetor i rezultateve në punë (vlerësuar me notën 2), eprori direkt me shkresën nr. 489/1 prot., dt. 03.04.2015 ka vendosur konfirmimin si nëpunës civil dhe më tej njësia përgjegjëse me aktin nr. 4891/2 prot., dt. 10.04.2015 “*Akt konfirmimi për statusin e nëpunësit civil*”, ka deklaruar statusin e punësimit si “*Nëpunës civil*”.

Në këto rrethana, arrihet në përfundimin se, për punonjësien *****, punësimi në pozicionin “*Specialist në Sektorin e GIS Kadastrës*”, pranë Bashkisë Tiranë (në dt. 18.04.2013) është kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit të zbatueshëm për shërbimin civil (ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”) pasi sipas përcaktimeve të këtij ligji, kandidatët që

pretendonin të punësoheshin në një pozicion të shërbimit civil duhet të kishin përfunduar arsimin e lartë sipas ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, edhe në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo punonjëse nuk e kishte përfunduar arsimin e lartë, që do të thotë se ajo nuk plotësonte kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit.

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka përcaktuar në mënyrë të shprehur mënyrën e pranimit në shërbimin civil, ndër të cilat, pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, nëpërmjet konkurrimit të hapur, ose nga trajtimi si “punonjës ekzistues”, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Punonjësja në fjalë nuk i është nënshtruar asnjërës nga këto procedura.

Nisur nga përmbajtja e materialit sqarues të dërguar nga institucioni si dhe aktet bashkëlidhur tij, rezulton se, punonjësja ***** i vazhdon marrëdhëniet e punës me institucionin. Në kuadër të ristrukturimit të institucionit, komisioni i ristrukturimit i ngritur në këtë rast dhe më pas edhe njësisia përgjegjëse e kanë trajtuar atë si nëpunës civil duke konkluduar me nxjerrjen e aktit individual të transferimit, siç është akti nr. 18064, dt. 12.11.2015 “Transferim për shkak të ristrukturimit”, për transferimin e punonjësës ***** në pozicionin “Specialist në Sektorin e GIS Kadastrës” dhe akti nr. 19583, dt. 23.6.2016 “Transferim për shkak të ristrukturimit” për transferimin e punonjësës ***** në pozicionin “Specialist në Sektorin e GIS Kadastrës”.

Çmohet se, në këtë rast njësisia përgjegjëse e institucionit ka zbatuar gabim ligjin pasi, kjo punonjëse nuk është përfshirë fare në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit për arsye se në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nuk e kishte përfunduar arsimin e lartë. Gjatë kryerjes së kësaj mbikëqyrje rezultoi se konstatimet e njësisë përgjegjëse përputhen me të dhënat individuale të nëpunësës të administruara në dosjen e personelit. Për këtë arsye, duhet të ishte vendosur përfundimi i marrëdhënies së punës dhe jo të trajtohej si nëpunës civil, pasi ajo nuk e ka përfituar këtë status në asnjë nga format që parashikon kuadri i ligjit për nëpunësin civil.

Duhet thënë se, kjo punonjëse ka të drejtë që të konkurrojë për pranimin në shërbimin civil, sipas procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkluzion:

Sa analizuar më sipër, për punonjësën ***** njësisia përgjegjëse duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ajo nuk zotëronte diplomë të arsimit të lartë, sipas parashikimeve të ligjit për arsimin e lartë në RSH. Më tej, njësisia përgjegjëse duhet të anulojë të gjitha aktet me të cilat kjo punonjëse është trajtuar si nëpunës civil, të tilla si, akti administrativ nr. 489/1 prot., dt. 03.04.2015, i eprorit direkt me të cilin është vendosur konfirmimi si nëpunës civil; akti nr. 4891/2 prot., dt. 10.04.2015 “Akt konfirmimi për statusin e nëpunësit civil”, i njësisë përgjegjëse për deklarimin e statusit të punësimit si “Nëpunës civil”; si dhe aktet e transferimit për shkak të ristrukturimit.

3. ***** , e cila në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “Specialist në Sektorin e Ankimimeve”, Drejtorja Juridike, për një periudhë punësimi më shumë se një vit (është emëruar në këtë detyrë

me urdhrin nr. 890, dt.17.09.2012, të drejtuesit të institucionit). Nga dokumentacioni i këqyrrur rezulton se, kjo punonjëse nuk është përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit. Ndërkohë, në momentin e mbikëqyrjes, nëpunësja në fjalë, kryen detyrën “*Specialist në periudhë prove në Sektorin e Planifikimit të Shërbimeve*”, Drejtoria e Planifikimit të Shërbimeve. Akti i emërimit në pozicionin aktual (akti nr. 14615/1 prot., dt. 03.11.2014), referon emërimin në kategorinë ekzekutive nëpërmjet procedurave konkurruese të parashikuara nga ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar.

Më tej, konstatohet se me aktin nr. 3353, datë 02.02.2016, “*Akt konfirmimi për statusin e nëpunësit civil*”, kjo punonjëse është konfirmuar si nëpunëse civile, në kategorinë ekzekutive, pasi ka kryer të gjitha detyrimet që kërkon periudha e provës.

Konkluzion:

Në rastin e punonjësës ***** , njësia përgjegjëse duhet të kishte kryer deklarimin e statusit të punësimit sipas nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Moskryerja e detyrës që i ngarkon pika 6, e kësaj dispozite të ligjit, e ngarkon me përgjegjësi njësinë përgjegjëse të institucionit të mbikëqyrrur.

Megjithatë, në këtë rast ky problem u theksua për të vënë në dukje mosveprimin e njësisë përgjegjëse, pasi në lidhje me të drejtat që i përkasin nëpunësës në fjalë, kjo parregullsi tashmë është kapërcyer, në kushtet kur ajo i gëzon të gjitha të drejtat që i njeh statusi i nëpunësit civil.

4. ***** , e cila në dt. 26.02.2014, ishte e punësuar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Infrastrukturës dhe Pajisjeve*”, Drejtoria e Prokurimeve, për një periudhë punësimi më të madhe se një vit (emëruar në këtë detyrë me urdhrin nr. 1315, dt. 26.10.2011, të titullarit të institucionit). Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, kjo punonjëse ishte me leje lindje të cilën e ka përfunduar në dt. 14.05.2014. Njësia përgjegjëse, nuk e ka përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e personelit u konstatua se, kjo nëpunëse është nëpunës civil i konfirmuar në nivelin ekzekutiv, sipas procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”. Me urdhrin nr. 284, dt. 14.05.2014, të titullarit të institucionit është emëruar Përgjegjës në Sektorin e Infrastrukturës dhe Pajisjeve, Drejtoria e Prokurimeve (emërim me urdhër, për ngritje në detyrë brenda sektorit ku ishte e punësuar). Më pas, për këtë pozicion ka kryer procedurën e ngritjes në detyrë sipas përcaktimeve të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, detyrë të cilën e kryen edhe në momentin e mbikëqyrjes.

Në rrethanat e parashtruara për këtë punonjëse, vërejmë se, në momentin e kryerjes së procedurave të deklarimit të statusit të punësimit (që institucioni i mbikëqyrrur i ka kryer në muajin qershor 2014), punonjësja ishte kthyer nga leja e lindjes dhe njësia përgjegjëse, duhet të kishte nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Kryerja e procedurës së ngritjes në detyrë, pa u bërë deklarimi i statusit të punësimit sipas përcaktimeve të nenit 67, përbën një parregullsi, pasi, një kandidat që aplikon për ngritje në detyrë, duhet të jetë nëpunës civil i konfirmuar sipas përcaktimeve të këtij ligji. Për këtë arsye,

për nëpunësen në fjalë, njësia përgjegjëse duhet të deklaronte statusin e punësimit si nëpunës aktual, pasi akti i deklaramit, është dokument që provon nëse, nëpunësi i plotëson ose jo kushtet minimale për të qenë kandidat për procedurën e ngritjes në detyrë, dokument i cili administrohet në dosjen e procedurës së konkurrimit.

Parregullsia e lejuar, ngarkon me përgjegjësi njësinë përgjegjëse, pasi nuk ka kryer detyrën që i ngarkon pika 6, e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku në mënyrë të shprehur thuhet se “*Deklarimi i statusit të punësimit sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit*”, por nga ana tjetër, ky mosveprim nuk e prek në thelb procesin e ngritjes në detyrë, pasi punonjësja realisht e gëzon statusin e nëpunësit civil.

5. ***** , e cila në dt. 26.02.2014, kryente detyrën “*Specialist në Sektorin e Komunikimit dhe Pritjes së Qytetarit*”, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, për një periudhë punësimi më të vogël se një vit (*emëruar në këtë pozicion me urdhrin nr. 927, dt. 13.12.2013, të drejtuesit të institucionit*). Nga verifikimi i dosjes së personelit rezulton se, niveli i arsimimit për këtë punonjëse, është arsimi i mesëm. Konstatohet se me urdhrin nr. 18843/1, datë 01.12.2015, të titullarit të Bashkisë Tiranë, për këtë punonjëse është vendosur zgjidhja e kontratës individuale të punës dhe përfundimi i marrëdhënies së punës me institucionin.

Në 17 raste punonjësit kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës, pa u kryer procedurat e deklaramit (*15 punonjës janë larguar nga detyra me dorëheqje; 1 punonjës është larguar me masë disiplinore; 1 punonjës ka mbushur moshën për pensionin e plotë të pleqërisë*).

Më konkretisht këta punonjës janë:

1. ***** , në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Bashkërendimit me Këshillin Bashkiak, ka përfunduar marrëdhëniet e punës për shkak të plotësimit të moshës për pension të plotë pleqërie, shkak i parashikuar në nenin 65, shkronja “c” të ligjit.
2. ***** , në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Publikimeve Zyrtare. Përgjatë periudhës nëntor 2013 - nëntor 2014 ka qenë me leje lindje. Me aktin nr. 803/1, dt. 27.11.2014 ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
3. ***** , në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Përgjegjës Zyre*”, në Zyrën e Ndihmës Juridike për Qytetarët. Me aktin nr. 282/2, dt. 10.06.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
4. ***** , në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Rinisë. Me aktin nr. 223, dt. 18.03.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
5. ***** , në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Vlerave Ekonomike e Zhvillimit Ekonomik. Me aktin nr. 182, dt. 05.03.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
6. ***** , në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Menaxhimit Financiar. Me aktin nr. 273, dt. 10.04.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
7. ***** , në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Implementimit të Projekteve. Me aktin nr. 273/1, dt. 10.04.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.

8. *****, në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Planeve Vendore. Me aktin nr. 717/1, dt. 29.07.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës.
9. *****, në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Shqyrtimit të Aplikimeve. Me aktin nr. 282, dt. 08.05.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
10. *****, në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Planifikimit të Shërbimeve. Me aktin nr. 761, dt. 01.09.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
11. *****, në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Ankimimeve. Me aktin nr. 194, dt. 10.03.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
12. *****, në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Arkivit Qendror. Me aktin nr. 717, dt. 30.06.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
13. *****, në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Financës. Me aktin nr. 187, dt. 10.03.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
14. *****, në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Modernizimit & Inovacionit & Projekteve. Me aktin nr. 120, dt. 03.03.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
15. *****, në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Shërbimeve dhe Asistencës Teknike. Me aktin nr. 226, dt. 19.03.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
16. *****, në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Analizës dhe Kostove. Me aktin nr. 766, dt. 02.09.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes.
17. *****, mbante detyrën “*Përgjegjës Sektori/Sekretariati Teknik*”, në datën 06.06.2014 ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me masë disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, marrë me vendimin nr. 5731/7 prot., dt. 06.06.2014, të komisionit disiplinor. Masa disiplinore është marrë para se të kryheshin procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, në rastin e këtyre punonjësve, njësia përgjegjëse ka vepruar drejt, pasi përfundimi i marrëdhënieve të punësimit në këtë rast është bërë nëpërmjet pranisë së shkaqeve të parashikuara nga neni 63, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Procesi i deklarimit të statusit të punësimit në raport me afatet ligjore

Në mbështetje të pikës 8 të nenit 67 të ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, është miratuar vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (ndryshuar me vendimin nr. 532, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr. 627, dt. 24.09.2014 të Këshillit të Ministrave).*

Në këtë akt normativ janë përcaktuar procedurat e hollësishme që duhet të kryejë njësia përgjegjëse për të realizuar deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit dhe nëpunësit aktualë si dhe afati brenda të cilit duhet të përfundojë i gjithë ky proces. Në kreun IV, pika 1 të

vendimit si më sipër është përcaktuar se “*Procedura e deklarimit të statusit të punësimit përfundon jo më vonë se 120 (njëqind e njëzetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi*”. Më tej pika 2 përcakton se “... Në çdo rast, shtyrja e afatit nuk mund të jetë më vonë se data 30 tetor 2014”.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes konstatohet se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë për **428** punonjës i ka përfunduar procedurat e deklarimit të statusit të punësimit në fund të muajit qershor 2014, pra, brenda afatit të përcaktuar.

Konstatohet se, në **2** raste, procedura e deklarimit të statusit të punësimit, i ka përfunduar me vonesë. Gjatë procesit të verifikimit, nuk u gjetën materiale shkresore që të justifikojnë vonesën për këto raste.

Në këtë rast bëhet fjalë për:

- Punonjës in ***** , me aktin nr. 4923/1 prot., dt. 03.04.2015 “*Akt konfirmimi për statusin e nëpunësit civil*”, i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, është deklaruar “*Nëpunës civil*” në kategorinë e ulët drejtuese.
- Punonjës in ***** , me aktin nr. 1514 prot., dt. 29.01.2015 “*Akt konfirmimi për statusin e nëpunësit civil*”, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, është deklaruar “*Nëpunës civil*” në kategorinë e ulët drejtuese. Në momentin e mbikëqyrjes, punonjësi në fjalë, ka përfunduar marrëdhënien e punësimit nëpërmjet dorëheqjes (akt nr. 11128/1, dt. 26.08.2015).

III. Administrimi i shërbimit civil në lidhje me disa institute të ligjit, të zbatuara nga fillimi i efekteve juridike të tij, deri në momentin e krverjes së mbikëqyrjes.

1. Pezullimi nga shërbimi civil

Nga këqyrja e dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, instituti i pezullimit nga shërbimi civil është zbatuar në 6 raste. Në të gjitha rastet, pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil, është bërë me kërkesë të nëpunësit, të parashikuar nga neni 55 i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 26.3.2014 “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, kreu VI “*Pezullimi*”, pika 39 (këto përcaktime janë shfuqizuar por ishin të zbatueshme në momentin e vendosjes së pezullimeve në fjalë). Më konkretisht këta nëpunës janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabelë: Rastet e pezullimit nga shërbimi civil

Nr.	Nëpunësi/ Emër/Mbiemër/ *****/	Akti i deklarimit të statusit të punësimit	Vendimi për miratim të pezullimit	Shkaku i pezullimit dhe afati i pezullimit
1	Përgjegjës zyre, Zyra e Koordinimit me Njësitë Bashkiake	Akti nr. 568, dt. 23.06.2014 deklarohet “ <i>Nëpunës civil në periudhë prove</i> ”	Akti nr. 2212 prot., dt. 09.02.2015	Pezullim nga detyra me kërkesë të nëpunësit, për një periudhë deri në 2 vjet
2	*****/Përgjegjës Sektori, Sektori i Shërbimit të Investitorëve	Akti nr. 698, dt. 26.06.2014 deklarohet	Akti nr. 10063/1, prot., dt. 27.07.2015	Pezullim nga detyra me kërkesë të nëpunësit, për një periudhë deri në 2 vjet

		<i>“Nëpunës civil në periudhë prove”</i> . Konfirmimi vendim nr. 3392/2, dt. 18.03.2015		
3	*****/Përgjegjës Sektori, Sektori i Planeve të Detajuara Vendore	Akti nr. 690, dt. 26.06.2014 deklarohet <i>“Nëpunës civil në periudhë prove”</i>	Akti nr. 4930 prot., dt. 01.04.2015	Pezullim nga detyra me kërkesë të nëpunësit, për një periudhë deri në 2 vjet
4	*****/ Specialist, Sektori i Infrastrukturës Rrugore	Akti nr. 598, dt. 24.06.2014 deklarohet <i>“Nëpunës civil në periudhë prove”</i>	Akti nr. 772/1 prot., dt. 30.09.2014	Pezullim për shkak të vazhimit të studimeve jashtë shtetit, për një periudhë deri në 1 vit.
5	*****/ Specialist, Sektori i Energji Telekomunikimit	Akti nr. 324, dt. 10.06.2014 deklarohet <i>“Nëpunës civil”</i>	Akti nr. 11127/1 prot., dt. 26.08.2015	Pezullim për shkak të vazhimit të studimeve jashtë shtetit.
6	*****/ Specialist, Sektori i Menaxhimit të Strehimit	Akti nr. 371, dt. 11.06.2014 deklarohet <i>“Nëpunës civil”</i>	Akti nr. 2650/2, dt. 02.03.2015	Pezullim nga detyra me kërkesë të nëpunësit, për një periudhë deri në 2 vjet.

Konkluzion:

Komisioneri arrin në përfundimin se, pezullimi nga shërbimi civil për nëpunësit *****, *****, *****, *****, ***** dhe *****, është i mbështetur në dispozitat ligjore që rregullojnë shërbimin civil, pasi:

- Pezullimi është bërë me kërkesë të vetë nëpunësit civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, neni 53, pika 1, shkronja *“b”* dhe vendimit nr. 171, datë 26.3.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”*, kreu VI, pika 39, që ishte edhe dispozita në fuqi.
- Njësia e burimeve njerëzore ka konstatuar me shkrim pezullimin sipas vendimit nr. 171, datë 26.3.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”*, kreu VI, pika 40.
- Në përfundim të afatit apo shkakut të pezullimit, njësia përgjegjëse, të zbatojë efektet e pezullimit sipas parashikimeve të nenit 56, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar si dhe kreu II, të vendimit nr. 124, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”*.

2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes

Nga trajtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se instituti i dorëheqjes është zbatuar për 52 nëpunës civilë (27 prej tyre të deklaruar *“Nëpunës civil”* dhe 25 të deklaruar *“Nëpunës civil në periudhë prove”*). Për shkak të numrit të madh, nëpunësit civilë të liruar me dorëheqje janë paraqitur në një tabelë më vete, *tabela 1.3: “Nëpunës të deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil”/“Nëpunës civil në periudhë prove” që në momentin e mbikëqyrjes kanë përfunduar marrëdhëniet e punës me dorëheqje”*. Në këtë tabelë është evidentuar nëpunësi civil i dorëhequr, pozicioni i punës që mbante në dt. 26.02.2014, akti i deklarimit të statusit të

punësimit dhe akti i miratimit të dorëheqjes nga njësia e burimeve njerëzore. Tabela i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij.

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 64 parashikon institutin e dorëheqjes. Ky nen, pas ndryshimeve përkatëse, në pikën 4 në mënyrë të shprehur parashikon :

“Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil”.

Në mbështetje të përcaktimeve të kësaj dispozite, nëpunësit që në momentin e miratimit të dorëheqjes ishin “Nëpunës civil të konfirmuar”, njësia përgjegjëse duhet t’i regjistrojë në një listë, duke u njohur të drejtën që brenda periudhës 2-vjeçare, nga data e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurën e lëvizjes paralele, apo të ngritjes në detyrë në pozicione pune të shërbimit civil.

Konkluzion:

Njësia përgjegjëse e institucionit të kontrolluar, në këtë rast duhet të krijojë një listë për nëpunësit që kanë përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil me anë të dorëheqjes. Kjo listë të administrohet nga njësia përgjegjëse me qëllim që, nëpunësve t’u garantohej e drejta e konkurrimit si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

4. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se, 5 nëpunës civilë, kanë përfunduar marrëdhëniet e punës për shkak të ligjit, për arsye se kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë.

Më konkretisht këta nëpunës janë:

- ***** , në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “*Specialist në Sektorin e Buxhetit Vjetor Afatmesëm*”, me aktin nr. 547, dt. 23.06.2014 është deklaruar “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, në dt. 09.04.2015, ka përfunduar marrëdhëniet e punës pasi ka plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë.
- ***** , në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “*Specialist në Sektorin e Projektimit*”, me aktin nr. 513, dt. 19.06.2014, është deklaruar “*Nëpunës civil*”, në dt. 21.04.2015 ka përfunduar marrëdhëniet e punës pasi ka plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë.
- ***** , në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “*Specialist në Sektorin e Energji Telekomunikimit*”, me aktin nr. 323, dt. 10.06.2014 është deklaruar “*Nëpunës civil*”, në dt. 03.12.2014 ka përfunduar marrëdhëniet e punës pasi ka plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë.
- ***** , në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “*Specialist në Sektorin e Qendrave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*”, me aktin nr. 513, dt. 19.06.2014 është deklaruar “*Nëpunës civil*”, në dt. 03.11.2014 ka përfunduar marrëdhëniet e punës pasi ka plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë.

- ***** , në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “*Specialist në Sektorin e Analizës dhe Kostove*”, me aktin nr. 396, dt. 13.06.2014 është deklaruar “*Nëpunës civil*”, në dt. 30.12.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës pasi ka plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë.

Konkluzion:

- Vlerësohet se, përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për këtë grup nëpunësish është bërë për shkak të ligjit, rast ky i parashikuar nga neni 65 shkronja “c”, e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar ku në mënyrë të shprehur përcakton se: “*Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon për shkak të ligjit kur: ... c) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë*”.

4. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të largimit nga shërbimi civil, si masë disiplinore

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se në 2 raste, nëpunësit kanë përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të largimit nga shërbimi civil, si masë disiplinore. Në këtë rast bëhet fjalë për nëpunësit:

- ***** , “*Përgjegjës Sektori/Sekretariati Teknik*”, në datën 06.06.2014, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me masë disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, marrë me vendimin nr. 5731/7 prot., dt. 06.06.2014 të komisionit disiplinor, (*masa disiplinore është marrë para se të kryheshin procedurat e deklarimit të statusit të punësimit*).
- ***** , me detyrë, “*Përgjegjës në Sektorin e Energji Telekomunikimit*”, me aktin nr. 322, dt. 09.06.2014 i është deklaruar statusi “*Nëpunës civil*”, në datën 01.09.2014, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me masë disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, marrë me vendimin nr. 10097/2 prot., dt. 22.08.2014 të komisionit disiplinor.

5. Nëpunës civilë që kanë kaluar në një institucion tjetër nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele

Gjatë mbikëqyrjes u konstatua se, 2 nëpunës, kanë kaluar në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëpërmjet lëvizjes paralele. Këta nëpunës janë:

- ✓ ***** , “*Inspektor në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm*”, me aktin nr. 389, dt. 11.06.2014, është deklaruar “*Nëpunës civil*”, në dt. 30.06.2015, me lëvizje paralele ka kaluar në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
- ✓ ***** , “*Specialiste në Sektorin e Nxitjes së Punësimit dhe Karrierës*”, me aktin nr. 431, dt. 16.06.2014, është deklaruar “*Nëpunës civil*”, në dt. 04.05.2015, me lëvizje paralele ka kaluar në Kuvendin e Shqipërisë.

6. Nëpunës civilë që kanë kaluar në një institucion tjetër nëpërmjet transferimit të përhershëm:

Transferimi i përhershëm është zbatuar vetëm në 1 rast, bëhet fjalë për nëpunësen ***** , “*Specialist në Sektorin e Koordinimit me Donatorët*”, me aktin nr. 550, dt. 23.06.2014, është

deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove”, në dt. 14.08.2015 me transferim të përhershëm ka kaluar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

7. Emërimet në shërbimin civil pas fillimit të efekteve të ligjit.

Nga verifikimi i akteve të emërimit, për nëpunësit që kryenin funksione të shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes u konstatua se, 60 nëpunës janë të emëruar sipas procedurave konkurruese të parashikuar nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Bazuar në procedurën e emërimit që referon akti i emërimit vëmë re se:

- në **1** rast, emërimi është kryer sipas përcaktimeve të nenit 30, pika 5 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar ku përcaktohet se, “Anëtarët e TND-së mund të caktohen në çdo pozicion të rregullt të kategorisë së lartë drejtuese, të përcaktuar sipas pikës 4 të nenit 19 të këtij ligji, apo të caktohen koordinatorë të posaçëm”. Më tej, pika 4 e nenit 19 përcakton “Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese janë këto pozicione: a) sekretar i përgjithshëm; b) drejtor departamenti; c) drejtor drejtorie të përgjithshme; ç) pozicionet e barasvlershme me tre të parat”.

Më konkretisht, rezulton se nëpunësja ***** me aktin nr. 10658, dt. 07.08.2015, është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse. Në këtë rast, me pëlqimin e nëpunësit dhe miratimin e Departamentit të Administratës Publike, një anëtar i TND-së është emëruar në një pozicion të kategorisë së lartë drejtuese.

- në **3** raste, emërimet janë kryer nëpërmjet transferimit të përhershëm nga nëpunës brenda institucionit.
- në **4** raste, emërimet janë kryer nëpërmjet lëvizjes paralele nga nëpunës civilë brenda institucionit.
- në **6** raste, emërimet janë kryer nëpërmjet ngritjes në detyrë nga nëpunës civilë brenda institucionit.

Nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes mbanin pozicione të shërbimit civil, të emëruar nëpërmjet lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe transferimit, procedura të cilat janë realizuar nga kandidatë brenda institucionit (nga nëpunës brenda bashkisë), janë pasqyruar në tabelën si më poshtë.

Tabelë: Nëpunës, të emëruar në pozicionin aktual nëpërmjet lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe transferimit të përhershëm.

Nr.	Nëpunësi/Emër/Mbiemër Pozicioni i punës që mbante në dt. 26.02.2014	Akti i deklaramit të statusit të punësimit, nr./dt.	Pozicioni i punës që mban në momentin e mbikëqyrjes (Pozicioni aktual i punës)	Akti i emërimit në pozicionin aktual (procedura e aplikuar)
1	***** Specialist, Sektori i Menaxhimit të Strehimit	Akti nr. 372, dt.11.06.2014, deklarohet “Nëpunës civil”	Specialist, Sektori i Komunikimit dhe Pritjes së Qytetarit	Akti nr. 5231 prot., dt. 07.04.2014 (lëvizje paralele)
2	***** Drejtor, Drejtorja e Planifikimit të Projekteve Strategjike	Akti nr. 705, dt. 26.06.2014, deklarohet “Nëpunës civil”	Drejtor, Njësia e Zbatimit të Projekteve	Aktin nr. 4989/5 prot., dt. 02.04.2015 (transferim i përhershëm)

3	***** <i>Specialist,</i> Sektori i Komunikimit &Pritjes së Qytetarit	Akti nr. 423, dt. 16.06.2014, deklarohet “Nëpunës civil në periudhë prove”	<i>Specialist,</i> Sektori i Menaxhimit Financiar, Njësia e Zbatimit të Projekteve	Akti nr. 5345/1 prot., dt. 09.04.2015 (<i>lëvizje paralele</i>)
4	***** <i>Specialist,</i> Sektori i Shqyrtimit të Aplikimeve	Akti nr. 534, dt. 20.06.2014, deklarohet “Nëpunës civil”	<i>Specialist,</i> Sektori i Kontrollit të Aplikimit të Lejeve	Akti nr. 2208/1 prot., dt. 09.02.2015 (<i>transferim i përhershëm</i>)
5	***** <i>Specialist,</i> Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve	Akti nr. 488, dt.18.06.2014, deklarohet “Nëpunës civil”	<i>Përgjegjës Sektori,</i> Sektori i Kontrollit të Zbatimit të Lejeve	Akti nr. 4915/5 prot., dt. 02.04.2015 (<i>ngritje në detyrë</i>)
6	***** <i>Specialist,</i> Sektori i Shqyrtimit të Aplikimeve	Akti nr.610, dt. 24.06.2014, deklarohet “Nëpunës civil në periudhë prove”	<i>Përgjegjës sektori,</i> në Sekretariatit Teknik	Akti nr. 4 913/5 prot., dt. 02.04.2015 (<i>ngritje në detyrë</i>)
7	***** <i>Specialist,</i> Sektori i Shërbimeve të Brendshme	Akti nr. 296, dt. 06.06.2014, deklarohet “Nëpunës civil”	<i>Specialist,</i> Sektori i Transportit Urban	Akti nr. 5342/1 prot., dt. 09.04.2015 (<i>transferim i përhershëm</i>)
8	***** <i>Specialist,</i> Sektori i Transportit Urban	Akti nr. 362, dt.11.06.2014, deklarohet “Nëpunës civil”	<i>Përgjegjës Sektori,</i> Sektori i Ujësjetës Kanalizimeve	Akti nr. 15239/6 prot., dt.19.11.2014. (<i>ngritje në detyrë</i>)
9	***** <i>Specialist,</i> Qendra e Kontrollit të Trafikut	Akti nr. 367, dt.11.06.2014, “Nëpunës civil”	<i>Specialist,</i> Sektori i Energji Telekomunikacionit	Akti nr.1692 prot., dt. 02.12.2014 (<i>lëvizje paralele</i>)
10	***** <i>Specialist,</i> Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit	Akti nr. 397, dt.13.06.2014 “Nëpunës civil”	<i>Përgjegjës Sektori,</i> Sektori i Kontratave & Marrëveshjeve	Akti nr. 14689/1 prot., dt. 03.11.2014 (<i>ngritje në detyrë</i>)
11	***** <i>Specialist,</i> Sektori i Infrastrukturës TIK	Akti nr. 611, dt. 24.06.2014, “Nëpunës civil në periudhë prove”	<i>Përgjegjës Sektori,</i> Sektori i Modernizimit & Inovacionit & Projekteve	Akti nr. 5265/1 prot., dt. 08.04.2015 (<i>ngritje në detyrë</i>)
12	***** <i>Specialist,</i> Sektori i Menaxhimit të Pastrimit të Qytetit. DMMUN	Akti nr. 301, dt. 06.06.2014 “Nëpunës civil”	<i>Specialist,</i> Sektori i Infrastrukturës TIK, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit	Akti nr. 5274/1 prot., dt. 08.04.2015 (<i>lëvizje paralele</i>)
13	***** <i>Specialist,</i> Sektori i Infrastrukturës dhe Pajisjeve	Nuk është përfshirë në procedurat e deklarimit.	<i>Përgjegjës Sektori,</i> Sektori i Infrastrukturës dhe Pajisjeve	Akti nr. 5266/2 prot., dt. 14.04.2015 (<i>ngritje në detyrë</i>)

- Në momentin e mbikëqyrjes u konstatua se, **40 nëpunës** të emëruar, nëpërmjet procedurës së pranimit në nivelin ekzekutiv, parashikuar nga seksioni 2, me nëntitull “Pranimi në nivelin ekzekutiv të shërbimit civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. (Këta nëpunës janë të pasqyruar në tabelën Aneks nr. 1: “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij).

- 3 vende të lira të kategorisë ekzekutive, janë plotësuar due mos respektuar procedurat e konkurrimit të hapur, të përcaktuara nga ligji për nëpunësin civil.

Konkluzione: Emërimet e kryera në shërbimin civil pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë trajtuar vetëm si konstatime, pa u shprehur për mënyrën e realizimit të tyre pasi programi i mbikëqyrjes, kishte objekt të kufizuar (*tematik*). Në këtë kuadër, sjellim në vëmendje të njësisë përgjegjëse që, bazuar në planin e nevojave për rekrutim, të realizojë procedurat e konkurrimit, duke respektuar me përpikmëri ligjin dhe duke luajtur rol aktiv, në mënyrë që të mos çenojë interesat e punonjësve për shkak të mosnjohjes së ligjit, apo mosrespektimit të kërkesave të tij dhe mundësive kufizuese ose favorizuese që përmbajnë dispozitat ligjore.

8. Emërimet të konstatuara në kundërshtim me procedurat e pranimit në shërbimin civil

Në këtë rast bëhet fjalë për punonjësit:

- ✓ *****, me urdhrin nr. 184, dt. 05.03.2014, “Për emërim në detyrë”, të titullarit të institucionit është emëruar “Specialist në Sektorin e Bashkërendimit me Këshillin Bashkiak”, në Bashkinë e Tiranës. Në pikën 3, të urdhrit është përcaktuar se marrëdhëniet e punës i fillojnë në dt. 10.03.2014.

Punonjësja *****, aktualisht vazhdon marrëdhëniet e punës, edhe pas ristrukturimit të institucionit, pasi komisioni i ristrukturimit i ngritur në këtë rast dhe më pas edhe njësisë përgjegjëse, e kanë trajtuar atë si nëpunës civil, nëpërmjet aktit individual të transferimit, me nr. 17817, dt. 12.11.2015 “Transferim për shkak të ristrukturimit”, në pozicionin “Specialist në Zyrën e Këshillit Bashkiak”. Konstatohet se, në këtë rast, njësisë përgjegjëse e institucionit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit pasi, për këtë punonjëse duhet të ishte vendosur përfundimi i marrëdhënies së punës me pozicionin e shërbimit civil dhe jo të trajtohej si nëpunës civil në kuadër të ristrukturimit.

- ✓ *****, është evidentuar gjatë verifikimit në institucion, në procesin e mbikëqyrjes, se ka filluar punë me urdhrin nr.266, dt. 02.04.2014, “Për emërim në detyrë”, të titullarit të institucionit, duke mos zbatuar procedurat ligjore, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Parqeve Industriale”, Drejtoria e Projekteve Strategjike, në Bashkinë e Tiranës. Në pikën 3 të urdhrit, është përcaktuar se marrëdhëniet e punës i fillojnë në dt. 01.04.2014.

Ndërkohë, në përmbajtjen e observacioneve të institucionit, për punonjësen *****, është sqaruar, si dhe janë paraqitur prova shpresore që provojnë se pozicioni që mbante nëpunësja, është publikuar si vend i lirë, me shkresën nr. 3967, datë 13.03.2015, “Njoftim”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Më tej, rezulton se me shkresën nr. 5450, datë 10.04.2015, “Njoftim për kandidatin fitues”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, kjo punonjëse është renditur e dyta në listën e kandidatëve fitues, me 75 pikë.

Në përfundim të periudhës së provës, pasi ka kryer edhe trajnimin e detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike, ka marrë vlerësim pozitiv, si dhe pasi ka dalë akti i eprorit direkt, për konfirmimin e saj si nëpunëse civile, rezulton se me shkresën nr. 20135/2, datë 06.07.2016, të njësisë përgjegjëse, ajo është deklaruar si nëpunëse civile.

Në këto kushte, në rrethanat e reja të paraqitura më sipër, vlerësohet se, punonjësja në fjalë, është rekrutuar nëpërmjet një procedure të rregullt konkurrimi.

Më tej, rezulton se kjo punonjëse me aktin nr. 17914, datë 12.11.2015, është trajtuar si nëpunëse civile, gjatë një procesi ristrukturimi, ku është emëruar në pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Planifikimit të Projekteve*”, në Drejtorinë e Projekteve Strategjike.

- ✓ ******, me urdhrin nr. 270, dt. 08.04.2014 të titullarit të institucionit është emëruar “*Specialist në Sektorin e Analizes dhe Kostove*”, Drejtoria e Prokurimeve në Bashkinë e Tiranës. Marrëdhëniet e punës me këtë pozicion i kanë filluar në dt. 09.04.2015.

Plotësimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, si më sipër, është bërë në kundërshtim me ligjin, për këtë arsye në projektraportin dërguar institucionit është rekomanduar që për këta punonjës të revokohen aktet e emërimit, pasi për çdo emërim në shërbimin civil, pas datës 26.02.2014, që është data e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, mbështetur në përcaktimet e nenit 22, e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht procedurat e konkurrimit për pranimin në shërbimin civil, lëvizjen paralele apo ngritjen në detyrë. Çdo emërim në pozicione të shërbimit civil, në kundërshtim me këto procedura, është absolutisht i pavlefshëm.

Ndërkohë, sipas observacioneve të institucionit, rezulton se me aktin nr. 25559, dt. 24.08.2016, është vendosur lirimi nga detyra i punonjësit ******, me motivacionin se është emëruar në kundërshtim me procedurat e pranimit në shërbimin civil.

Konkluzion:

Në rrethanat e përmendura si më sipër, çmohet se në rastin e punonjësit ***** dhe ******, është rregulluar ligjshmëria, pasi njësia përgjegjëse i ka zbatuar rekomandimet e lëna në projektraport, ndërsa në rastin tjetër, për punonjësën ******, për rregullimin e paligjshmërisë, njësia përgjegjëse duhet të veprojë si më poshtë:

- Në zbatim të nenit 124/1, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, referuar nenit 185 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, të anulohet aktin nr. 184, datë 05.03.2014 “*Për emërim në detyrë*” dhe aktin nr. 17817, dt. 12.11.2015 “*Transferim për shkak të ristrukturimit*”, të nxjerra për punonjësën ******, me detyrë “*Specialist në Zyrën e Këshillit Bashkiak*”, në Bashkinë e Tiranës dhe të përfundojë marrëdhëniet e punës me shërbimin civil.
- Pozicioni i punës të shpallet i lirë dhe kjo punonjëse nuk ka asnjë pengesë që të marrë pjesë në konkurrimin që do të zhvillohet në këtë rast.

9. Struktura dhe organika e institucionit në momentin e mbikëqyrjes.

Nga momenti i fillimit të efekteve të ligjit e deri në momentin e mbikëqyrjes struktura dhe organika e institucionit ka pësuar vetëm një ndryshim të miratuar me vendimin nr. 17, datë 06.03.2015 të Këshillit Bashkiak Tiranë “*Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 8, dt. 12.10.2011 “Për miratimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës (i ndryshuar)*”. Në këtë proces, vihet re se, është shtuar një pozicion pune pjesë e

shërbimit civil (në momentin e fillimit të efekteve të ligjit ishin 469 pozicione të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes janë 470 pozicione, pasi është shtuar një pozicion me emërtesën “Specialist” në Sektorin e Bashkërendimit të Këshillit Bashkiak).

Ndërsa, përsa i përket mënyrës së organizimit të pozicioneve të shërbimit civil 4 pozicione pune kanë ndryshuar emërtesën ku tre prej tyre ishin “Specialist” dhe janë bërë “Inspektor”, dhe 1 pozicion ishte “Përgjegjës Sektori” dhe është bërë “Specialist”. Pra, në momentin e mbikëqyrjes, struktura dhe organika e institucionit përbëhet nga këto nivele:

- 6 pozicione pune, të kategorisë së lartë drejtuese;
- 30 pozicione pune, të kategorisë së mesme drejtues;
- 89 pozicione pune, të kategorisë së ulët drejtuese; dhe,
- 345 pozicione pune, të nivelit ekzekutiv.

10. Dokumentimi i procesit të deklarimit të statusit të punësimit në dosjen e personelit

b) Përshkrimet e punës:

Hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ndër të tjera e ngarkonin njësinë përgjegjëse, (në rastin e institucionit të mbikëqyrur në këtë rol paraqitet njësia e burimeve njerëzore), me detyrën e hartimit të përshkrimeve të punës në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.

Gjatë procesit të verifikimit të dosjeve të personelit u konstatuan raste ku, përshkrimi i punës nuk është sipas formatit të miratuar; raste ku formati i përshkrimit të punës nuk përputhet plotësisht me formatin e miratuar; si dhe, raste ku në kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit është përcaktuar vetëm që kërkohet arsimit i lartë dhe nuk është specifikuar niveli i diplomës që duhet të zotërojë kandidati/kandidatja si dhe profili i arsimit të lartë që duhet të zotërojë.

Në këtë proces u konstatua një rast, ku nëpunësi është i punësuar sipas procedurave konkurruese të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, në bazë të të cilit kandidatët që punësoheshin në një pozicion të shërbimit civil duhet të kishin formim universitar. Bëhet fjalë për nëpunësin ***** me detyrë “Specialist në Sektorin e Sigurisë Rrugore”, Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë, kategoria e pagës III-b, i punësuar në këtë pozicion me aktin nr. 1625, dt. 31.10.2011 (fillimi i marrëdhënies të punës me institucionin me aktin nr. 518/1, dt. 07.11.2003). Niveli i arsimit Diplomë Teledidaktike, kursi i plotë 3 vjeçar në Sistemin e Edukimit në Distançë, pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, UPT, në Inxhinieri Elektronike, profili Telekomunikacion. Titulli “Inxhinier Elektronik, Profili Telekomunikacion”. (Numri i Diplomës 004, dt. 21.04.2006).

Ligji nr. 152/2013 përcakton në mënyrë të shprehur se një kandidat që do të punësohet në një pozicion të shërbimit civil duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit të lartë diplomë “Bachelor”; “Master Profesional”; “Master i Shkencave” sipas specifikës së përshkrimit të punës. Për këtë rast, në projektraport është lënë detyrë që njësia përgjegjëse të bëjë ekuivalentimin e diplomës që zotëron nëpunësi ***** , sipas sistemit të Bolonjës. Në përfundim të verifikimeve nëse nëpunësi nuk plotëson kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit të bëhet sistemimi i tij në një pozicion me përshkrim pune sipas nivelit të arsimit ose përfundimi i marrëdhënies së punësimit me shërbimin civil.

Nisur nga përmbajtja e materialit sqarues të dërguar nga institucioni si dhe aktet bashkëlidhur tij, rezulton se, me aktin nr. 19595, datë 23.06.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burimeve Njerëzore, punonjësi D. Balluku, është transferuar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Sigurisë dhe Sinjalistikës Rrugore*”, (kategoria e pagës IV-a), pozicion pune për të cilin punonjësi në fjalë plotëson kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë. Në këtë rast, çmohet se institucioni i ka marrë parasysh rekomandimet e bëra nga grupi i punës në projektraport.

Gjithashtu, njësisë përgjegjëse dhe aktorëve të tjerë të procesit i janë lënë disa detyra, ndër të cilat:

- Njësia përgjegjëse të fillojë menjëherë punën, për plotësimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, për pozicionet e shërbimit civil, me qëllim që ato të jenë në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, në përputhje me rregullat e parashikuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar dhe lidhjeve bashkëlidhur këtij vendimi. Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen për hartimin e përshkrimeve të punës, nëpunësit përgjegjës për hartimin e këtyre akteve, strukturën përgjegjëse për vlerësimin e bazueshmërisë së tyre në ligjin specifik dhe formatin e miratuar, organin që ka kompetencën për miratimin e tyre, si dhe depozitimin e tyre pranë njësisë përgjegjëse.
- Analisti i burimeve njerëzore mbështetur në legjislacionin specifik dhe në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit përkatës të shërbimit civil të mbledhë informacionin e nevojshëm për çdo pozicion pune dhe pas një analize të këtij informacioni, të përcaktohen në mënyrë të qartë detyrat, përgjegjësitë dhe kërkesat e veçanta për çdo pozicion apo grup pozicionesh të shërbimit civil.
- Formati i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil, të jetë sipas lidhjes nr. 4 “*Formulari i përshkrimit të punës*”, që i bashkëlidhet si pjesë përbërëse e tij vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, dhe të ketë të përfshirë të gjithë elementet, siç janë të dhënat për pozicionin e punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës dhe kërkesat e posaçme.
- Në ndarjen “*Kërkesat e posaçme*”, të plotësohen në mënyrë të qartë kërkesat e posaçme që duhet të plotësojë nëpunësi për: nivelin e arsimit (*niveli i diplomës “Bachelor”; “Master Profesional”; “Master i Shkencave” që ai/ajo duhet të zotërojë*); profili i arsimit të lartë që duhet të ketë; kualifikimet/trajnimet dhe kërkesa të tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës të shërbimit civil.
- Njësia përgjegjëse (njësia e burimeve njerëzore), të konfirmojë në mënyrë shkresore, se përshkrimet e punës, janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar.

- Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë njësisë përgjegjëse të institucionit. Në këtë mënyrë përshkrimet e punës bëhen pjesë e akteve rregullative në bazë të të cilave është i organizuar dhe funksionon institucioni, siç janë, struktura dhe organika në fuqi e institucionit, rregullorja e brendshme e institucionit etj. Kjo për faktin pasi, vetë akti nënligjor, i ka konceptuar këto akte me karakter të qëndrueshëm që hartohen kur krijohen institucione të reja dhe që kushti për t'u ndryshuar është ndryshimi i mënyrës së organizimit të institucionit apo ndryshimi i legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni.

c) Dosja e Personelit

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikuan dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe sipas kërkesave të vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se janë të përfshira dokumentet me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjeve 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se, në dosjet personale të nëpunësve, administrohet dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnjoftimit*); dokumentet lidhur me nivelin e arsimit të lartë dhe profilin e studimeve (*fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*), dokumentet që vërtetojnë fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*); dokumenti i vërtetimit të gjendjes gjyqësore, apo çertifikata e kontrollit shëndetësor (*raporti mjekësor*), si dhe aktet që provojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit.

Në institucionin e mbikëqyrur, konstatohet se dosjet e personelit, janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve. Rastet e konstatuara me mungesa, janë të evidentuara në tabelat bashkëlidhur raportit.

Më konkretisht u konstatua se:

- Në **40** raste, nëpunësit nuk kanë paraqitur dokumentin që vërteton kushtet shëndetësore të përshtatshme (*raportin mjekësor*). Këto raste janë evidentuar në tabelën bashkëlidhur raportit. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 17.2.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, kreu III “Lirimi nga shërbimi civil”, pika 23, paragrafi i dytë përcakton: “Nëpunësi civil paraqet pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentin e shëndetit në punë, sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë, brenda datës 10 janar të çdo viti”.
- Në **94** raste, nëpunësit nuk kanë paraqitur dokumentin që vërteton gjendjen gjyqësore. Këto raste janë evidentuar në tabelën bashkëlidhur raportit.

Për 9 punonjës, (për punonjësit *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, ***** dhe *****), në projektraport është kërkuar që, të administrohet në dosjen e personelit në formën e kërkuar nga ligji, diploma e arsimit të lartë.

Nisur nga materiali shkresor nr. 34576 prot., datë 14.11.2016 “Kthim përgjigje”, dhe aktet bashkëlidhur që institucioni i kontrolluar ka dërguar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil rezulton se, për punonjësit *****, *****, *****, *****, *****, ***** dhe *****, njësia e burimeve njerëzore e ka realizuar këtë detyrë sipas rekomandimeve të lëna nga grupi i punës. Punonjësja *****, me urdhrin nr. 17844/2, dt. 24.11.2015, është liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit. Ndërsa punonjësja *****, duhet të dorëzojë dokumentin e njohjes të diplomës nga MAS dhe punonjësi *****, duhet të dorëzojë kopjen e diplomës së arsimit të lartë të vërtetuar nga noteri dhe dokumentin e njohjes së diplomës “Master Shkencor” nga MAS.

Konkluzion: Në këto rrethana, nga mbikëqyrja konstatohet se dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve. Nga ana tjetër, duhet të vijojë puna për të plotësuar dosjen e personelit me të gjitha dokumentet e evidentuara në mungesë, të cilat janë pasqyruar në aneksin përkatës, bashkëlidhur raportit.

IV. Administrimi i shërbimit civil në ish Komunitat, që aktualisht janë Njësi Administrative në përbërje të Bashkisë Tiranë

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se njësitë administrative të Bashkisë së Tiranës (*ish komunat*), në fillim të çdo viti kalendarik/viti financiar, kanë miratuar strukturë organizative të re për administratën dhe punonjësit e tyre.

1. Komuna Petrelë, aktualisht Njësia Administrative Petrelë

Ky subjekt është përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të këtij ligji, kjo njësi e qeverisjes vendore, ka qenë e organizuar dhe funksiononte, mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me vendimin nr. 2, datë 02.04.2014 të këshillit të komunës “Mbi strukturën organizative dhe caktimin e kufijve të pagave për punonjësit e aparatit të komunës, këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave për vitin 2014”. Në pikën 3 të këtij vendimi është përcaktuar se efektet financiare fillojnë nga data 01.02.2014. Më pas ka dalë edhe urdhri nr. 5, datë 14.04.2014, i drejtuesit të komunës “Për emërimin e punonjësve të administratës për vitin 2014”, me të cilin ka miratuar, në mënyrë analitike, punonjësit që do të vazhdonin të qëndronin në detyrë sipas vendeve të miratuara. Mbështetur në këto akte rregullative, struktura organizative e Njesisë Administrative Petrelë, në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, (në dt.26.02.2014) kishte 33 pozicione pune, të organizuara në këtë mënyrë:

- ✓ 4 pozicione pune, kryejnë funksione politike (1 kryetar; 1 zv/kryetar; 1 sekretar; 1 sekretar këshilli);
- ✓ 3 pozicione pune, kryejnë funksione administrative (1 punonjës topograf; 1 elektrikist; 1 magazinier);

- ✓ 3 pozicione, kryejnë funksionet e Inspektoriatit Ndërtimor Vendor;
- ✓ 2 pozicione, kryejnë funksionet e policisë së komunës;
- ✓ **21 pozicione pune, kryejnë funksione të shërbimit civil.**

Konstatohet se, 21 pozicionet e shërbimit civil, janë të kategorisë ekzekutive dhe të ulët drejtuese, dhe këto pozicione përfshijnë pozicionet me emërtesën “Përgjegjës Zyre”, 6 pozicione pune; “Specialist”, 9 pozicione pune; “Administrator i ndihmës ekonomike”, 1 pozicion pune; “Inspektor tatimor”, 2 pozicione pune; “Inxhinier topograf”, 1 pozicion pune; “Jurist”, 1 pozicione pune; “Përgjegjës ujësjellës”, 1 pozicion pune.

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së punonjësve për periudhën 01-28 shkurt 2014, rezulton se nga 21 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, që kishte struktura në fuqi, 13 prej tyre ishin të plotësuar, ndërsa 8 pozicione pune ishin vende të lira. Më konkretisht, vende pune të lira ishin si më poshtë:

- 1 vend, për “Inspektor Tatimor”, në Zyrën e tatim taksave;
- 2 vende në Zyrën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, (1 vend për “Specialist Mjedisi”(inxhinier) dhe 1 vend për “Inxhinier” (topograf);
- 2 vende në Zyrën Juridike (1 pozicion për “Përgjegjës” dhe 1 pozicion për “Jurist”);
- 1 vend për “Përgjegjës” i Zyrës së infrastrukturës publike.
- 1 vend për “Përgjegjës” në Zyrën e administrimit dhe mbrojtjes së tokës.
- 1 vend për “Specialist për emergjencat civile”, në Zyrën e menaxhimit, mbrojtjes së pyjeve, mjedisit dhe emergjencave civile.

Për të arritur në një konkluzion të saktë, nëse njësia përgjegjëse e institucionit i ka kryer procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe brenda afatit të përcaktuar, gjatë procesit të kontrollit u verifikuan dhe analizuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si struktura dhe organika e institucionit që ishte në fuqi në dt. 26.02.2014, listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve për muajin shkurt 2014; dosjet individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (aktet e emërimit, të dhënat lidhur me nivelin e arsimit për çdo punonjës) si dhe, plotësimin e kriterëve për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se:

- Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit 152/2013, institucioni kishte 21 pozicione pune të shërbimit civil, ku 13 prej tyre ishin të zëna dhe 8 ishin vende të lira.
- Njësia përgjegjëse ka verifikuar kohëzgjatjen e periudhës së punësimit dhe plotësimin e kriterit të arsimit të lartë vetëm për 2 punonjës që në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit ishin të punësuar në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil. Në përfundim, në datën 06.10.2014, është lëshuar akti i deklarimit të statusit të punësimit “Nëpunës civil”, në pozicionet e punës ku ata ishin të punësuar.
- Për 11 punonjës, të cilët në datën 26.02.2014, mbanin një pozicion pune të konsideruar pjesë e shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk i ka kryer procedurat e deklarimit të statusit të punësimit. Në këtë rast konstatohet se, 7 punonjës janë me arsim të lartë, (aktualisht 4 janë larguar me dorëheqje), dhe, 4 punonjës janë me arsim të mesëm, nuk plotësojnë

kriterin e nivelit arsimor, në pozicionet e punës ku ata janë emëruar (*aktualisht 2 prej tyre kanë përfunduar marrëdhëniet e punës*).

(*Procedurat e deklarimit të statusit të punësimit janë kryer vetëm për 2 punonjës, të cilët zënë 15 % të rasteve të punësuar në pozicione të shërbimit civil, ndërsa, për 11 punonjës të cilët zënë 75 % të rasteve të punësuar në pozicione të shërbimit civil, procedurat e deklarimit të statusit të punësimit nuk janë kryer*).

I. Raste kur janë kryer procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikua dhe trajtua dokumentacioni që materializonte procedurat e kryera për 2 punonjës të cilëve iu janë kryer procedurat e deklarimit të statusit të punësimit. Në këtë rast bëhet fjalë për punonjësit:

- ***** , me detyrë “Përgjegjës” i Zyrës së Financës, me aktin nr. 1827, datë 06.10.2014, është deklaruar me statusin “Nëpunës civil”. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen individuale të kësaj nëpunëse, u konstatua se, ajo është punësuar në këtë pozicion, që në datën 01.03.2005 dhe ka diplomë të arsimit të lartë (DIND) në Degën Plan, Fakulteti Ekonomi Agrare i Universitetit Bujqësor të Tiranës.
- ***** , me detyrë “Përgjegjës” i Zyrës së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, (*aktualisht i pezulluar për shkak të fillimit të çështjes penale*), me aktin nr. 1827, datë 06.10.2014 është deklaruar me statusin “Nëpunës civil”. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen individuale të këtij nëpunësi, u konstatua se, ai është punësuar në këtë pozicion që në datën 15.05.2007 dhe ka diplomë të arsimit të lartë, në Inxhinieri Agrare, Fakulteti i Bujqësisë i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Konkluzion:

- Konstatohet se, për 2 punonjësit e deklaruar me statusin “Nëpunës civil” procedura e deklarimit të statusit të punësimit është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), pasi në dt. 26.02.2014, punonjësit në fjalë, ishin të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil; periudha e punësimit në të njëjtin pozicion pune ishte më e madhe se një vit dhe plotësojnë kriterin e nivelit të arsimit të lartë.

II. Raste kur nuk u janë kryer procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, për 11 punonjës që në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, institucioni nuk i ka kryer procedurat e deklarimit të statusit të punësimit. Në mënyrë më të detajuar, këto raste paraqiten më poshtë.

a) Punonjës që e plotësojnë kriterin e arsimit të lartë:

- ✓ ***** , me detyrë “Specialist finance” dhe arkëtar, punësuar në këtë pozicion me urdhrin nr. 5, dt. 15.10.2007. Kohëzgjatja e periudhës së punësimit më shumë se një vit. Arsimi i lartë, (Universiteti “Kristal”, DNP në Financë dhe “Master Shkencor” në Financë. Ka mangësi në dokumentacion pasi nuk ka paraqitur diplomën dhe suplementi i diplomës së DNP është fotokopje).

- ✓ *****, me detyrë “*Specialist i Zyrës së Informacionit*”, punësuar në këtë pozicion me urdhrin nr. 20, dt. 31.03.2004. Kohëzgjatja e periudhës së punësimit mbi një vit. Arsimi i lartë (*Universiteti Bujqësor i Tiranës, DIND në Fakultetin Ekonomi Agrare*).
- ✓ *****, me detyrë, “*Specialist Arkivi*”, punësuar në këtë pozicion me kontratën e punës dt. 02.02.2009. Kohëzgjatja e periudhës së punësimit mbi një vit. Arsimi i lartë (*Universiteti i Tiranës, diplomë “Bachelor” në Gjeografi*).
- ✓ *****, me detyrë, ish “*Specialist finance*”. Kohëzgjatja e periudhës së punësimit mbi një vit. *Arsimi i lartë. Ka përfunduar marrëdhëniet e punës në qershor 2015, pasi ka dalë në pension.*
- ✓ *****, me detyrë, ish “*Administrator i Zyrës së Ndihmës Ekonomike*”. *Arsimi i lartë. Ka përfunduar marrëdhëniet e punës, në dt. 02.06.2015.*
- ✓ *****, me detyrë, ish “*Përgjegjës i Zyrës së Planifikimit*”. *Arsimi i lartë. Ka përfunduar marrëdhëniet e punës me dorëheqje në dt. 03.11.2014.*
- ✓ *****, me detyrë, ish “*Specialist i Pyjeve*”. *Arsimi i lartë. Ka përfunduar marrëdhëniet e punës.*

Bazuar në faktet e përmendura më sipër, në projektraport i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që, për punonjësit: ***** dhe ***** të bëjë verifikimin, rast pas rasti, të plotësimin të kriterëve të përcaktuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe për secilin prej tyre të përfundojë procesin duke nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit sipas ligjit.

Nisur nga materiali sqarues nr. 34576 prot., dt. 14.11.2016, dërguar nga subjekti i kontrolluar, konstatohet se, punonjësja ***** është liruar nga detyra me kërkesë të saj, (*akt nr. 527/1, dt. 18.01.2016*); ***** ka ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të suprimimit të vendit të punës, (*akt nr. 3257/2, dt. 01.02.2016*); ***** është sistemuar në pozicionin “*Arkiv Protokoll*”, në Njësinë Administrative Petrelë.

b) *Punonjës që nuk plotësojnë kriterin e diplomës së arsimit të lartë:*

- ✓ *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “*Përgjegjës*” i Zyrës së Tatim Taksave. Aktualisht i punësuar në pozicionin “*Specialist i Pyjeve*”, i vazhdojnë marrëdhëniet financiare edhe në momentin e mbikëqyrjes.
- ✓ *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “*Inspektor Tatimor*”, i vazhdojnë marrëdhëniet financiare edhe në momentin e mbikëqyrjes.
- ✓ *****, me detyrë, ish “*Specialist*” i Zyrës së Planifikimit (*Arkitekt*), ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 10.04.2015, (*sipas borderosë së muajve shkurt dhe mars 2014 rezulton pa diplomë të arsimit të lartë*).

- ✓ *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014, kryente detyrën “Përgjegjës Ujësjiellësi”, ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 25.09.2015.

Punonjësit ***** dhe ***** të konstatuar me arsim të mesëm, nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Plotësimi i kërkesave të posaçme lidhur me nivelin e diplomës dhe profilin e arsimit të lartë që kërkohet për pozicionin përkatës të shërbimit civil, është parashikuar nga shkronja “e”, neni 21, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si një prej kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.

Më tej, vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në pikën 7 përcakton se: “Në rastin kur punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës”.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse nuk ka zbatuar ligjin, pasi për punonjësit ***** dhe ***** duhet të kishin dalë aktet e refuzimit të statusit të punësimit dhe të mos vijonin të punonin në funksione të shërbimit civil.

Për të rregulluar ligjshmërinë, në projektraportin dërguar institucionit është rekomanduar që njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, duke evidentuar faktin se, ata nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civil për shkak të nivelit arsimor (*arsimi i mesëm*) dhe pozicionet e punës të shpallen të lira për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Nisur nga observacionet e institucionit, konstatohet se, në momentin e përgatitjes së raportit përfundimtar, nëpunësit në fjalë kanë përfunduar marrëdhëniet e punës me Bashkinë e Tiranës.

Në mënyrë më konkrete konstatohet se punonjësit:

- ***** me aktin nr. 3257, dt. 01.02.2016 të njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë së Tiranës ka përfunduar marrëdhëniet e punës pasi ka mbushur moshën për pensionin e plotë të pleqërisë.
- ***** me aktin nr. 3257/3, dt. 01.02.2016 ka ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të suprimimit të vendit të punës.

Në këtë rast, në momentin e përfundimit të marrëdhënies së punës, për këta punonjës ka përfunduar edhe situata e parregullt e tyre.

Organizimi i burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes

Njësia administrative e kontrolluar, në momentin e kryerjes së verifikimit funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 2, dt. 16.01.2015 të Këshillit të Komunës Petrelë, “Mbi strukturën organizative dhe caktimin e kufijve të pagave për punonjësit e aparatit të komunës, këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave për vitin 2014/2015”.

Në këtë proces, u vu re se, struktura dhe organika e vitit 2015 ka rikonfirmuar numrin e përgjithshëm të vendeve të punës dhe mënyrën e organizimit të tyre sipas strukturës dhe organikës së miratuar për vitin 2014. Pra, në momentin e mbikëqyrjes, numri i pozicioneve të punës dhe mënyra e organizimit të tyre krahasuar me numrin e pozicioneve të punës dhe mënyrën e organizimit të tyre në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, (*moment i cili është evidentuar në fillim të këtij materiali*) nuk ka pësuar asnjë ndryshim.

Në këto kushte, rezulton se, subjekti i kontrolluar ka **33** pozicione pune gjithsej, nga të cilat **21** prej tyre janë pozicione të shërbimit civil.

Konstatim:

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, konstatohet se, 7 vende pune, janë të plotësuar nga punonjës me kontratë pune, periudha e punësimit ju fillon pas fillimit të efekteve të ligjit 152/2013. Më konkretisht këto vende pune janë pasqyruar në tabelën më poshtë.

Tabelë: Punonjës me kontratë, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit

Nr.	Emërtesa e pozicionit të punës	Punonjësi Emër/Mbiemër	Dt. e fillimit të marrëdhënieve e financiare	Procedura e marrjes në punë
1	Administrator i Zyrës së ndihmës Ekonomike	*****	Dt. 16.10.2015	Kontratë pune
2	Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave	*****	Dt. 01.04.2015	Urdhër i titullarit
3	Inspektor Tatimor	*****	Dt. 23.10.2015	Kontratë pune
4	Përgjegjës i Zyrës së Planifikimit	*****	Dt. 19.11.2014 fillon në pozicionin aktual.	Urdhër nr. 4, dt. 03.03.2014, fillon Përgjegjës i Zyrës së Infrastrukturës.
5	Specialist i Zyrës së Planifikimit të territorit (<i>Arkitekt</i>)	*****	Dt. 23.10.2015	Kontratë pune
6	Përgjegjës i Zyrës Juridike (<i>Jurist</i>)	*****	Dt. 14.04.2014	Urdhër i titullarit
7	Përgjegjës Ujësjetësi	***** (<i>Arsimi i Mesëm</i>)	Dt. 15.10.2015	Kontratë pune

Plotësimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, si më sipër, është bërë në kundërshtim me ligjin, për këtë arsye në projektraportin dërguar institucionit, është rekomanduar që të revokohen aktet e emërimit, pasi për çdo marrëdhënie të re pune, në pozicione që janë pjesë e shërbimit civil, e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm. Pozicionet e punës të konstatohen të lira dhe të plotësohen në përputhje me kërkesat ligjore.

Në lidhje me këtë situatë të parregullt, nisur nga observacionet e institucionit dhe dokumentacioni shoqërues, Komisioneri konstaton se subjekti i kontrolluar ka nxjerrë vendimin përkatës për përfundimin e marrëdhënies së punës për të gjithë këta punonjës.

Në mënyrë më të detajuar vihet re se:

1. *****, me aktin nr. 3246/7, dt. 01.02.2016, ka përfunduar marrëdhëniet e punës me Bashkinë e Tiranës.
2. *****, me aktin nr. 3257/1, dt. 01.02.2016, ka përfunduar marrëdhëniet e punës me Bashkinë e Tiranës.
3. *****, me aktin nr. 3246/8, dt. 01.02.2016, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë e Tiranës.
4. *****, me aktin nr. 21320, dt. 11.12.2015, ka përfunduar marrëdhëniet e punës me Bashkinë e Tiranës.
5. *****, me aktin nr. 21318, dt. 11.12.2015, ka përfunduar marrëdhëniet e punës me Bashkinë e Tiranës.
6. *****, me aktin nr. 2269/1, dt. 29.01.2016, ka përfunduar marrëdhëniet e punës me Bashkinë e Tiranës me kërkesë të saj.
7. *****, me aktin nr. 3246/3, dt. 01.02.2016, ka përfunduar marrëdhëniet e punës me Bashkinë e Tiranës.

Çmohet se, në rastin e punonjësve si më sipër, nga ana e institucionit, janë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i mbikëqyrjes.

2. Komuna Farkë, aktualisht Njësia Administrative Farkë

Ky subjekt është përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (në dt. 26.02.2014), Njësia Administrative Farkë, funksiononte në bazë të strukturës së miratuar me vendimin nr. 2, datë 14.02.2014 të Këshillit të Komunës “Mbi strukturën e administratës publike të Komunës Farkë për vitin 2014 dhe miratimin e fondit të pagave nga të ardhurat e taksave vendore për pagat e administratës për vitin 2014”.

Mbështetur në këtë strukturë, rezulton se kjo njësi ka pasur gjithsej **56 pozicione pune**, të cilat paraqiten të organizuara si më poshtë:

- **20 pozicione pune nuk konsiderohen pozicione pjesë e shërbimit civil.**

Në këtë grupim përfshihen **4** pozicione pune, që kryejnë funksione politike; **1** pozicion pune, që kryen shërbime administrative/sekretari teknike; **5** pozicione pune, që kryejnë funksionet e policisë ndërtimore; **1** pozicion pune, që kryen shërbime administrative shofer; **1** pozicion pune, punonjës i zyrës së gjendjes civile; **8** pozicione, pune që kryejnë funksionet e policisë komunale.

- **36 pozicione pune konsiderohen pozicione pune pjesë e shërbimit civil.**

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, si dhe duke përcaktuar raportin e tyre në lidhje me pozicionet e shërbimit civil, situata paraqitet e tillë:

- Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese, **1** pozicion pune, me emërtesën “Sekretar i Përgjithshëm”, niveli i pagës I-b, ose **3 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil;

- Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese, **5** pozicione pune, me emërtesën “*Drejtor drejtorie*”, niveli i pagës II-b, ose **13 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, **1** pozicione pune, me emërtesën “*Përgjegjës Sektori*”, ose **3 %** e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil;
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **29** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Specialist/Inspektor/Administrator*”; “*Nëndrejtor*”, të kategorizuara në nivelin e pagës III-b. Këto pozicione zënë **80 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil.

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së punonjësve për periudhën 01-28 shkurt 2014, rezulton se nga **36** pozicione pune të shërbimit civil, **28 prej tyre kanë qënë të zëna**, ndërsa **8 pozicione pune kanë qënë vende të lira**.

Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në dosjet individuale të punonjësve, rezulton se, njësia përgjegjëse e komunës, ka realizuar detyrimin për deklarimin e statusit të punësimit për **20 raste**, ndërkohë që për **8 raste** nuk është shprehur.

Në rastin konkret, nisur nga analiza që i është bërë akteve të emërimit, mbështetur në listëpagesën e muajit shkurt 2014, mbi bazën e strukturës së miratuar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, si dhe, nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, rezulton si më poshtë:

- në **18** raste, punonjësit ekzistues që janë të punësuar në të njëjtin vend pune, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, kishin një periudhë punësimi *më shumë se 1 vit* në atë pozicion.

Për këtë kategori punonjësish, njësia përgjegjëse, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si *nëpunës civilë*. Në këtë rast, vlerësohet se, njësia e burimeve njerëzore, ka vepruar drejt në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si “*Nëpunës civilë*” për këtë kategori punonjësish.

- në **2** raste, punonjësit ekzistues, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, kishin një periudhë *më pak se 1 vit* në atë pozicion.

Nga këqyrja dosjeve të personelit rezulton se, momenti i fillimit të efekteve të ligjit të ri, i ka gjetur këta punonjës në një pozicion pune, *ku periudha e punësimit ka qënë më e vogël se një vit*. Për këtë kategori punonjësish, në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, njësia përgjegjëse, është shprehur si më poshtë:

- ***** , “*Specialist inxhinier për ndjekjen e kontratave të punimeve*”, emëruar me aktin nr. 11, datë 23.08.2013, dhe deklaruar *nëpunës civil në periudhë prove* me aktin nr. 2371, datë 15.10.2014,
- ***** , “*Specialist për infrastrukturën dhe sinjalistikën*”, emëruar me aktin nr. 12, datë 23.08.2013, dhe deklaruar *nëpunës civil në periudhë prove* me aktin nr. 2915, datë 10.12.2014.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, në kuptim të nenit 67 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, njësia përgjegjëse, ka vepruar drejt duke i konsideruar nëpunësit e cituar më sipër si nëpunës civilë në periudhë prove.

Nga ana tjetër, njësia përgjegjëse e Komunës Farkë, aktualisht Njësia Administrative Farkë, duhet të kishte vazhduar procedurat e vendimmarrjes në përfundim të periudhës së provës.

Në përmbushje të këtij detyrimi, në projektraport është lënë detyrë që, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, në zbatim të vendimit nr. 510, datë 10.06.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, kreu IV, “Transferimi i personelit”, si një njësi që ka marrë funksionet e organit përgjegjës, duhet të shprehet në lidhje me statusin e dy punonjësve të cituar më sipër.

Nisur nga observacionet e dërguara nga subjekti i kontrolluar, konstatohet se, *****; aktualisht nuk është punonjës i Njesisë Administrative Farkë; *****; me aktin nr. 8128, dt. 19.03.2016 është liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit.

- në 8 raste, njësia përgjegjëse nuk është shprehur në lidhje me deklarin e statusit të punësimi.

Duke i grupuar sipas shkakut të refuzimit të statusit të punësimi, këto raste po i rendisim si më poshtë:

- në 1 rast, ku përfshihet pozicion pune, pjesë e shërbimit civil, është emëruar një punonjës i cili nuk plotëson kriterin e nivelit arsimor, në pozicionin e punës ku është emëruar.

Bëhet fjalë për punonjësin *****; emëruar në pozicionin “Specialist” në Sektorin GIS/Kadastër, me urdhrin nr. 25, datë 25.07.2012.

Në lidhje me këtë rast, konstatohet se, ky punonjës, i cili vazhdon të kryejë detyrat e tij funksionale në shërbimin civil, nuk plotëson kriteret arsimore për të qenë nëpunës civil, për shkak se niveli më i lartë i arsimimit të tij është arsimiti i mesëm.

Niveli arsimor, është një kërkesë e posaçme për pranimin në shërbimin civil, e përcaktuar si një prej kërkesave të përgjithshme, e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se një kandidat për nëpunës civil, duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, që në këtë rast është arsimi i lartë.

Në ato raste kur, punonjësit nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimi për këta punonjës, siç parashikohet në pikën 6, të vendimit nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkluzion: Në këtë rast, konstatohet se njësia përgjegjëse, ka vepruar drejt në lidhje me refuzimin e statusit të punësimit për këtë punonjës, i cili nuk plotëson kriteret arsimore për të qenë nëpunës civil, për shkak se ka nivelin e mesëm të edukimit arsimor.

Por, që të rregullohet situata e paligjshmërisë në këtë rast, në projektraport është rekomanduar që njësia përgjegjëse, të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjës *****, pasi ai nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, për arsye se është me arsim të mesëm.

Nisur nga përmbajtja e observacionit dhe akteve bashkëlidhur tij, të dërguara nga institucioni i kontrolluar, Komisioneri konstaton se punonjësi *****, me aktin nr. 18975, dt. 20.6.2016, i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë e Tiranës.

Çmohet se, në rastin e punonjësit në fjalë, institucioni, ka marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i mbikëqyrjes.

- në 4 raste nuk është deklaruar statusi i punësimit, pasi këta punonjës kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës nëpërmjet dorëheqjes (në 3 raste) dhe për shkak të mungesës së fondeve (1 rast), përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit.

Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

- 1) *****, i emëruar në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit”, me aktin nr. 86, datë 17.12.2013, ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit, në datën 25.03.2014.
 - 2) *****, i emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit GIS/ Kadastër” me aktin nr. 16, datë 15.02.2012, ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit, me aktin nr. 2350, datë 30.10.2014.
 - 3) *****, emëruar në pozicionin “Specialist Pastrim Gjelbërimi” me aktin nr. 16, datë 29.09.2013, ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit, me aktin datë 20.06.2014.
 - 4) *****, emëruar në pozicionin “Specialist për Shërbime Veterinare” me aktin nr. 57, datë 03.12.2012, ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit, me aktin nr. 60, datë 30.09.2014.
- në 1 rast, nuk është deklaruar statusi i punësimit, pasi ky punonjës ka shkëputur marrëdhëniet e punës për shkak të plotësimit të moshës për pension pleqërie, përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit.

Bëhet fjalë për punonjësen *****, emëruar në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Financës”.

Konkluzion: Vlerësohet se, nga njësia përgjegjëse, është vepruar në mbështetje të kërkesave të nenit 65, shkronja “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku parashikohet përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, e në rastin konkret, për shkak të plotësimit të moshës për pension pleqërie.

- në 2 raste, nuk është nxjerrë akti i deklarimit të statusit të punësimit, me pretendimin se pozicioni i punës “*Sekretar i Përgjithshëm*” dhe “*Punonjës arkiv-protokoll*”, nuk konsiderohen si pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Konstatohet se, veprimi i njësisë përgjegjëse, në këtë rast, nuk është bërë në përputhje me kërkesat specifike, që rregullojnë marrëdhëniet e punësimit, në lidhje me këto pozicione pune.

Në kuptim të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, këto pozicione pune kanë qenë dhe vijojnë të mbesin pjesë e shërbimit civil, në kushtet kur realizojnë një funksion publik. Për më tepër, përfshirja e këtyre pozicioneve në shërbimin civil është e përcaktuar edhe në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”. Konkretisht, në lidhjen nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi, “*Përshkrimi i përgjithshëm i punës për çdo kategori dhe klasë*”, në klasën I.1, është renditur pozicioni “*Sekretar i Përgjithshëm*”, si nëpunësi më i lartë civil në institucion.

Në institucionin e mbikëqyrur, me aktin e emërimit nr. 16, datë 29.09.2013, në këtë pozicion është emëruar ******, por, në momentin e mbikëqyrjes, me miratimin e strukturës së re me vendimin nr. 7, datë 13.02.2015, ky pozicion pune është shkurtuar.

Përsa i përket pozicionit të punës “*Specialist Arkive*”, në pikën 9, të VKM-së të cituar më sipër, klasifikohen pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive, sipas natyrës së pozicionit në **a) grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm;** dhe **b) grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.**

Ndërkohë, sipas pikës 12, të këtij akti nënligjor, grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm përcaktohen në lidhjen nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e tij. Më tej, lidhja nr. 3 “*Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës*”, në kolonën e parë, ka renditur grupin e specialistëve të institucioneve të administratës publike, që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, bazuar mbi profesionet përkatëse. Në këtë renditje, rezulton se, në grupin që i përket ndarjes me numër rendor 26, përcaktohet në mënyrë të shprehur emërtesa e pozicionit të punës “specialistë të arkivave”, si pozicione që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil.

Në këtë njësi administrative, në këtë pozicion, është emëruar punonjësja ******, e cila është me arsim të mesëm, për shkak se njësia përgjegjëse pretendon se ky pozicion pune nuk konsiderohet pjesë e shërbimit civil.

Në këtë rast, situata e kësaj punonjëseje do të rivlerësohet, pasi njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, të rishikojë marrëdhënien e këtyre pozicioneve, që funksionojnë në njësitë administrative, në varësi me shërbimin civil si dhe me veprimtarinë e këtij pozicioni, në strukturën e Bashkisë(qendra).

- Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të paplotësuara (vende të lira).

Nga dokumentacioni i administruar në dosje, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, janë konstatuar 8 pozicione pune të paplotësuara dhe konkretisht:

- “Inspektor” + (inventar fizik e magazinë);
- “Administrator Shoqëror”;
- “Inspektor i Tatim Taksave” (2 pozicione);
- “Specialist për problemet e energjisë elektrike”;
- “Specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”;
- “Specialist në Sektorin e Shqyrtimit të Aplikimeve”;
- “Specialist në Drejtorinë Juridike, Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”.

- **Organizimi i burimeve njerëzore në momentin mbikëqyrjes**

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, Njësia Administrative Farkë, funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 7, datë 13.02.2015 të Këshillit të Komunës “Mbi strukturën e administratës publike të komunës për vitin 2015 dhe miratimin e fondit të pagave nga të ardhurat e taksave lokale për pagat e administratës për vitin 2015”.

Në bazë të kësaj strukture, kjo njësi ka gjithsej 43 pozicione pune, nga të cilat 25 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.

Pra, në momentin e mbikëqyrjes, numri i pozicioneve të punës i krahasuar me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, (të cilin e kemi prezantuar në fillim të materialit), ka pësuar ndryshime, të cilat konsistojnë në shkurtimin e pozicioneve të punës me 13 pozicione në numrin e përgjithshëm, nga të cilat 11 pozicione të shkurtuara janë pjesë e shërbimit civil.

Në momentin e verifikimit të realizuar në subjekt, gjatë mbikëqyrjes, është konstatuar se 1 punonjës, është emëruar me akt të përkohshëm emërimi, pas hyrjes në fuqi të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë rast, bëhet fjalë për punonjësin ******, i cili, me aktin nr. 2567, datë 01.11.2014 është emëruar në pozicionin “Specialist për Pastrim Gjelbërimin”.

Për përmirësimin e situatës në këtë rast, në projektraport është rekomanduar që njësia përgjegjëse, të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësin ******, më tej pozicioni i punës të konsiderohet i lirë dhe të plotësohet në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndërkohë, sipas observacioneve të institucionit, dërguar me shkresën nr. 34576 prot., datë 14.11.2016 “Kthim përgjigje” dhe akteve bashkëlidhur tij, Komisioneri konstaton se, punonjësi ******, me aktin nr. 18974, dt. 10.6.2016 ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë e Tiranës, duke zbatuar ligjin në këtë mënyrë.

- **1 punonjës**, është emëruar me transferim të përhershëm nga Këshilli i Qarkut Tiranë.

Bëhet fjalë për punonjësin ******, i cili ka punuar pranë Këshillit të Qarkut Tiranë si “Specialist për Urbanistikën”, në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Infrastrukturës dhe Transportit, i konfirmuar nëpunës civil në këtë pozicion me aktin nr. 3, datë 01.03.2002. Pas ristrukturimit të institucionit, vendi i tij i punës është shkurtuar, dhe për këtë shkak, ai është transferuar në Komunën Farkë, aktualisht Njësia Administrative Farkë, në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit”, me aktin nr. 137/1, datë 16.01.2015.

Nga këqyrja e materialeve konstatohet se, për këtë rast, është ndjekur procedura e *transferimit për shkak ristrukturimi*, e përcaktuar në nenin 50 të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 171, datë 26.3.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, kreu III “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, (i shfuqizuar por që ishte i zbatueshëm në atë moment).

Në rastin konkret, në lidhje me procedurën e transferimit të nëpunësit ***** në këtë komunë, njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Tiranë, ka nxjerrë aktin nr. 16, datë 16.01.2015 për lirimin e tij nga detyra dhe transferimin në Komunën Farkë. Njësia përgjegjëse e komunës, ka nxjerrë urdhrin nr. 137/1, datë 16.01.2015 për emërimin në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit*”, i cili rezulton të ketë qenë vend i lirë. Më pas, me urdhrin nr. 13, datë 06.03.2015, ai është emëruar (*komanduar*) në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit*”.

Ky emërim, në kuptim të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, konsiderohet ngritje në detyrë, e cila është parashikuar në nenin 26, të tij dhe e gjithë procedura që duhet të ndiqej në këtë rast është përcaktuar në vendimin nr. 143, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, (i shfuqizuar, por që ishte i zbatueshëm në atë moment). Nga këqyrja e dokumentacionit, nuk rezulton të jetë ndjekur procedura e përcaktuar në aktet ligjore si më sipër.

Konkluzion: Nga sa më sipër, vlerësohet e rregullt procedura e transferimit të nëpunësit ***** nga Këshilli i Qarkut Tiranë, si rezultat i ristrukturimit dhe emërimi në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit*”, pranë Komunës Farkë.

Ndërsa, emërimi i tij në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit*”, është bërë në kundërshtim me ligjin. Për këtë arsye në projektraport është rekomanduar që njësia përgjegjëse, të revokojë aktin e emërimin në këtë pozicionin. Më tej është kërkuar që pozicioni i punës të shpallet vend i lirë për t’u plotësuar nëpërmjet procedurave konkurruese.

Nisur nga përmbajtja e pikës 6 të materialit shkresor nr. 34576 prot., datë 14.11.2016 “*Kthim përgjigje*”, dërguar nga institucioni i kontrolluar, Komisioneri konstaton se me aktin nr. 18976 prot., datë 20.06.2016 të njësisë përgjegjëse, punonjësi ***** ka kaluar në nivelin “*Specialist*”, i cili është niveli në të cilin i është bërë deklarami i statusit të punësimit.

Pas kësaj me aktin nr. 26505/1 prot, datë 13.09.2016, punonjësi në fjalë është liruar nga shërbimi civil me anë të dorëheqjes.

Në këto kushte, çmohet se, nga ana e institucionit, janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i mbikëqyrjes.

3. Komuna Dajt, aktualisht Njësia Administrative Dajt

Komuna Dajt, aktualisht Njësia Administrative Dajt, është një subjekt i përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (në dt. 26.02.2014), Njësia Administrative Dajt, funksiononte në bazë të strukturës të miratuar me vendimin nr. 1, dt. 14.01.2014 të këshillit komunal “Për miratimin e strukturës organike dhe numrit të nëpunësve të administratës dhe punonjësve të tjerë me kontratë pune të Komunës Dajt për vitin 2014”. Në mbështetje të këtij vendimi ka dalë urdhri nr. 5, datë 31.01.2014 i drejtuesit të komunës “Për vendosjen e drejtuesve e punonjësve të administratës dhe punonjësve të tjerë në vendet e punës sipas strukturës për vitin 2014”, me të cilin ka miratuar strukturën analitike të administratës dhe emrat e punonjësve për çdo pozicion pune.

Mbështetur në këto akte rregullative struktura organizative e Njesisë Administrative Dajt, në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit (në dt, 26.02.2014), kishte në organikë **54** pozicione pune (personel administrate) dhe **99** pozicione pune punonjës të tjerë.

Pozicionet e punës, të grupit personel administrate (55 pozicione gjithsej), paraqiten të organizuara si më poshtë:

- **37** pozicione pune kryejnë funksione të shërbimit civil. (Në mënyrë më të detajuar organizimi i këtyre pozicioneve është: 3 pozicione janë me emërtesën “drejtor drejtorie”; 4 pozicione janë me emërtesën “përgjegjës sektori/përgjegjës zyre”; 30 pozicione janë me emërtesën “specialist”). Pozicionet “drejtor drejtorie” janë të klasifikuar me nivelin e pagës *II-b* ndërsa pozicionet “përgjegjës sektori”/“përgjegjës zyre” dhe “specialist” janë të klasifikuar me të njëjtin nivel page *III-b*.
- 17 pozicione pune konsiderohen si pozicione ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për shërbimin civil. (Në këtë grupim përfshihen 5 pozicione pune që kryejnë funksione politike; 4 pozicione pune që kryejnë funksionet e policisë ndërtimore; 8 pozicione pune që kryejnë funksione administrative (1 arkëtar +1 magazinier + 2 punonjës të mesëm për tatim taksat + 2 punonjës të mesëm topograf për kadastrën urbane dhe sekretarinë teknike + 2 punonjës të mesëm për azhornimin topografik); 1 pozicion pune “Inspektor” i policisë komunare).

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së punonjësve për periudhën 01-28 shkurt 2014 rezulton se, nga 37 pozicione të shërbimit civil që kishte struktura 28 prej tyre kanë qenë të plotësuar. (Rezultoni se, për një vend pune, ishte lidhur kontrata e punës, ndërsa marrëdhënia faktike dhe ajo financiare për vendin e punës ka filluar në dt. 17.03.2014. Bëhet fjalë për pozicionin “Specialist” i nivelit të lartë, për urbanistikën ligjore dhe kontrollin teknik të projekteve. Për këtë pozicion pune, ka një kontratë punësimi nr. 112/1 prot., dt. 16.01.2014 të lidhur ndërmjet ish komunës në cilësinë e punëdhënësit dhe znj. A. Prendi në cilësinë e punëmarrësit, por marrëdhënia faktike dhe ajo financiare me pozicionin e punës ka filluar në dt. 17.03.2014); ndërsa 9 pozicione pune kanë qenë vende të lira. Më konkretisht, vendet e lira evidentohen më poshtë:

- 2 vende për “Specialist” i nivelit të lartë, në Zyrën e Tatim Taksave;
- 1 vend për “Specialist” i nivelit të lartë, çështjet e rinisë, sportit dhe shëndetit;
- 2 vende për “Specialist” i nivelit të lartë, për mbikëqyrjen e shërbimeve dhe të projekteve;
- 2 vende për “Specialist” i nivelit të lartë, për veprimet e administrimit financiar;
- 1 vend për “Specialist” i nivelit të lartë, për mbrojtjen e tokës dhe arkivën kadastrale;

- 1 vend për “*Specialist*” i nivelit të lartë, për administrimin e pyjeve, kullotave e livadheve komunare e mjedisore.

Në datën 28.04.2015, njësia përgjegjëse ka përfunduar procesin e verifikimit, rast pas rasti, të kriterit të punësimit në të njëjtin vend pune për një periudhë më shumë apo më pak se një vit dhe, për 28 nëpunës, (*27 që ishin të punësuar + A. Prendi kishte lidhur kontratë para fillimit të efekteve të ligjit, por ka filluar punë në dt. 17.03.2014*), ka vendosur:

- Për **16** punonjës, të nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit “*Nëpunësi civil*”.
- Për **4** punonjës të nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit “*Nëpunësi civil në periudhë prove*”;
- **2** punonjësve nuk iu është deklaruar statusi i punësimit për mospërputhje të profilit të arsimit të lartë me kërkesat e vendi të punës ku ata janë të punësuar.
- Në **6** raste punonjësit nuk janë përfshirë në procedurat e deklaramit të statusit të punësimit, (*bëhet fjalë për 1 punonjës të punësuar në pozicionin “Specialist i nivelit të lartë i sekretarisë dhe arkivës”; 1 punonjës i punësuar në pozicionin “Specialist i nivelit të lartë operator”, pasi këto vende pune nuk janë konsideruar pjesë e shërbimit civil; 4 punonjës kanë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit para se të kryheshin procedurat e deklaramit të statusit të punësimit*).

Për të arritur në një konkluzion të saktë, nëse njësia përgjegjëse e institucionit i ka kryer procedurat e deklaramit të statusit të punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe brenda afatit të përcaktuar, gjatë mbikëqyrjes u verifikuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si struktura dhe organika e institucionit që ishte në fuqi në dt. 26.02.2014, listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve për muajin shkurt 2014; dosjet individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (*aktet e emërimit, të dhënat lidhur me nivelin e arsimit*) si dhe plotësimin e kriterëve për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

a) Punonjës ekzistues të deklaruar “Nëpunës civil” për shkak të ligjit.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për **16** punonjësit e deklaruar me statusin e punësimit “*Nëpunës civil*”, vëmë re se:

- Për **15** punonjës të deklaruar me statusin “*Nëpunës civil*”, procedura e deklaramit të statusit të punësimit është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”.

Këta punonjës, në dt. 26.02.2014 ishin të punësuar në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil; periudha e punësimit në të njëjtin pozicion pune ishte më e madhe se një vit dhe plotësojnë kriterin e nivelit të arsimit të lartë. (*Në momentin e mbikëqyrjes, u konstatua se, punonjësi Shpëtim Sina i deklaruar me statusin “Nëpunës civil”, në dt. 31.07.2015, ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit për shkak se është emëruar administrator i Njesisë Administrative Shëngjergj*).

Ndërkohë, konstatohet se në **1 rast**, njësia e burimeve njerëzore, në procedurat e ndjekura për deklarimin e statusit të punësimit, nuk ka respektuar kërkesat e ligjit, konkretisht:

- **Punonjësi *******, me aktin nr. 1584/20, dt. 28.04.2015 i është deklaruar statusi i punësimit “*Nëpunës civil*” në pozicionin “*Përgjegjës*”, i Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen individuale u konstatua se, me urdhrin nr. 2296 prot., dt. 23.09.2013 të titullarit të institucionit, punonjësi ***** është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës*”, i Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tojës.

Pra, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit “*Për nëpunësin civil*”, në datën 26.02.2014, ai ishte i punësuar në një pozicion pune të konsideruar pjesë e shërbimit civil, por periudha e punësimit në këtë pozicion ishte më pak se 1 vit dhe për këtë arsye deklarimi i statusit të punësimit duhet të ishte “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.

Për këtë arsye, në projektraportin dërguar institucionit është rekomanduar njësia përgjegjëse, që

- Të revokojë aktin nr. 1584/20, dt. 28.04.2015, me të cilin punonjësit ***** i është deklaruar statusi i punësimit “*Nëpunës civil*” dhe të vendosë për këtë punonjës deklarimin e statusit të punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.
- Njësia përgjegjëse, duhet të kujdeset për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji për nëpunësit civil në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në ASPA, caktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori pas përfundimit të periudhës së provës dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.

Nisur nga sa parashtrohet në pikën 7, të observacioneve të institucionit, dërguar me shkresën nr. 34576 prot., datë 14.11.2016 “*Kthim përgjigje*”, si dhe akteve bashkëlidhur, të dërguara nga subjekti i kontrolluar, Komisioneri konstaton se, me aktin nr. 32644, datë 17.10.2016, të drejtuesit të Bashkisë së Tiranës, është vendosur revokimi i aktit nr. 1584/20, dt. 28.04.2015, për deklarimin e statusit të punësimit “*Nëpunës civil*”, për punonjësin Ilir Qoku, duke u deklaruar statusi i tij “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.

Më tej, në përfundim të trajnimit të detyrueshëm në ASPA dhe pas kryerjes së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës, punonjësi në fjalë, me aktin nr. 13271/2, dt. 10.05.2016 është konfirmuar si nëpunës civil. Në këto kushte, çmohet se, nga ana e institucionit, është rivendosur ligjshmëria, duke e sjellë situatën në gjendje normale.

b) Punonjës ekzistues të deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove” për shkak të ligjit.

Nga verifikimet e kryera në institucion, ka rezultuar se nga **4** punonjës të deklaruar me statusin e punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, në **3** raste, procedurat e deklarimit të statusit të punësimit janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Bëhet fjalë për punonjësit:

- ✓ Petrit Cuka, me detyrë “*Specialist*” i nivelit të lartë për regjistrimin e dokumentacionit, i punësuar me urdhrin nr. 68, dt. 01.07.2013.

Periudha e punësimit më pak se një vit. (Në momentin e hartimit të raportit përfundimtar rezulton se, ky punonjës me urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016, të drejtuesit të bashkisë, është

transferuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila nuk është pjesë e shërbimit civil).

- ✓ *****, me detyrë “*Specialist*” i nivelit të lartë i sekretarisë teknike, infrastrukturës inxhinierike dhe impaktit në mjedis, e punësuar në këtë pozicion me urdhrin nr. 100, dt. 02.10.2013. Periudha e punësimit më pak se një vit.
- ✓ *****, me detyrë “*Specialist*” i nivelit të lartë për administrimin e pyjeve, kullotave e livadheve komunare e mjedisore, i punësuar në këtë pozicion me urdhrin nr. 5, dt. 31.01.2014. Periudha e punësimit më pak se një vit.

Në këto rrethana grupi i punës, në projekt raport ka arritur në konkluzionin se:

- Procedura e deklarimit të statusit të punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, për këta punonjës, është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Njësia e burimeve njerëzore si njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji për nëpunësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASP), caktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori pas përfundimit të periudhës së provës dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.

Ndërkohë, nisur nga përmbajtja e observacioneve të institucionit si dhe provat pjesë e tyre, (pika 6 e këtij materiali), subjekti i kontrolluar njofton Komisionerin se, nëpunësit ***** dhe ***** e kanë përfunduar ciklin e detyrueshëm të trajnimit në ASPA; iu është bërë vlerësimi i rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe është nxjerrë vendimi i eprorit direkt për konfirmimin si nëpunës civil.

(Punonjësi S. Sallaku, deklaruar në kategoritë përkatëse me aktin nr. 13273/2, dt. 10.05.2016 dhe B. Troski, me aktin nr. 13272/2, dt. 10.05.2016).

Në këto rrethana vlerësohet se nga ana e institucionit, janë marrë masa për të rivendosur ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil.

Ndërkohë, konstatohet se në rastin e një punonjësi, njësia e burimeve njerëzore nuk ka respektuar kërkesat e ligjit, e konkretisht bëhet fjalë për punonjësen ***** e cila me aktin nr. 1584/7 prot., dt. 28.04.2015, është deklaruar me statusin “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin “*Specialist i nivelit të lartë për Urbanistikën Ligjore*”.

Nga këqyrja e akteve konstatohet se, për këtë punonjëse ka një kontratë punësimi nr. 112/1 prot., dt. 16.01.2014, të lidhur ndërmjet ish komunës, në cilësinë e punëdhënësit dhe punonjëses në fjalë, në cilësinë e punëmarrësit, por marrëdhënia faktike dhe ajo financiare me pozicionin e punës ka filluar në dt. 17.03.2014. Pra, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit (në dt. 26.02.2014) punonjësja ***** kishte lidhur kontratë punësimi, por marrëdhënia faktike me vendin e punës i ka filluar në dt. 17.03.2014. (Në nenin 8 të kontratës, është parashikuar se efektet financiare do të fillojnë në momentin që do të marrë lejen e lindjes, punonjësja që kryente detyrën e drejtorit të Drejtorisë Juridike).

Çmojmë se, punonjësen A. Prendi, data 26.02.2014 që është edhe data e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, nuk e ka gjetur realisht në pozicionin “*Specialist*” i nivelit të lartë për Urbanistikën Ligjore. Ky konstatim mbështetet në faktin që,

pavarësisht se kontrata e punësimit është lidhur në datën 16.01.2014, marrëdhënia faktike e punës dhe ajo financiare i kanë filluar në dt. 17.03.2014. Këto fakte provohen edhe me listëpagesën e punonjësve të muajve Shkurt dhe Mars 2014.

Në këtë rast për rregullimin e ligjshmërisë, në projektraportin dërguar institucionit, i është rekomanduar njësisë përgjegjëse, që të bëjë revokimin e aktit nr. 1584/7 prot., datë 28.04.2014 “*Akti i deklarimit të statusit të punësimit*” për punonjësen Aldjona Prendi, si “*Nëpunës civil në periudhë prove*” në pozicionin “*Specialist*” i nivelit të lartë për Urbanistikën Ligjore. Ky pozicion duhet të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurrimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

Në lidhje me këtë rast, subjekti i kontrolluar ka dërguar pranë Komisionerit, shkresën nr. 33479/2, dt. 18.11.2016, me të cilën është vendosur lirimi i punonjësës ***** nga detyra “*Specialist Jurist*”, pranë Njesisë administrative Dajt, për arsye se emërimi i saj në këtë detyrë është bërë në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga ligji për nëpunësin civil. Në këto kushte, çmohet se, nga ana e institucionit, është rivendosur ligjshmëria gjatë zbatimit të ligjit për këtë rast.

(Aktet e deklarimit të statusit të punësimit “nëpunës civil”/“nëpunës civil në periudhë prove”, si dhe të dhënat individuale lidhur me kohëzgjatjen e punësimit në të njëjtin vend pune dhe plotësimin e kushteve për të qenë nëpunës civil sipas ligjit janë të materializuara si anekse më vete në Aneksi nr. 1 dhe Aneksi nr. 2 të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti).

c) Punonjës, të cilëve nuk i është deklaruar statusi i punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, është konstatuar se, për 2 punonjës, që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk e nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit. Për këta punonjës, njësia përgjegjëse ka arsyetuar se, profili i arsimit të lartë që ata kanë, nuk përfshihet në fushën e njohurive të përcaktuara si të nevojshme, për realizimin e detyrave që kryejnë, pozicionet e punës ku ata janë të punësuar.

Në mënyrë më të detajuar, bëhet fjalë për këta punonjës:

- 1) ***** , në dt. 26.02.2014 ishte i punësuar në pozicionin “*Specialist i nivelit të lartë për të ardhurat vendore*”, periudha e punësimit në këtë pozicion më pak se një vit, ky është pozicioni i punës që mban edhe në në momentin e mbikëqyrjes. Ka diplomën e arsimit të lartë në Universiteti i Bolonjës, Itali, “*Bachelor*” për Disiplina të Artit, Muzikës dhe Spektaklit.
- 2) ***** , sipas librezës së punës ka qenë i punësuar në këtë njësi që nga dt. 13.06.2011 në pozicionin “*Përgjegjës*” i Zyrës së Shërbimeve. Me vendimin nr. 2, dt. 14.01.2014 është sistemuar në pozicionin “*Specialist i nivelit të lartë tatim taksat*”, periudha e punësimit më e madhe se një vit, ky është pozicioni i punës që mban edhe në

momentin e mbikëqyrjes. Ka diplomën e arsimit të lartë në Universitetin Bujqësor të Tiranës, Inxhinieri Agrare, DIND, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit.

Konstatimet e njësisë përgjegjëse lidhur me profilin e arsimit të lartë që zotërojnë këta punonjës, përputhet me dokumentet e përfshira në dosjet e tyre të personelit.

Vendimi nr. 142, dt. 12.03.2014 i Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, në lidhjen nr. 3 “Klasifikimi i pozicioneve të punës/ sipas profesioneve të punës”, bashkëlidhur tij, ka të përcaktuara profesionet e specialistëve dhe profilin e arsimit të lartë që duhet të ketë aplikanti/ja për institucionet e përfshira në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Për grupin e punës me emërtesën “Specialistë të fushës shoqërore, fetare dhe të tjera” (të renditur me numër rendor 28), është përcaktuar që nevojiten “Ekonomist”, sipas emërtimeve që përmban ky nëngrup dhe të kenë përfunduar studimet e plota në shkencat ekonomike dhe të zotërojnë diplomë “Master Shkencor”, “Master Profesional”, “Bachelor” sipas specifikës së përshkrimit të punës.

Në lidhje me këtë rast, për përmirësimin e situatës, në projektraportin dërguar institucionit, është rekomanduar njësi përgjegjëse që, të hartojë përshkrimet e punës për pozicionet përkatëse dhe nëse këta punonjës, nuk plotësojnë kërkesat e veçanta të vendit të punës, të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punësimit sipas përcaktimeve të vendimit nr. 116, dt. 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreu III “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunat”, pika 7, paragrafi i dytë, ku thuhet se: “Në rastin kur punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës”.

Ndërkohë, nga ana e institucionit, informohemi, se aktualisht, me dëshirën e tyre, punonjësit ***** dhe ***** me urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016, të drejtuesit të bashkisë, janë transferuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila nuk është pjesë e shërbimit civil.

d) Punonjës që nuk janë përfshirë në procedurat e deklaramit të statusit të punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në 6 raste punonjës të cilët në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit ishin të punësuar në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, nuk janë përfshirë në procedurat e deklaramit të statusit të punësimit.

Më konkretisht këto raste janë si më poshtë:

- 2 punonjës, nuk janë përfshirë në procedurat e deklaramit të statusit të punësimit, pasi pozicionet e punës ku ata janë të punësuar nuk janë konsideruar pjesë e shërbimit civil.

Në mënyrë më të detajuar vemë re se:

- ✓ ***** “Specialist” i nivelit të lartë i sekretarisë dhe arkivës, sipas dokumenteve që përmban dosja e personelit është punësuar në këtë njësi, me urdhrin nr.14, dt. 16.03.2007, në detyrën “Specialisti-Arkivist” dhe periudha e punësimit është më e madhe

se një vit, me arsim të lartë, (*Instituti i Lartë Pedagogjik Shkodër, Fakulteti Gjuhë Letërsi*). Aktualisht, punonjësit në fjalë, me urdhrin nr. 18301, datë 14.6.2016, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës si punonjës i arkiv-protokollit.

- ✓ *****, “*Specialist*” i nivelit të lartë operator, sipas dokumenteve që përmban dosja e personelit është punësuar në këtë njësi me urdhrin nr. 40, dt. 19.04.2007, në detyrën “*Operatore*”. Më pas, emërtesa e pozicionit të punës është përshtatur me pozicionin “*Specialist i nivelit të lartë*”. Periudha e punësimit në të njëjtin vend pune është më e madhe se një vit, arsimi i lartë, (*Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, DNP, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Punonjës Social*).

Në projektraportin dërguar instsucionit, është rekomanduar njësia përgjegjëse që, të evidentojë punën dhe detyrat që realizon pozicioni “*Specialist i nivelit të lartë operator*”. Nëse rezulton se, pozicioni i punës në fjalë, kryen punë të ngjashme me specialistët e përfshirë në shërbimin civil, të qartësohet raporti që ka ky pozicion me shërbimin civil, ç’ka realizohet nëpërmjet hartimit të përshkrimit të punës, përcaktimit të kërkesave të veçanta të pozicionit të punës dhe verifikimit të të dhënave që përmban dosja e personelit e punonjësit të punësuar në këtë pozicion, për të konkluduar lidhur me plotësimin ose jo të kriterëve për të qenë nëpunës civil sipas ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Në momentin e hartimit të këtij raporti, rezulton se me urdhrin nr. 7245, datë 04.03.2016 “Për lirim nga shërbimi civil”, punonjësja ***** është liruar nga detyra në kuadër të ristrukturimit të institucionit. Nga përmbajtja e aktit të lirimimit rezulton se punonjësja në fjalë është trajtuar si nëpunës civil, pasi akti i lirimimit nga detyra ka si mbështetje ligjore nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe vendimin nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”.

Pra, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga grupi i mbikëqyrjes, pozicioni “*Specialist i nivelit të lartë operator*”, është rivlerësuar duke u trajtuar si vend i shërbimit civil.

(*Grupet e punës së specialistëve që hyjnë në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, janë të listuara në lidhjen nr. 3 “Klasifikimi i pozicioneve të punës/ sipas profesioneve të punës”, që i bashkëlidhet si pjesë e tij vendimit nr. 142, dt. 12.03.2014 i Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*).

- 4 punonjës nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit, për shkak se i kanë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me njësinë e mbikëqyrur, për arsye të ndryshme ligjore.

Bëhet fjalë për punonjësit :

- 1) *****, “*Specialist*” i nivelit të lartë për vlerësimin e xhiros, ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit, në dt. 31.07.2015, për shkak të mbushjes së moshës për pension.

- 2) *****, ish “*Specialist*” i nivelit të lartë për zyrën e shërbimit veterinar, ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit, në dt. 31.07.2015, për shkak të mbushjes së moshës për pension.
- 3) *****, “*Drejtor*” në Drejtorinë Juridike, ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit në dt. 16.01.2015, për shkak se është transferuar në një institucion tjetër të administratës shtetërore.
- 4) *****, “*Specialist*” i nivelit të lartë për mbrojtjen e tokës dhe arkivës kadastrale, ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit në dt. 19.10.2014, për shkak se është transferuar në një institucion tjetër, (ka kaluar në detyrën drejtor shkolle).

Organizimi i burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes

Njësia administrative objekt mbikëqyrje, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes funksionon në bazë të strukturës të miratuar me vendimin nr. 67, dt. 12.12.2014 të Këshillit të Komunës Dajt, “*Për miratimin e strukturës organike dhe numrit të nëpunësve të administratës dhe punonjësve të tjerë me kontratë pune të Komunës Dajt për vitin 2015*”.

Në mbështetje të këtij vendimi ka dalë urdhri nr. 3, datë 08.01.2015 i drejtuesit të komunës, “*Për vendosjen e drejtuesve e punonjësve të administratës dhe punonjësve të tjerë në vendet e punës sipas strukturës për vitin 2015*”, me të cilin ka miratuar strukturën analitike të administratës dhe emrat e punonjësve për çdo pozicion pune.

Në këtë proces, vihet re se, struktura dhe organika e vitit 2015 ka rikonfirmuar numrin e përgjithshëm të vendeve të punës sipas strukturës dhe organikës së miratuar për vitin 2014. Pra, në momentin e mbikëqyrjes, numri i pozicioneve të punës i krahasuar me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, (të cilin e kemi prezantuar në fillim të materialit) nuk ka pësuar asnjë ndryshim, ndërsa në mënyrën e organizimit vihet re se, është riorganizuar vetëm pozicioni “*Drejtor i Drejtorisë Juridike*”, (nuk ka më pozicion me këtë emërtesë), pasi kjo strukturë nuk plotësonte kriterin e numrit të punonjësve për të qenë e organizuar në nivel drejtorie.

Në këto kushte, konkludohet se, në momentin e mbikëqyrjes, njësia e mbikëqyrur ka 37 pozicione të shërbimit civil, të organizuara në këtë mënyrë: 2 pozicione janë me emërtesën “*drejtor drejtorie*”; 4 pozicione janë me emërtesën “*përgjegjës sektori/përgjegjës zyre*”; 31 pozicione janë me emërtesën “*specialist*”.

Konstatim:

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, konstatohet se, 3 pozicione të shërbimit civil, janë plotësuar nga punonjës të emëruar me kontratë pune, periudha e punësimit, fillon pas fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil. Më konkretisht, emërimet me kontratë paraqiten në tabelën më poshtë.

Tabelë: Punonjës të emëruar në kundërshtim me ligjin

Nr.	Emërtesa e pozicionit të punës	Punonjësi Emër/Mbiemër	Fillimi i marrëdhënieve financiare	Procedura e marrjes në punë
1	Specialist i nivelit të lartë për regjistrimin e	*****	01.12.2014	Urdhër i titullarit

	dokumentacionit			
2	Specialist i nivelit të lartë për mbikëqyrjen e shërbimeve dhe projekteve	*****	01.04.2015	Urdhër i titullarit
3	Specialist i nivelit të lartë për mbikëqyrjen e shërbimeve dhe projekteve	*****	02.02.2015	Urdhër i titullarit

Plotësimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, si më sipër, është bërë në kundërshtim me ligjin, për pasojë për punonjësit ***** , ***** dhe ***** , në projekt raport është rekomanduar që të revokohen aktet e emërimit, pasi për çdo marrëdhënie të re pune në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Në lidhje me këtë situatë të parregullt, nisur nga pika 7, e materialit shkresor nr. 34576 prot., datë 14.11.2016 “Kthim përgjigje”, Komisioneri konstaton se subjekti i kontrolluar ka nxjerrë vendimin përkatës për përfundimin e marrëdhënies së punës për të gjithë këta punonjës.

Në mënyrë më të detajuar vihet re se për punonjësit:

- ✓ ***** , me aktin nr. 19151/1, dt. 11.12.2015, me anë të dorëheqjes, ka përfunduar marrëdhënia e punës me Bashkinë e Tiranës.
- ✓ ***** dhe ***** , me urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016, të drejtuesit të bashkisë, me dëshirën e tyre, janë transferuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila nuk është pjesë e shërbimit civil.

Komisioneri vlerëson se në këtë rast nga ana e institucionit, janë marrë masa për zbatimin e ligjshmërisë, duke rivendosur situatën ligjore.

4. Komuna Zall Bastar, aktualisht Njësia Administrative Zall Bastar

Komuna Zall Bastar, aktualisht Njësia Administrative Zall Bastar, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr.5, datë 13.02.2013, të Këshillit të Komunës “Për miratimin e strukturës së aparatit të komunës për vitin 2013”. Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo njësi kishte gjithsej **19** pozicione pune nga të cilat, **8** pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.

Pozicionet e punës janë të organizuara në këtë mënyrë:

- **3** pozicione pune, janë funksione politike (*1 kryetar + 1 nënkryetar + 1 sekretar këshilli*).
- **8** pozicione, kryejnë veprimtari shërbimi.
- **8** pozicione pune, kryejnë funksione të shërbimit civil.

Konstatohet se, të gjitha pozicionet e shërbimit civil janë të kategorisë ekzekutive dhe në këtë rast bëhet fjalë për pozicionet “Përgjegjës Zyre”, (3 pozicione pune); “Inspektor + Jurist” (5 pozicione pune).

Vërejmë se, më parë, në strukturën dhe organikën e ish komunës, pozicionet e shërbimit civil, nuk kanë qenë të ndara në mënyrë të qartë, nga pozicionet e punës ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil, të tilla si funksionet politike, apo punonjësit administrativë.

- Plotësimi i kushteve ligjore për të përfutur statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij në Njësinë Administrative Zall Bastar.

Mbikëqyrja në këtë subjekt është realizuar mbi bazën e akteve të administruara në dosjen individuale të punonjësve, të sjella nga përfaqësuesi i Njësisë pranë zyrave të KMSHC-së, listëprezencës dhe listëpagesës së punonjësve për periudhën shkurt 2014 dhe shtator 2015.

Mbështetur në këto të dhëna, si dhe nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se:

- në **6 raste**, punonjësit në momentin që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë të punësuar për një periudhë më shumë se 1 vit, në pozicionin e punës ku janë të emëruar, gjithashtu, rezulton se këta punonjës, e plotësojnë kriterin e nivelit arsimor, që është arsim i lartë.
- në **1 rast**, punonjësi, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka qenë në pozicion pune pjesë e shërbimit civil, por më pas është larguar. Aktualisht pozicioni i punës është i lirë.
- në **1 rast**, punonjësi i emëruar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil, nuk plotëson kriterin e nivelit arsimor, për pozicionin e punës ku ai është i emëruar.
Bëhet fjalë për punonjësin *****, emëruar në pozicionin e punës “Inspektor ujësjellësi”. (Aktualisht ky pozicion është pozicion pune shërbimesh në komunë.)

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, njësia përgjegjëse, e Komunës Zall Bastar, e cili ka patur funksionet e njësisë përgjegjëse për t’u shprehur në lidhje me Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimin, për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt, ç’ka do të thotë se njësia përgjegjëse, nuk i ka përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me realizimin e këtij procesi.

- Mënyra e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes

Në momentin e mbikëqyrjes, Njësia Administrative Zall Bastar, funksiononte me strukturën e miratuar me vendimin nr. 11, datë 19.03.2015, të Këshillit të Komunës, “Për miratimin e strukturës së aparatit të komunës për vitin 2015”.

Kjo strukturë ka ndryshuar numrin e pozicioneve të punës të përfshira në shërbimin civil dhe konkretisht, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 ishin **8 pozicione të shërbimit civil**, ndërsa në momentin e mbikëqyrjes janë **7 pozicione të shërbimit civil**. Ndërkohë, rezulton se **1 pozicion** pune, është vend i lirë, bëhet fjalë për pozicionin “Jurist”.

Konstatohet se pozicioni i punës “*Inspektor ujësjellësi*”, që në datën 26 shkurt 2014, përfshihej në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, aktualisht, në strukturë, është përfshirë në pozicione pune që kryejnë shërbime të komunës.

Për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, në projektraport është lënë detyrë që, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, të plotësojë dosjet individuale të punonjësve me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të kryejë verifikimin e plotësimit të kushteve të parashikuara në nenin 67 të ligjit. Pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë statusin e punësimit për secilin prej punonjësve të punësuar në pozicione të shërbimit civil, ndërsa 1 pozicion pune i konstatuar vend i lirë, të plotësohet në përputhje me procedurat e konkurrimit sipas parashikimeve të kuadrit ligjor për nëpunësin civil.

Nisur nga përmbajtja e observacioneve dhe akteve bashkëlidhur tij, të dërguara nga institucioni i kontrolluar, vihet re se nga 7 punonjës të punësuar në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, aktualisht vetëm 3 prej tyre vazhdojnë marrëdhëniet e punës me këtë njësi, ndërsa 4 punonjës të tjerë nuk janë punonjës të njësisë në fjalë.

Më konkretisht, rezulton se komisioni i ristrukturimit, i ngritur në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë së Tiranës, 3 punonjësit që aktualisht vijnë punën në institucion, të cilët janë ***** , ***** dhe ***** , i ka trajtuar si nëpunës civil.

Më tej, konstatohet se njësia përgjegjëse ka konkluduar me nxjerrjen e akteve individuale të transferimit për këta punonjës, si më poshtë:

1. ***** , me aktin nr. 4477, dt. 10.02.2016, është transferuar në pozicionin “*Specialist Finance në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse*” në Njësinë Administrative Zall Bastar;
2. ***** , me aktin nr. 4425, dt. 10.02.2016, “*Për lirim nga shërbimi civil*” është liruar nga shërbimi civil, në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së re të Bashkisë së Tiranës. Më pas me aktin nr. 14061, dt. 9.5.2016, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele është emëruar në pozicionin “*Specialist i Përkrahjes Sociale*”, në Njësinë Administrative Zall-Bastar;
3. ***** , me aktin nr. 4477/1, dt. 10.02.2016, është transferuar në pozicionin “*Specialist në Zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Sektorin e Shërbimeve Publike*”, në Njësinë Administrative Zall Bastar.

Ndërsa për punonjësit më poshtë është vendosur lirimi nga shërbimi civil:

- ✓ ***** , me aktin nr. 4426, dt. 10.02.2016, “*Për lirim nga shërbimi civil*”, është liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit.
- ✓ ***** , me urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016, është transferuar në pozicionin “*Inspektor taksash*”, me dëshirën e saj, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore , njësi që nuk përfshihet në shërbimin civil.
- ✓ ***** , me urdhrin nr. 20461, dt. 01.07.2016, me dëshirën e tij është transferuar pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, që nuk përfshihet në shërbimin civil.
- ✓ ***** , me aktin nr. 3251, dt. 01.01.2016, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të suprimimit të vendit të punës, në kuadër të miratimit të strukturës së re.

Bazuar në faktet si më sipër, pavarësisht faktit që, nuk ka një akt formal të deklarimit të statusit të punësimit nga ana e njësisë përgjegjëse, në procedurat e kryera për transferimin e përhershëm të nëpunësve për shkak të ristrukturimit, si dhe në rastin e emërimit nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, punonjësit janë trajtuar si nëpunës civil.

- Komuna Berzhitë, aktualisht Njësia Administrative Berzhitë

Komuna Berzhitë, aktualisht Njësia Administrative Berzhitë, është një subjekt i përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo njësi e qeverisje vendore, funksiononte në bazë të strukturës, të miratuar me vendimin nr. 2, dt. 03.02.2014 të këshillit komunal “Për miratimin e strukturës organizative të administratës dhe punonjësve të tjerë të Komunës Berzhitë”.

Bazuar në këtë organikë, aparati i Njësisë Administrative Berzhitë, në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, në dt. 26.02.2014, kishte **30 pozicione pune (personel administrate)**; 15 pozicione pune punonjës të tjerë (*Spektori i shërbimeve + pastrim gjelbërim*) dhe 1 pozicion pune Zyra e Gjendjes Civile (*funksion i deleguar*).

Pozicionet e punës, të grupit personel administrate, (*30 pozicione pune gjithsej*), paraqiten të organizuara si më poshtë:

- **20** pozicione pune kryejnë funksione të shërbimit civil. (*Në mënyrë më të detajuar organizimi i këtyre pozicioneve është: 4 pozicione janë me emërtesën “përgjegjës zyre”; 13 pozicione janë me emërtesën “specialist”, 2 pozicione janë me emërtesën e profesionit që kërkon vendi i punës (“Jurist”, “Protokoll-Arkiva), dhe 1 pozicion pune është me emërtesën “Inspektor Veterinar”).* Pozicionet e shërbimit civil janë të klasifikuara me të njëjtin nivel page.
- **10** pozicione pune konsiderohen si pozicione ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për shërbimin civil. (*Në këtë grupim përfshihen 4 pozicione pune që kryejnë funksione politike; 2 pozicione pune që kryejnë funksionet e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik; 4 pozicione pune që kryejnë funksione administrative (1 arkëtar +1 magazinier + 2 pozicione pune Zyra e Policisë Komunare).*

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së punonjësve, për periudhën 01-28 shkurt 2014, rezulton se, nga **20** pozicione të shërbimit civil që kishte struktura, **13** prej tyre kanë qenë të plotësuara, ndërsa **7** vende pune kanë qenë të lira.

Më konkretisht, vende të lira kanë qenë:

- 1 vend për “*Jurist*” për çështjet urbane dhe kontrollin e territorit;
- 1 vend për “*Specialist finance*”;
- 1 vend për “*Specialist IT*”;
- 1 vend për “*Specialist infrastrukture*”;
- 1 vend për “*Specialist kuz*”;
- 1 vend për “*Përgjegjës në Zyrën e Tatim-Taksave*”;

- 1 vend për “*Inspektor Veterinar*”.

Për 13 punonjësit që, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, njësia përgjegjëse ka verifikuar, rast pas rasti, plotësimin e kriterit të punësimit në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se një vit, apo më pak se një vit, dhe ka vendosur si më poshtë:

- Për 2 punonjës, është lëshuar akti i deklarimit të statusit të punësimit “*Nëpunësi civil*”.
- 2 punonjësve, nuk iu është deklaruar statusi i punësimit, për mospërputhje të profilit të arsimit të lartë, me kërkesat e vendit të punës, ku ata ishin të punësuar.
- 5 punonjësve, nuk iu është deklaruar statusi i punësimit për shkak se, nuk plotësojnë kriterin e nivelit arsimor për pozicionet e punës ku ata janë të emëruar, (*janë me arsim të mesëm*).
- Në 4 raste, punonjësit nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, (*në këtë grup përfshihen punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me njësinë e mbikëqyrur, këto raste janë trajtuar në mënyrë më të detajuar në vijim të materialit*).

Për të arritur në një konkluzion të saktë, nëse njësia përgjegjëse e institucionit i ka kryer procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe brenda afatit të përcaktuar, u verifikuan dhe trajtuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si struktura dhe organika e institucionit që ishte në fuqi në dt. 26.02.2014, listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve për muajin shkurt 2014; dosjet individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (*akti i emërimit*) si dhe plotësimin e kriterëve për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

a) Punonjës ekzistues të deklaruar “Nëpunës civil” për shkak të ligjit.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për 2 punonjësit e deklaruar me statusin e punësimit “*Nëpunës civil*” vërehet se:

- ✓ Punonjësja *****, me aktin nr. 737, dt. 19.06.2014 i është deklaruar statusi i punësimit “*Nëpunës civil*” në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Financës dhe Buxhetit*”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen individuale u konstatua se, me urdhrin nr. 9 prot., dt. 30. 01. 2013 të titullarit të institucionit, punonjësja *E. Kapaj*, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës, i Zyrës së Financës dhe Buxhetit*”. Pra, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, *në dt. 26.02.2014*, ajo ishte e punësuar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil, periudha e punësimit ishte më e madhe se një vit, zotëron diplomë të arsimit të lartë (*Universiteti “Ismail Qemali”, DIND në Menaxhim Biznesi, profili “Marketing”*).

Ndërkohë, konstatohet se:

- ✓ Punonjësja *****, me aktin nr. 902 prot., dt. 19.05.2015 i është deklaruar statusi i punësimit “*Nëpunës civil*” në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit*”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, me urdhrin nr. 122 prot., dt. 21.11.2013 të titullarit, punonjësja *****, është emëruar në pozicionin “*Specialist në Zyrën e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit*”. Më pas, me urdhrin nr. 32 prot., dt. 26.02.2014 është emëruar përgjegjëse e kësaj zyre. Zotëron diplomë të arsimit të lartë (“*Albanian University*”, “*Master Shkencor*” në Arkitekturë).

Pra, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit “*Për nëpunësin civil*”, në datën 26.02.2014, ajo ishte e punësuar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil, por periudha e punësimit në këtë pozicion ishte më pak se një vit. Për këtë arsye, deklarimi i statusit të punësimit, duhet të ishte “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.

Për këtë arsye në projektraport është orientuar njësia përgjegjëse, në këtë mënyrë:

- Të revokojë aktin nr. 902, dt. 19.05.2015, me të cilin punonjësja *****, i është deklaruar statusi i punësimit “*Nëpunës civil*” dhe të vendosë për këtë punonjëse deklarimin e statusit të punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.
- Njësia përgjegjëse duhet të kujdeset, për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji, për nëpunësit civil në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në ASPA, caktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori pas përfundimit të periudhës së provës, dhe pas kësaj, të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.

Nisur nga sa parashtrohet në pikën 9 të observacioneve të institucionit si dhe akteve bashkëlidhur, konstatohet se, me aktin nr. 32643, dt. 27.10.2016, të drejtuesit të bashkisë është vendosur revokimi i aktit nr. 902, dt. 19.05.2015 për deklarimin e statusit të punonjësja *****, “*Nëpunës civil*”. Më tej, në përfundim të trajnimit të detyrueshëm në ASPA dhe pas kryerjes së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës, punonjësja në fjalë, me aktin nr. 13452/2, dt. 18.05.2016 është deklaruar nëpunës civil.

Aktualisht, kjo punonjëse ka përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil nëpërmjet dorëheqjes, (akti nr. 3294/1, dt. 07.11.2016).

Sa më sipër, çmohet se, nga ana e institucionit, janë realizuar detyrat e lëna duke rivendosur ligjshmërinë në këtë rast.

b) Punonjës që nuk iu është deklaruar statusi i punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt është konstatuar se, për 7 punonjës, të cilët fillimi e efekteve të ligjit, i gjeti në funksione të shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk e ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit.

Për dy punonjës njësia përgjegjëse ka vlerësuar se, profili i arsimit të lartë që kanë punonjësit, nuk përfshihet në fushën e njohurive, të përcaktuara si të nevojshme, për realizimin e detyrave që kryejnë pozicionet e punës ku ata janë të punësuar.

Në mënyrë më të detajuar, këta punonjës paraqiten si më poshtë:

- 1) *****, me detyrë, “*Përgjegjës në Zyrën e Tatim –Taksave*”.

Bazuar në dokumentacionin që përmban dosja e personelit, ai i ka filluar marrëdhëniet e punësimit, me këtë njësi, që në dt. 09.01.2009, (duke mbajtur funksione të ndryshme, siç janë “Përgjegjës i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun” deri në dt. 11.09.2009, “Inspektor Tatim-Taksash” deri në dt. 12.07.2013, punonjës “Protokollit” deri në prill 2015). Në dt. 26.02.2014, mbante pozicionin e punës punonjës i “Protokollit”, i emëruar që nga dt. 12.07.2013. Periudha e punësimit në të njëjtin vend pune është më e vogël se një vit. Niveli i arsimit, ka përfunduar arsimin e lartë (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, dega “Gazetari”).

2) ***** , me detyrë “Specialist në Zyrën e Çështjeve Sociale dhe Ndhmës Ekonomike”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se, në dt. 26. 02.2014, ishte i punësuar në pozicionin “Specialist në Zyrën e Çështjeve Sociale dhe Ndhmës Ekonomike”, (punësimi në këtë pozicion i fillon që në dt. 09.01.2012). Niveli i arsimit, ka përfunduar arsimin e lartë, (Universiteti Bujqësor i Tiranës, fakulteti i Bujqësisë, “Teknolog Vere”, zotëron DND në Inxhinieri Agrorshqimore).

Në këtë rast, në projekt raport, është arritur në **konkluzionin** se:

- Konstatimet e njësisë përgjegjëse lidhur me profilin e arsimit të lartë që kanë përfunduar këta punonjës, përputhet me dokumentet e përfshira në dosjet e personelit.
- Vendimi nr. 142, dt. 12.3.2014 i Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, në lidhjen nr. 3 “Klasifikimi i pozicioneve të punës/ sipas profesioneve të punës”, bashkëlidhur tij, ka të përcaktuara profesionet e specialistëve dhe profilin e arsimit të lartë që duhet të ketë aplikanti/ja për institucionet e përfshira në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Për këtë arsye, në projektraportin dërguar institucionit, njësia përgjegjëse është rekomanduar që, të hartojë përshkrimet e punës dhe nëse këta punonjës nuk plotësojnë kërkesat e veçanta të vendit të punës, të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punësimit sipas përcaktimeve të vendimit nr. 116, dt. 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreu III “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunat”, pika 7, paragrafi i dytë, ku thuhet se: “Në rastin kur punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunjës civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës”.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në momentin e hartimit të raportit përfundimtar rezulton se, punonjësi ***** , nuk është në pozicionin e mëparshëm pasi me kontratën nr. 4480, dt. 10.02.2016, është emëruar në arkivën e Njesisë Administrative Bërzhitë. (Pozicionet e punës “Arkivist”, njësia përgjegjëse e institucionit nuk i konsideron pjesë e shërbimit civil).

Ndërsa, për pozicionin e punës “Specialist i përkrahjes Sociale”, në të cilin ishte i emëruar punonjësi ***** , njësia përgjegjëse ka hartuar përshkrimin e punës dhe në kërkesat e posaçme, lidhur me nivelin e diplomës dhe profilin e arsimit të lartë është përcaktuar “Diplomë universitare e nivelit Bachelor në Shkenca Shoqërore/Ekonomike/Sociale”, të cilën punonjësi në

fjalë nuk e zotëron. Për këtë arsye me aktin nr. 34094/1, dt. 23.11.2016, është urdhëruar përfundimi i marrëdhënieve financiare.

- Në 5 raste, punonjësit nuk zotërojnë një diplomë të arsimit të lartë. (Niveli më i lartë i arsimit të tyre është arsimi i mesëm). Më konkretisht këta punonjës janë:
 - 1) *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “Specialist për Taksat”, i vazhdojnë marrëdhëniet financiare edhe në momentin e mbikëqyrjes.
 - 2) *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “Specialist për Taksat”, i vazhdojnë marrëdhëniet financiare edhe në momentin e mbikëqyrjes.
 - 3) *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “Specialist topograf”, i vazhdojnë marrëdhëniet financiare edhe në momentin e mbikëqyrjes.
 - 4) *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “Specialist” i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, i ka përfunduar marrëdhëniet e punësimit me urdhrin nr. 19957, dt. 09.12.2015.
 - 5) *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “Specialist” i Zyrës së Gjendjes Civile, i vazhdojnë marrëdhëniet financiare edhe në momentin e mbikëqyrjes.

Në projektraportin dërguar institucionit është konstatuar se, punonjësit: *****, *****, ***** dhe *****, janë me arsim të mesëm, e për këtë arsye nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Plotësimi i kërkesave lidhur me nivelin dhe profilin e arsimit, për pozicionin përkatës, është parashikuar nga neni 21, shkronja “e” e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si një prej kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil. Më tej, vendimi nr. 116, datë 05.03.2014 i Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në pikën 7 përcakton se “Në rastin kur punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës”.

Në këtë rast, konstatohet se, për punonjësit me arsim të mesëm, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil njësia përgjegjëse, duhet të nxirrte aktet për përfundimin e marrëdhënies së punësimit. Për rregullimin e ligjshmërisë në këtë rast, në projektraport është rekomanduar njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, që të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, duke evidentuar faktin se, ata nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civil për shkak të nivelit arsimor (arsimi i mesëm) dhe pozicionet e punës të shpallen të lira për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Nisur nga sa parashtrohet në pikën 9, të observacionit të dërguar nga institucioni, si dhe akteve bashkëlidhur, konstatohet se punonjësit :

- ✓ *****, me urdhrin nr. 19965, dt.09.12.2015, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin.
- ✓ *****, me urdhrin nr. 19966, dt.09.12.2015, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin.

- ✓ ***** , me kontratën nr. 4488, dt. 10.02.2016, është emëruar “Topograf” në Njësinë Administrative Berzhitë, (pozicion pune i cili nuk është pjesë e shërbimit civil).
- ✓ ***** , me urdhrin nr. 19956, dt.09.12.2015, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin.

Sa më sipër, çmohet se, nga ana e institucionit, janë marrë masa për zbatimin e ligjshmërisë, duke rregulluar aspektet me probleme të konstatuara gjatë mbikëqyrjes.

c) Punonjës që nuk janë përfshirë në procedurat e deklaramit të statusit të punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në 4 raste punonjësit nuk janë përfshirë në procedurat e deklaramit të statusit të punësimit, për shkak se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me njësinë e mbikëqyrur.

Këta punonjës janë:

- ✓ ***** , “Përgjegjës” i Zyrës Juridike, në dt. 03.09.2014 ka përfunduar marrëdhënien e punësimit për shkak të pranisë së shkaqeve të parashikuara nga neni 65 shronja “d” e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- ✓ ***** , “Specialist” në Zyrën e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, ka përfunduar marrëdhënien e punësimit, në fund të vitit 2014.
- ✓ ***** , “Specialist” në Zyrën e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, me urdhrin nr. 122, dt. 16.10.2014, ka përfunduar marrëdhënien e punësimit.
- ✓ ***** , “Specialist” në Zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pyjeve, veprave ujore dhe aseteve bujqësore, me urdhrin nr. 12748 prot., dt. 15.09.2015 të titullarit të bashkisë ka përfunduar marrëdhënien e punësimit.

Organizimi i burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes

Njësia administrative objekt mbikëqyrje, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 5, dt. 30.01.2015 të Këshillit të Komunës Berzhitë, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës si dhe punonjësve të tjerë të Komunës Berzhitë”.

Në këtë proces, vihet re se, struktura e vitit 2015 ka miratuar 18 pozicione të shërbimit civil nga 20 që kishte struktura e vitit 2014 dhe janë të organizuara në këtë mënyrë 4 pozicione janë me emërtesën “Përgjegjës Zyre” dhe 14 pozicione janë me emërtesën “Specialist”.

Konstatim:

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, konstatohet se, 2 pozicione të shërbimit civil, janë plotësuar nga punonjës të emëruar me kontratë pune, periudha e punësimit iu fillon pas hyrjes

në fuqi të ligjit 152/2013. Në këtë rast, bëhet fjalë për pozicionin e punës “*Specialist Protokoll-Arkivi*”, me urdhrin nr. 21, dt. 02.02.2015, është punësuar punonjësja ***** dhe pozicioni i punës “*Specialist Mjedisi*”, me urdhrin nr. 61, dt. 14.04.2014 është punësuar punonjësja *****.

Në projektraportin dërguar institucionit është rekomanduar njësia e burimeve njerëzore që, punonjësve ***** dhe *****, t’u revokohen aktet e emërimit, pasi për çdo marrëdhënie të re pune në pozicione që janë pjesë e shërbimit civil, e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm. Pozicionet e punës të konstatohen të lira dhe të plotësohen në përputhje me kërkesat ligjore.

Në momentin e hartimit të raportit përfundimtar, rezulton se për punonjësit:

- ✓ *****, me urdhrin nr. 21884/1, dt. 24.12.2015, kanë përfunduar marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin.
- ✓ *****, me urdhrin nr. 29556/2, dt. 04.11.2016, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin.

Sa më sipër, çmohet se, nga ana e institucionit, janë marrë masa për zbatimin e ligjshmërisë, duke rregulluar aspektet me probleme të konstatuara gjatë mbikëqyrjes.

6. Komuna Krrabë, aktualisht Njësia Administrative Krrabë

Ky institucion, është një subjekt i përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të këtij ligji, kjo njësi e qeverisjes vendore, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organigramës së miratuar me vendimin nr. 4, datë 06.03.2013 të Këshillit të Komunës “*Mbi miratimin e strukturës së aparatit të komunës për vitin 2013*”.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo njësi kishte gjithsej **24** pozicione pune, ku **9** prej tyre, konsiderohen pozicione të shërbimit civil. Konstatohet se, pozicionet e shërbimit civil, përfshijnë pozicionet me emërtesën “*Përgjegjës*”, **2** pozicione pune; “*Specialist*”, **6** pozicione pune; “*Administrator i shërbimit social shtetëror*”, **1** pozicion pune.

Për shkak të numrit të vogël të personelit, megjithëse përdoret emërtesa “*përgjegjës*”, struktura paraqitet e sheshtë, pasi ka vetëm një pozicion pune drejtues dhe të gjithë vendet e tjera i raportojnë drejtuesit.

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së aparatit të njësisë, për periudhën **01-28 shkurt 2014**, rezulton se, në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, **7** pozicione pune të shërbimit civil ishin të plotësuara ndërsa **2** pozicione pune ishin vende të lira (pozicioni “*Specialist veteriner*” dhe pozicioni “*Specialist shërbimi pyjor*”).

Në zbatim të kërkesave të nenit 67, pika 6 e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse e institucionit të mbikëqyrur ka patur detyrim që, për punonjësit të cilët, në datën e shtrirjes së efekteve të ligjit, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, të verifikonte rast pas rasti, plotësimin e kriterit të punësimit në të njëjtin vend pune (*nëse periudha e punësimit ishte jo më të vogël se një vit apo më pak se një vit*) si dhe plotësimin e kriterëve për të qenë nëpunës civil (*nëse punonjësi i plotësonte kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil të përcaktuara në nenin 21 të ligjit*).

Më tej, vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në kreun III, pika 7 ka përcaktuar se, në rastin e komunave, njësia përgjegjëse, pasi bën verifikimin e plotësimit të kriterëve si më sipër, lëshon për çdo punonjës aktin e deklaramit të statusit të punësimit sipas ligjit, *brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi*. Ndërsa, në pikën 2 të kreut IV, është përcaktuar se në çdo rast afati i deklaramit të statusit të punësimit nuk mund të jetë më vonë se data 30 tetor 2014.

(Vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, është botuar në *Fletoren Zyrtare nr. 31, dt. 18.03.2014*. Më pas ka pësuar ndryshime me vendimin nr. 532, dt. 6.8.2014; ndryshuar me vendimin nr. 627, dt. 24.9.2014, por ndryshimet nuk e kanë prekur pikën , që përcakton afatin e deklaramit të statusit të punësimit për rastin e komunave).

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, konstatohet se:

- Njësia Administrative Krrabë, nuk i ka nisur fare procedurat e deklaramit të statusit të punësimit.
 - Në momentin e mbikëqyrjes, kjo njësi është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar me vendimin nr. 5, dt. 25.03.2015 të Këshillit të Komunës, “Mbi miratimin e strukturës së aparatit të komunës për vitin 2015”. Sipas kësaj strukture, kjo njësi ka të miratuara gjithsej 20 pozicione pune, ku vetëm 6 prej tyre konsiderohen pozicione të shërbimit civil.
 - Nga 6 pozicione pune, ndaj të cilëve zbatohet ligji për shërbimin civil, 4 prej tyre janë të plotësuar, (3 punonjës ekzistues + 1 emërim me kontratë pas fillimit të efekteve të ligjit).
- **Situata në lidhje me pozicionet e shërbimit civil dhe punonjësit që janë të punësuar në këto pozicione.**

Më poshtë po paraqesim pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil (*sipas strukturës në fuqi në momentin e verifikimit*) dhe konstatimet për punonjësit e punësuar në këto pozicione.

1) “Përgjegjës i Financës”, mbahet nga punonjësi *****.

Nga dokumentacioni i verifikuar rezulton se, punonjësi ***** është i punësuar në këtë njësi, që nga dt. 31.10.2006 dhe në vazhdimësi ka kryer funksione të zyrës së financës. Periudha e punësimit në këtë pozicion në datën e shtrirjes së efekteve të ligjit, (*në dt. 26.02.2014*), është më e madhe se një vit. Niveli i arsimit, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, DIND në Fakultetin e Ekonomisë.

- 2) “Specialist i MMT”, Shërbimet Agroteknike dhe Shërbimi Pyjor, mbahet nga punonjësi *****.

Nga dokumentacioni i verifikuar rezulton se, punonjësi *****, i kanë filluar marrëdhëniet e punësimit me këtë njësi, me urdhrin nr. 11, dt. 01.10.2013. Periudha e punësimit në këtë pozicion, në datën e shtrirjes së efekteve të ligjit, (në dt. 26.02.2014) është më e vogël se një vit. Niveli i arsimit, Diplomë në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, DNP dhe “Master Shkencor” në Inxhinieri Matematike.

- 3) “Specialist Jurist”, *Emergjenat Civile dhe Burimet Njerëzore*, vend pune i lirë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se, në dt. 26.02.2014 ky pozicion pune, mbahej nga punonjësi *****, i cili me urdhrin nr. 8, dt. 17.04.2015 ka ndërprerë marrëdhënien e punës.

- 4) “Administrator i shërbimit social shtetëror”, *Specialist i Tatim Taksave dhe Shërbimi i Transportit*, mbahet nga punonjësi *****.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit konstatohet se, punonjësi *****, i kanë filluar marrëdhëniet e punës me këtë njësi me urdhrin nr. 5, dt. 03.04.2015. Niveli i arsimit i mesëm.

(Në dt. 26.02.2014 ky pozicion pune mbahej nga *****. Përfundimi i marrëdhënieve të punësimit për këtë punonjëse është bërë nëpërmjet pranisë së shkaqeve të parashikuara nga neni 66 shronja “a” të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- 5) “Përgjegjës i shërbimeve publike” dhe *Magaznier*, vend pune i lirë.

Në dt. 26.02.2014 ky pozicion pune mbahej nga punonjësi *****, i cili me urdhrin nr. 46, dt. 27.04.2015, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës.

- 6) “Specialist Protokollit dhe Arkive”, mbahet nga punonjësja *****.

Nga dokumentacioni i verifikuar rezulton se, punonjësja *Xh. Seitaj*, është e punësuar në këtë njësi me urdhrin nr. 31, dt. 06.10.2011. Periudha e punësimit në këtë pozicion në datën e shtrirjes së efekteve të ligjit, (në dt. 26.02.2014) është më e madhe se një vit. Niveli i arsimit, Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori Filologji, diplomë e nivelit “Bachelor” në degën Gjeografi.

Në këto rrethana, në projekt raportin dërguar institucionit është arritur në **konkluzionin** se:

- Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, punonjësi që mbante pozicionin “*Specialist Jurist + Emergjenat Civile + Burimet Njerëzore*”, pranë ish Komunës Krrabë, ka pasur funksionet e njësisë përgjegjëse për t’u shprehur në lidhje me Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit, për punonjësit që janë në pozicione pjesë e shërbimit civil. Por rezulton se, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt, ç’ka do të thotë se njësia përgjegjëse, nuk i ka përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me realizimin e këtij procesi.

- Për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar në këtë rast, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, duhet që, *së pari*, të plotësojë dosjet individuale me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të kryejë verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe *së dyti*, pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë statusin e punësimit për secilin prej punonjësve të punësuar në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, pranë ish Komunes Krrabë, aktualisht njësi administrative e bashkisë.
- Plotësimi i pozicionit të punës “Administrator i shërbimit social shtetëror + Specialist i Tatim Taksave + Shërbimi i Transportit”, është bërë në kundërshtim me ligjin, për pasojë punonjësit të emëruar në këtë pozicion, duhet t’i revokohet akti i emërimit, pasi për çdo marrëdhënie pune në pozicione pjesë e shërbimit civil, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm. Pozicionet e punës që konstatohen të lira duhet të plotësohen në përputhje me kërkesat ligjore.

Sa më sipër, duke marrë parasysh pikën 2, të observacioneve të dërguara nga subjekti i mbikëqyrur, si dhe nga përmbajtja e akteve bashkëlidhur, Komisioneri konstaton se, për punonjësit :

- ✓ *****, me aktin nr. 6730/1, dt. 29.2.2016, është sistemuar në pozicionin “Specialist Finance, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”, në Njësinë Administrative Krrabë.

Më pas, me aktin nr. 14994, dt. 17.05.2016, në zbatim të procedurave të konkurrimit është emëruar “Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”, në Njësinë Administrative Krrabë.

- ✓ *****, ka përfunduar trajnimin e detyrueshëm në ASPA, i është kryer vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën e provës, dhe më tej, me aktin nr. 21385/1, dt.14.7.2016 “Akti i deklarimit të statusit të nëpunësit në përfundim të periudhës së provës”, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “Specialist për Infrastrukturën në Sektorin e Shërbimeve Publike”, pranë Njësisë Administrative Krrabë.
- ✓ *****, me urdhrin nr. 3245/5, dt. 01.02.2016, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin.
- ✓ *****, me urdhrin nr. 36049, dt. 23.11.2016, ka përfunduar marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin.

Bazuar në faktet që parashtruan më sipër, pavarësisht se për punonjësit ***** dhe *****, nuk ka akt formal të deklarimit të statusit të punësimit, në procedurat e kryera për transferimin e përhershëm të nëpunësve për shkak të ristrukturimit; në kryerjen e procedurave të konfirmimit në përfundim të periudhës së provës, si dhe në rastin e emërimit nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, punonjësit janë trajtuar si nëpunës civil, duke respektuar të drejtat e tyre.

7. Komuna Baldushk, aktualisht Njësia Administrative Baldushk

Ky subjekt është përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të këtij ligji, kjo njësi e qeverisjes vendore, ka qenë e organizuar në bazë të strukturës së miratuar me vendimin nr. 3, datë 12.02.2014 të këshillit të komunës “Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave të administratës dhe shpërblimin e këshilltarëve e kryetarëve të fshatrave”.

Bazuar në këtë organikë, Njësia Administrative Baldushk, në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit (në dt.26.02.2014), kishte 24 pozicione pune, të organizuara në këtë mënyrë:

- 12 pozicione pune konsiderohen pozicione të shërbimit civil.
- 12 pozicione pune klasifikohen si pozicione ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për shërbimin civil. (Në këtë grupim përfshihen: 3 pozicione pune që kryejnë funksione politike; 6 pozicione pune që kryejnë funksione administrative (llogaritar-arkëtar, magazinier + korier, teknik ndërtimi, pastrues, 2 pozicione punonjës i policisë së komunës) dhe 3 punëtorë mirëmbajtje). Në tabelën 1 bashkëlidhur vendimit që miraton strukturën, në kreun IV, pika 3 është renditur pozicioni i punës me emërtesën “Inspektor finance”. Por, dokumentet që kanë dalë në mbështetje të strukturës, siç janë tabela 2, që pasqyron nivelin e pagave për çdo pozicion pune dhe listëprezenca e aparatit të komunës nuk ka pozicion pune me emërtesën “Inspektor finance” por gjendet pozicioni i punës me emërtesën “Llogaritar-arkëtar”, pozicion pune ky që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Konstatohet se, 12 pozicionet e shërbimit civil, përfshijnë pozicionet me emërtesën “Përgjegjës Zyre” (5 pozicione pune); “Specialist” (1 pozicion pune); “Inspektor i pyjeve” (1 pozicion pune); “Administrator i ndihmës ekonomike” (1 pozicion pune); “Inxhinier” (1 pozicion pune); “Punonjës i protokollit dhe arkivës” (1 pozicion pune); “Jurist” (1 pozicion pune) dhe “Veteriner” (1 pozicion pune).

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së punonjësve **për periudhën 01-28 shkurt 2014**, rezulton se pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil, (12 gjithsej sipas strukturës në fuqi), ishin të plotësuar.

Njësia përgjegjëse e institucionit, ka kryer verifikimet lidhur me periudhën e punësimit në të njëjtin vend pune, (nëse periudha e punësimit ishte mbi një vit apo më pak se një vit), si dhe, plotësimin e kriterit të nivelit të diplomës së arsimit të lartë.

Pas kryerjes së këtyre verifikimeve në datën 28.04.2015, njësia përgjegjëse ka lëshuar aktet e deklaramit të statusit të punësimit duke vendosur:

- 5 punonjës të deklarohen me statusin e punësimit “Nëpunës civil”.
- 3 punonjës të deklarohen me statusin “Nëpunës civil në periudhë prove”.
- 1 punonjësi nuk i është deklaruar statusi i punësimit për mospërputhje të profilit të arsimit të lartë me kërkesat e vendit të punës ku ai është i punësuar.
- 2 punonjësve nuk i është deklaruar statusi i punësimit për shkak se nuk plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionet e punës ku ata janë të emëruar (niveli më i lartë i arsimit të tyre është i mesëm).

- Në 1 rast punonjësi nuk është përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, për shkak se ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me njësinë e mbikëqyrur.
(Rastet si më sipër janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në vijim të materialit).

Për të arritur në një konkluzion të saktë, nëse njësia përgjegjëse e institucionit i ka kryer procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit, u verifikuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si struktura dhe organika e institucionit që ishte në fuqi në dt. 26.02.2014, listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve për muajin shkurt 2014; dosja individuale e çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (*akti i emërimit, të dhënat lidhur me nivelin e arsimimit për çdo punonjës të punësuar në pozicione të shërbimit civil*) si dhe, plotësimin e kriterëve për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

a) Punonjës ekzistues të deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil”

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për 5 punonjës të deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil” vëmë re se:

- Për 3 punonjës të deklaruar me statusin “Nëpunës civil”, procedura e deklarimit të statusit të punësimit është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këtë grup përfshihen punonjësit:
 - ✓ *****, me detyrë “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, arsimit i lartë, (*Diplomë në Institutin e Lartë Bujqësor, Fakulteti i Ekonomisë Agrare, dega Financë*).
 - ✓ *****, me detyrë “Përgjegjës” i Zyrës së Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës, arsimit i lartë, (*Instituti i Lartë Bujqësor, Fakulteti i Agronomisë*).
 - ✓ *****, me detyrë “Përgjegjës” i Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, arsimit i lartë, (*Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, dega Financë*).

Nga dokumentacioni i administruar në dosjet e personelit konstatohet se, këta punonjës, në dt. 26.02.2014 ishin të punësuar në pozicione pune, të konsideruara pjesë e shërbimit civil; periudha e punësimit në të njëjtin pozicion pune është më e madhe se një vit dhe kanë një diplomë të arsimit lartë.

Ndërkohë, gjatë përgatitjes së projektraportit nuk mund të arrihej në një konkluzion lidhur me rregullshmërinë e akteve të deklarimit të statusit të punësimit të lëshuara për punonjësit ***** dhe ***** pasi në dosjet e personelit të këtyre punonjësve, nuk ishin të administruara dokumentet që vërtetojnë kohëzgjatjen e periudhës së punësimit, plotësimin e kriterit të nivelit të diplomës së arsimit të lartë, si dhe dokumentet personale që vërtetojnë plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në verifikimin e kryer pranë njësisë së mbikëqyrur, në dt. 30.10.2015, u konstatua sa më poshtë:

- ✓ Punonjësit *****, me aktin nr. 241 prot., dt. 28.04.2015, i është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil” në pozicionin “Përgjegjës” në Zyrën e Shërbimeve. Njësia e mbikëqyrur nuk ka krijuar dosje personeli për këtë punonjës. U arrit të merren të dhëna, vetëm nga librezat e punës dhe listëprezenca e listëpagesa e aparatit të komunës.

- ✓ Punonjës ***** me aktin nr. 240 prot., dt. 28.04.2015 i është deklaruar statusi i punësimit “*Nëpunës civil*” në pozicionin “*Specialist Finance*”. Dosja e personelit e kësaj punonjësje nuk përmban raportin mjekësor që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse; dëshmi penaliteti që të provojë gjendjen gjyqësore; si dhe diploma e arsimit të lartë (*Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë Agrare, dega Ekonomi Agrare*), është fotokopje e pavërtetuar nga noteri.

Duke qenë se, u konstatuan mungesa në dokumentacion, nuk u arrit të provohet, nëse këta punonjës, i plotësojnë ose jo kriteret për të qenë nëpunës civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Për këtë arsye në projektraportin dërguar institucionit u rekomandua njësia e burimeve njerëzore si më poshtë:

- Për punonjësen ***** të administrohej kopja e diplomës së arsimit të lartë dhe lista e notave si dhe raporti mjekësor që vërteton se, është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Për punonjësin ***** duhet që të krijohet menjëherë dosja e personelit në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe kërkesat e vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”. Dosja e personelit të plotësohet me të gjitha të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave të cituar si më sipër.

Gjithashtu u kërkua që dokumentet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara nga noteri dhe të bëhen pjesë përbërëse e dosjes së personelit.

Nisur nga përmbajtja e observacioneve të institucionit, rezulton se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Tiranë, ka marrë masat për plotësimin e dosjeve të punonjësve ***** dhe ***** me diplomën e arsimit të lartë, si dhe të dhënat personale të karakterit teknik e profesional.

Sa sipër, çmohet se, nga ana e institucionit, janë marrë masa për zbatimin e ligjshmërisë, duke rregulluar aspektet me probleme të konstatuara gjatë mbikëqyrjes.

b) Punonjës ekzistues të deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove” për shkak të ligjit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, nga **3 punonjës** të deklaruar me statusin e punësimit “*Nëpunës civil në periudhë*”, në 1 rast, procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Bëhet fjalë për punonjësin ***** me detyrë “*Përgjegjës në Zyrën e Urbanistikës*”, i punësuar në këtë pozicion me urdhrin nr. 10, dt. 21.03.2013. Periudha e punësimit është më pak se një vit, zotëron diplomë të arsimit të lartë në “*Albanian University*”, dhe “*Master Shkencor*” në Arkitekturë.

Në këto rrethana, në projekt raport është arritur në **konkluzionin** se:

Procedura e deklarimit të statusit të punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, për punonjësin *****, është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

- Njësia e burimeve njerëzore si njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji për nëpunësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), caktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori pas përfundimit të periudhës së provës dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.

Ndërkohë, nga ana tjetër, gjatë procesit të verifikimit nuk u arrit në një konkluzion lidhur me rregullshmërinë e akteve të deklarimit të statusit të punësimit të lëshuara për punonjësit ***** dhe *****. Në dosjet e personelit të këtyre punonjësve nuk ishin administruar dokumentet që vërtetojnë kohëzgjatjen e periudhës së punësimit, plotësimin e kriterit të nivelit të diplomës së arsimit të lartë, si dhe dokumentet personale që vërtetojnë plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në verifikimin e kryer pranë njësisë së mbikëqyrur , në dt. 30.10.2015, u konstatua sa më poshtë:

- ✓ *Punonjësi ******, me aktin nr. 243/2 prot., dt. 28.04.2015 i është deklaruar statusi i punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*” në pozicionin “*Veteriner*”.

Në dt. 26.02.2014, ky punonjës mbante pozicionin e punës “*Veteriner*”, marrëdhënia e punësimit me këtë pozicion i fillon me urdhrin nr. 2, dt. 08.02.2013. Por, për këtë punonjës, njësia e mbikëqyrur, nuk ka krijuar dosje personeli. Grupit të mbikëqyrjes iu vu në dispozicion vetëm urdhri i emërimit nr. 2, dt. 08.02.2013 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit me nr.243/2 prot., dt. 28.04.2015.

- ✓ *Punonjësi ******, me aktin nr. 243/1 prot., dt., 28.04.2015, i është deklaruar statusi i punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin “*Jurist*”.

Në dt. 26.02.2014 ky punonjës mbante pozicionin e punës “*Jurist*”, marrëdhënia e punësimit me këtë pozicion i fillon me urdhrin nr. 11, dt. 21.03.2013 si jurist i jashtëm dhe më pas sitemohet si punonjës definitiv. Në dokumentet që duhet të përmbajë dosja e personelit, mungon - akti i emërimit në pozicionin e punës ku është i punësuar; - raporti mjekësor që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën; - dëshmia e penaltetit që të provojë gjendjen e tij gjyqësore; si dhe, - diploma e shkollës së lartë (*DIND në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë*), është fotokopje e panoterizuar.

Listëprezenca dhe listëpagesa e aparatit të komunës për periudhën shkurt 2014, është i vetmi dokument që provon punësimin e këtij punonjësi në një pozicion të shërbimit civil, në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit.

Për punonjësit e konstatuar me mangësi dokumentacioni, ky fakt është pasqyruar në procesverbalin e mbajtur ndërmjet grupit të inspektorëve dhe personit të kontaktit të njësisë së mbikëqyrur, në dt. 30.10.2015, si dhe në tabelën Aneks nr. 2, “*Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në datën 26.02.2014, si*

dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilët janë të administruara në dosjen e mbikëqyrjes”, që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij.

Në projekt raportin dërguar institucionit, për punonjësit ***** dhe *****, i është lënë detyrë njësisë së burimeve njerëzore, që të plotësojë menjëherë dosjet e personelit të këtyre punonjësve. Dokumentet e konstatuar në mungesë t’i dërgohen Komisionerit bashkë me observacionet përklatëse, me qëllim që Komisioneri të arrijë në konkluzione sa më të sakta për këta punonjës.

Ndërkohë, duke u nisur nga observacionet e institucionit, dërguar nga subjekti i kontrolluar, rezulton se për punonjësit:

- ✓ *****, me aktin nr. 6931, dt. 02.03.2016, janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, pasi ka mbushur moshën për pension.
- ✓ *****, me aktin nr. 10762/1, dt. 14.04.2016, “Për lirim nga shërbimi civil”, është liruar nga detyra, me kërkesë të tij.

c) Punonjës që nuk iu është deklaruar statusi i punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, për 3 punonjës, që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk e ka lëshuar aktin e deklarimit të statusit të punësimit.

- Në 1 rast, profili i arsimit të lartë që zotëron punonjësi nuk përputhet me kërkesat e vendit të punës. Në këtë rast, njësia përgjegjëse ka vlerësuar se profili i arsimit të lartë që zotëron punonjësi, nuk përfshihet në fushën e njohurive të përcaktuara si të nevojshme për realizimin e detyrave që kryen pozicioni i punës ku ai është i punësuar.

Bëhet fjalë për punonjësin *****, me detyrë “Përgjegjës” në Zyrën e Tatim –Taksave.

Bazuar në dokumentacionin që përmban dosja e personelit, rezulton se ai ka filluar marrëdhëniet e punës në këtë pozicion pune, në dt. 01.01.2008. Periudha e punësimit në të njëjtin vend pune është më shumë se një vit. Në lidhje me nivelin e arsimit, rezulton se ai ka përfunduar arsimin e lartë në Universitetin Bujqësor të Tiranës, (Fakulteti i Agronomisë, dega e përgjithshme).

Konkluzion:

Në këtë rast, konstatimet e njësisë përgjegjëse lidhur me profilin e arsimit të lartë që zotëron ky punonjës përputhen me dokumentet e përfshira në dosjen e personelit.

Vendimi nr. 142, dt. 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, në lidhjen nr. 3 “Klasifikimi i pozicioneve të punës/sipas profesioneve të punës”, bashkëlidhur tij, ka të përcaktuara profesionet e specialistëve dhe profilin e arsimit të lartë që duhet të ketë aplikanti/ja për institucionet e përfshira në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil dhe ka ngarkuar njësinë përgjegjëse të hartojë përshkrimet e punës.

Nëse ky punonjës nuk i plotëson kërkesat e veçanta të vendit të punës, duhet të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punësimit, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 116, dt. 5.3.2014, të

Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreu III “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunat”, pika 7, paragrafi i dytë, ku thuhet se: “Në rastin kur punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës”.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në momentin e hartimit të raportit përfundimtar rezultoi se, me urdhrin nr. 3026, datë 01.02.2016 “Për transferimin e punonjësve të Njësive Administrative pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore”, punonjësi Xh. Dapi, është transferuar me dëshirën e tij, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore që nuk është pjesë e shërbimit civil, duke rregulluar në këtë mënyrë edhe situatën ligjore.

- Në 2 raste, punonjësit nuk zotërojnë një diplomë të arsimit të lartë. (Niveli më i lartë i arsimimit të tyre është i mesëm).

Më konkretisht këta punonjës janë:

- ✓ *****, niveli i arsimit është i mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “Administrator i Ndihmës Ekonomike”, i vazhdojnë marrëdhëniet financiare edhe në momentin e mbikëqyrjes.
- ✓ *****, niveli i arsimit është i mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “Inspektor Pyjesh”, i ka përfunduar marrëdhëniet e punësimit me urdhrin nr. 12334/2 prot., dt. 30.09.2015 të titullarit të bashkisë me motivacionin “Për mosparaqitje në punë”.

Konkluzion:

- ✓ Për punonjësin *****, konstatohet se, ai është me arsim të mesëm, e për këtë arsye, nuk i plotëson kriteret për të qenë nëpunës civil sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Plotësimi i kërkesave lidhur me nivelin dhe profilin e arsimit, për pozicionin përkatës, është parashikuar nga neni 21, shkronja “e” e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si një prej kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.

Më tej, vendimi nr. 116, date 5.3.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në pikën 7 përcakton se “Në rastin kur punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës”.

Në këtë rast, konstatohet se, për punonjësin me arsim të mesëm, i cili edhe pas fillimit të efekteve juridike të ligjit, ka vijuar të kryejë funksione të shërbimit civil, është vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi për këtë punonjës duhet të kishte dalë akti i përfundimit të marrëdhënies së punës.

Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, në këtë rast, në projektraportin dërguar institucionit i është lënë detyrë njësisë së burimeve njerëzore, që të vendosë përfundimin e marrëdhënies së

punësimi për punonjësin *****, duke evidentuar faktin se, ai nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil për shkak të nivelit arsimor (*arsimi i mesëm*) dhe pozicioni i punës të shpallet i lirë për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në momentin e hartimit të raportit përfundimtar rezulton se, me urdhrin nr. 3250/1, datë 01.02.2016, punonjësit ***** i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për mosplotësim të kërkesave të veçanta të vendit të punës.

Sa më sipër, çmohet se, nga ana e institucionit, janë marrë masa për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me këtë rast.

d) Punonjës që nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimi.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në **1** rast punonjësi nuk është përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimi për shkak se ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me njësinë e mbikëqyrur. Bëhet fjalë për punonjësen *****, ish "*Inxhinier (Arkitekt)*" në Zyrën e Urbanistikës, në dt. 30.06.2014, ka përfunduar marrëdhënien e punës pasi ka plotësuar moshën për pension pleqërie.

Organizimi i burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes:

Njësia administrative objekt mbikëqyrje, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 6, dt. 09.02.2015 të Këshillit të Komunës Baldushk, "*Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave të administratës dhe shpërblimit të këshilltarëve e kryetarëve të fshatrave*".

Në këtë proces, vihet re se organika e vitit 2014, kishte 24 pozicione pune gjithsej ku, 12 prej tyre konsiderohen pozicione të shërbimit civil. Ndërsa, struktura e miratuar për vitin 2015 ka 19 pozicione pune gjithsej ku, 11 prej tyre konsiderohen pjesë e shërbimit civil.

(Janë shkurtuar: 1 pozicion që kryente funksione politike, 3 pozicione për punëtor mirëmbajtje dhe 1 pozicion i shërbimit civil me emërtesën "Inxhinier").

Në momentin e kryerjes së verifikimit, njësia e mbikëqyrur ka **11** pozicione të shërbimit civil. Bazuar në përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*", të gjitha pozicionet e shërbimit civil janë të kategorisë ekzekutive.

8. Komuna Shëngjergj, aktualisht Njësia Administrative Shëngjergj

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, Komuna Shëngjergj, aktualisht Njësia Administrative Shëngjergj, ka qenë e organizuar dhe funksiononte në bazën e strukturës së miratuar me vendimin nr. 1, dt. 06.01.2014, të Këshillit të Komunës "*Për miratimin e strukturës organizative të Komunës për vitin 2014*".

Mbështetur në këtë akt rregullativ, struktura organizative e Njesisë Administrative Shëngjergj, në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, në dt. 26.02.2014, kishte **13** pozicione pune, të organizuara në këtë mënyrë:

- 2 pozicione pune kryejnë funksione politike, (1 kryetar + 1 sekretar këshilli).
- 3 pozicione shërbimesh (1 shofer + 1 polic i komunës + 1 roje i komunës)
- 8 pozicione pune kryejnë funksione të shërbimit civil.

Konstatohet se, të gjitha pozicionet e shërbimit civil pavarësisht emërtesës i përkasin kategorisë ekzekutive. (Pozicionet e shërbimit civil paraqiten me emërtesën Përgjegjës Zyre, K/administrator - 3 pozicione pune dhe Specialist, Urbanist/Administrator/Inspektor/Agjent Tatimor” - 5 pozicione pune).

Vërejmë se, për periudhën objekt mbikëqyrje, në strukturën e njësisë pozicionet e shërbimit civil nuk janë të ndara nga pozicionet e përgjithshme të punës dhe për më tepër, përdoren emërtime të tilla si, “Kryeadministrator”, “Administrator”, “Inspektor”, “Agjent tatimor” apo “arkivist”, kategorizimi i të cilëve në nivelin ekzekutiv të nëpunësve civilë, është realizuar bazuar në karakteristikat e pozicionit të punës. Rezulton se, emërtimet që janë përdorur për pozicionet e punës, nuk gjenden në përputhje me ligjin, ç’ka tregon se njësia përgjegjëse e këtij subjekti nuk është kujdesur për ndarjen e këtyre pozicioneve sipas kërkesave të ligjit.

- Plotësimi i kushteve ligjore për të përfutuar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij në Njësinë Administrative Shëngjergj.

Mbikëqyrja në këtë subjekt është realizuar mbi bazën e akteve të administruara në dosjet e personelit, listëprezencën dhe listëpagesën e punonjësve për periudhën shkurt 2014. Mbështetur në këto të dhëna, si dhe nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se:

- Në 7 raste, punonjësit ekzistues e kanë periudhën e punësimit më shumë se 1 vit.

Në këtë grup punonjësish, 1 punonjës, ***** “Urbanist,Teknik,Topograf”, nuk plotëson kriterin e nivelit arsimor, për shkak se është me arsim të mesëm, gjë që bie ndesh me kushtet e nenit 21, gërma “e”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se një kandidat për nëpunës civil duhet të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, që në këtë rast është arsim i lartë.

- Në 1 rast, punonjësi ekzistues e ka periudhën e punësimit më pak se 1 vit.

Në këtë rast punonjësi nuk plotëson kriterin e nivelit arsimor, për shkak se është me arsim të mesëm, (***** Administrator shoqëror, akti nr.31, dt.22.11.2013).

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, njësia përgjegjëse, e Komunës Shëngjergj, e cila ka patur funksionet e njësisë përgjegjëse për t’u shprehur në lidhje me aktin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësit që janë në pozicione të shërbimit civil, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt, ç’ka do të thotë se njësia përgjegjëse, nuk i ka përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me realizimin e këtij procesi.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar në këtë rast, në projektraportin dërguar institucionit është lënë detyrë që njësia përgjegjëse e Bashkisë

Tiranë, të plotësojë dosjet individuale me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të mundësohet kryerja e verifikimit të plotësimin të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë statusin e punësimit për secilin prej punonjësve të punësuar në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, pranë Komunës Shëngjergj, aktualisht njësi administrative e bashkisë.

Nisur nga përmbajtja e observacioneve të bashkisë, në lidhje me këtë rast, si dhe akteve bashkëlidhur tij, të dërguara nga institucioni i kontrolluar, vëmë re se, njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës, aktualisht ka marrë masat për plotësimin e dosjeve të personelit për punonjësit ***** , ***** , ***** , ***** , dhe ***** . Më tej punonjësve:

***** , me aktin nr. 22488/2, dt. 28.07.2016, i është deklaruar statusi i punësimit nëpunës civil.

***** , me aktin nr. 22488/1, dt. 28.07.2016, i është deklaruar statusi i punësimit nëpunës civil.

Ndërsa, punonjësit ***** dhe ***** , nëpërmjet transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit janë trajtuar si nëpunës civil, (aktet nr. 4509/3, dt. 10.02.2016 dhe nr. 4509, dt. 10.02.2016).

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në momentin e hartimit të raportit përfundimtar, rezulton se 4 punonjës, aktualisht i kanë përfunduar marrëdhëniet e punës me shërbimin civil. Bëhet fjalë për punonjësit :

- ✓ ***** , me urdhrin nr. 6724, dt. 29.02.2016, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare;
- ✓ ***** , me urdhrin nr. 3256, dt. 01.02.2016, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare;
- ✓ ***** , me urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016, është transferuar në pozicionin “Arkëtar Agjent Tatimor”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore , që nuk përfshihet në shërbimin civil.
- ✓ ***** , me urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016, është transferuar në pozicionin “Përgjegjës Taksash”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore , që nuk përfshihet në shërbimin civil.

Në këto rrethana, vlerësohet se në këtë rast është rivendosur situata ligjore, nëpërmjet veprimeve të përshkruara më sipër.

o Mënyra e plotësimin të pozicioneve të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes

Në momentin e mbikëqyrjes, Komuna Shëngjergj, aktualisht Njësia Administrative Shëngjergj, funksionon me strukturën e vitit 2015, e miratuar me vendimin e Këshillit të Komunës nr. 8, datë 20.02.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Komunës për vitin 2015”. Kjo strukturë paraqet ndryshime në numrin e punonjësve, për arsye se, me vendimin nr. 12, datë 21.05.2014, të Këshillit të Komunës, është shtuar 1 punonjës i “Sekretari arkivës”, dhe për shkak të këtij ndryshimi, njësia ka gjithsej 14 pozicione pune, prej të cilave, 9 pozicione janë në shërbimin civil.

Mënyra e plotësimin të 9 pozicioneve të shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes, paraqitet si më poshtë:

- në 8 pozicione pune, janë të punësuar “punonjës ekzistues”.
- në 1 pozicion pune, punonjësi ka filluar marrëdhëniet e punës pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Për këtë punonjës u krye verifikimi i aktit të emërimit të administruar në dosjen individuale dhe u konstatua se punonjësi ***** me aktin nr.12, dt. 21.05.2014 është emëruar Punonjës i Sekretarisë së arkivës, pa u zbatuar procedurat ligjore për pranimin në shërbimin civil.

Në lidhje me punonjësin ***** në projektraport është konstatuar se emërimi i tij, është bërë në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë duhet të revokohet, pasi për çdo marrëdhënie të re pune në pozicione që janë pjesë e shërbimit civil, e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Pas observacioneve të paraqitura nga institucioni, rezulton se punonjësi ***** me kontratën individuale të punës nr. 7321/1, dt. 4.3.2016 është emëruar në detyrën “Arkivist Protokoll”, në Njësinë Administrative Shëngjergj, pozicion pune të cilin njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë nuk e konsideron pjesë të shërbimit civil.

Në këto rrethana, ashtu siç e kemi trajtuar edhe më parë në këtë raport, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, duhet të qartësojë situatën në lidhje me pozicionin e punës “Arkivist Protokoll” pranë njësive administrative në përbërje të saj. Në se, ky pozicion pune nuk do të konsiderohet pjesë e shërbimit civil, kjo duhet të reflektohet edhe në emërtesën e tij, të materializuar në përmbajtjen e strukturës dhe organikës së institucionit.

9. Komuna Vaqarr, aktualisht Njësia Administrative Vaqarr

Ky subjekt përfshihet për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (në dt. 26.02.2014), Njësia Administrative Vaqarr, funksiononte në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 37, dt. 30.12.2013 të këshillit komunal “Mbi strukturën organizative, numrin e personelit dhe nivelin e pagës të punonjësve të Komunës Vaqarr për vitin 2014”. Në mbështetje të këtij vendimi ka dalë urdhri nr. 3, datë 13.01.2014 i drejtuesit të komunës “Për emërimin e punonjësve të administratës së Komunës Vaqarr për vitin 2014”, me të cilin ka miratuar strukturën analitike të administratës dhe emrat e punonjësve për çdo pozicion pune.

Mbështetur në këto akte rregullative Njësia Administrative Vaqarr, në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit (në dt. 26.02.2014), kishte 37 pozicione pune (personel i administratës) dhe 23 pozicione pune punonjës të tjerë (shërbime për mirëmbajtje rrugësh, pastrim plehrash, mirëmbajtje ujësjellësi, mirëmbajtje kuz, ruajtje dhe mirëmbajtje të objekteve dhe shërbimi i ruajtjes së pyjeve).

Pozicionet e punës, të grupit personel administrate, paraqiten të organizuara si më poshtë:

- **25** pozicione pune kryejnë funksione të shërbimit civil. (Në mënyrë më të detajuar organizimi i këtyre pozicioneve është: 7 pozicione janë me emërtesën “përgjegjës zyre”; 15 pozicione janë me emërtesën “specialist”, 2 pozicione janë me emërtesën e profesionit që kërkon vendi i punës (“Arkitekt”, “Arkivist”) dhe 1 pozicion pune është me emërtesën “Inspektor personeli”. Pozicionet e shërbimit civil janë të klasifikuar me të njëjtin nivel page.
- **12** pozicione pune konsiderohen si pozicione ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për shërbimin civil. (Në këtë grupim përfshihen 4 pozicione pune që kryejnë funksione politike; 2 pozicione pune që kryejnë funksionet e policisë ndërtimore; **6 pozicione pune** që kryejnë funksione administrative (1 llogaritar-arkëtar; 1 magazinier; 2 shoferë; 2punonjë të policisë së komunës).

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së punonjësve për periudhën 01-28 shkurt 2014 rezulton se, nga **25** pozicione të shërbimit civil që kishte struktura **22** prej tyre kanë qenë të plotësuar, ndërsa **3** pozicione pune kanë qenë të lira. Më konkretisht, vende të lira kanë qenë:

- 1 vend për “Specialist i Mbrojtjes së Tokave dhe Menaxhimin Kadastral”;
- 1 vend për “Specialist për Taksat Vendore”;
- 1 vend për “Përgjegjës në Zyrën e Shërbimeve Publike”.

Në datën 17.04.2014, njësia përgjegjëse, pasi ka bërë verifikimin, rast pas rasti, të kriterit të punësimit në të njëjtin vend pune për një periudhë më shumë apo më pak se një vit, në përfundim, ka vendosur si më poshtë:

- Për **15** punonjës, ka vendosur deklarin e statusit të punësimit “Nëpunësi civil”.
- Për **4** punonjës, ka vendosur deklarin e statusit të punësimit “Nëpunësi civil në periudhë prove”. (Nënvizojmë se, të katër punonjësit e përfshirë në këtë grup i kanë filluar marrëdhëniet e punës me institucionin pas hyrjes në fuqi të ligjit).
- **3** punonjësve, nuk iu është deklaruar statusi i punësimit për shkak se nuk plotësojnë kriterin e nivelit arsimor për pozicionet e punës ku ata janë të emëruar (janë me arsim të mesëm).
- Në **4** raste, punonjësit nuk janë përfshirë në procedurat e deklarinimit të statusit të punësimit, (në këtë grup përfshihen punonjësit e punësuar në pozicionin “Përgjegjës Zyre Sekretari Arkivi” dhe pozicionin “Arkivist” pasi këto vende pune nuk janë konsideruar pjesë e shërbimit civil; dhe, 2 punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me njësinë e mbikëqyrur, këto raste janë trajtuar në mënyrë më të detajuar në vijim të materialit).

Për të arritur në një konkluzion të saktë, nëse njësia përgjegjëse e institucionit i ka kryer procedurat e deklarinimit të statusit të punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit, u verifikuan dhe analizuan të gjitha materialet shpresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si struktura dhe organika e institucionit që ishte në fuqi në dt. 26.02.2014, listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve për muajin shkurt 2014; dosjet individuale të çdo

punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (*aktet e emërimit, të dhënat lidhur me nivelin e arsimit për çdo punonjës*) si dhe plotësimi i kriterëve për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

a) Punonjës aktual të deklaruar “Nëpunës civil” për shkak të ligjit.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për **15** punonjësit e deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil” vërejmë se:

- Për **13** punonjës të deklaruar me statusin “Nëpunës civil”, procedura e deklarimit të statusit të punësimit është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Këta punonjës, në dt. 26.02.2014 ishin të punësuar në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil; periudha e punësimit në të njëjtin vend pune është jo më e vogël se një vit.

Ndërkohë, konstatohet se në **2 raste**, njësia e burimeve njerëzore në procedurat e ndjekura për deklarimin e statusit të punësimit nuk ka respektuar kërkesat e ligjit, konkretisht:

- ✓ Punonjësi *****, me aktin nr. 982, dt. 17.04.2014, është deklaruar “Nëpunës civil” në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës Juridike”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen individuale u konstatua se, me kontratën nr. 7 prot., dt. 06.01.2014, punonjësi ***** është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës Juridike”.

- ✓ Punonjësja *****, me aktin nr. 982, dt. 17.04.2014 i është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil” në pozicionin “Specialist në Zyrën Juridike”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen individuale u konstatua se, me kontratën nr. 2249 prot., dt. 29.08.2013, punonjësja ***** është emëruar në pozicionin, “Specialist i Zyrës Juridike”.

Pra, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, (në dt. 26.02.2014), këta punonjës ishin të punësuar në një pozicion pune të konsideruar pjesë e shërbimit civil, por periudha e punësimit në pozicionet ku ata ishin të punësuar, ishte më pak se një vit. Për këtë arsye deklarimi i statusit të punësimit duhet të ishte “Nëpunës civil në periudhë prove”.

Me qëllim që të rregullohet situata në këtë rast, në projektraportin dërguar institucionit është rekomanduar njësia përgjegjëse që, të kryejë veprimet e mëposhtme:

- Të revokojë aktin nr. 982, dt. 17.04.2014, me të cilin punonjësi *****, është deklaruar “Nëpunës civil” dhe për këtë punonjës të vendoset deklarimi i statusit të punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”.
- Të revokojë aktin nr. 982, dt. 17.04.2014, me të cilin punonjësja *****, është deklaruar “Nëpunës civil” dhe për këtë punonjës të vendoset deklarimi i statusit të punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”.

- Njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji për nëpunësit civil në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në ASPA, caktimin e një punonjësi më të vjetër për t'u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori pas përfundimit të periudhës së provës dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.

Në vazhdim të mbikëqyrjes pranë Bashkisë së Tiranës, ky institucion me anë të materialit shkresor nr. 34576 prot., datë 14.11.2016 “*Kthim përgjigje*”, dhe akteve bashkëlidhur tij, njofton Komisionerin se ka marrë masa në përgjigje të rekomandimeve të lëna në projektraport. Më konkretisht rezulton se njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës, për punonjësit ***** dhe ***** ka revokuar aktet e deklarimit të statusit të punësimit dhe ka mundësuar kryerjen e detyrimeve të periudhës së provës, të tilla si trajnimi i detyrueshëm në ASPA dhe vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën e provës.

Në përfundim të këtyre procedurave rezulton se për punonjësit:

- ***** , me aktin nr. 18578/2, dt. 06.07.2016, është deklaruar si nëpunës civil.
- ***** , me aktin nr. 18577/2, dt. 06.07.2016, është deklaruar si nëpunës civil.

Konstatim: Në momentin e mbikëqyrjes, u konstatua se, 2 punonjës të deklaruar me statusin e punësimit “*Nëpunës civil*”, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit. Bëhet fjalë për punonjësit:

- ✓ ***** , të cilit me aktin nr. 982, dt. 17.04.2014 i është deklaruar statusi “*Nëpunës civil*” në pozicionin “*Specialist topograf (kadastra urbane)*” dhe aktualisht i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në dt. 14.09.2015, më dorëheqje nga detyra.
- ✓ ***** , e cila me aktin nr. 982, dt. 17.04.2014, i është deklaruar statusi “*Nëpunës civil*”, në pozicionin “*Inspektor personeli*” dhe aktualisht i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në dt. 03.04.2015.

b) Punonjës ekzistues të deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove” për shkak të ligjit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, 4 punonjësve iu është deklaruar statusi i punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”. Në këtë rast, bëhet fjalë për punonjësit:

- 1) ***** , me aktin nr. 982, dt. 17.04.2014 është deklaruar me statusin e punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*” në pozicionin “*Specialist i Mbrojtjes së Tokave dhe Menaxhimit Kadastral*”.

Nga këqyrja e akteve konstatohet se, pozicioni “*Specialist i Mbrojtjes së Tokave dhe Menaxhimit Kadastral*”, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka qenë vend i lirë, por, pas hyrjes në fuqi të ligjit, në këtë pozicion është emëruar punonjësi ***** , me urdhrin nr. 24, datë 26.03.2014, të drejtuesit të institucionit.

- 2) ***** , me aktin nr. 982, dt. 17.04.2014 është deklaruar me statusin e punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*” në pozicionin “*Specialist për Taksat Vendore*”.

Nga këqyrja e akteve konstatohet se, pozicioni “*Specialist për Taksat Vendore*”, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka qenë vend i lirë, por, pas hyrjes në fuqi të ligjit, në këtë pozicion është emëruar punonjësi ***** , me urdhrin nr. 24, datë 26.03.2014 të drejtuesit të institucionit.

- 3) *****, me aktin nr. 982, dt. 17.04.2014 është deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “Inspektor Personeli”.

Nga këqyrja e akteve konstatohet se, punonjësja *****, ka filluar marrëdhëniet e punësimit me këtë pozicion pune me kontratën nr. 735 prot., dt. 26.03.2014.

Pozicioni “Inspektor Personeli”, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, mbahej nga punonjësja *****, e cila në dt. 26.03.2014, ka filluar lejen e lindjes dhe në përfundim të saj ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit në dt. 03.04.2015.

- 4) *****, me aktin nr. 982, dt. 17.04.2014 është deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve dhe Punëve Publike”.

Nga këqyrja e akteve konstatohet se, pozicioni “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve dhe Punëve Publike”, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka qenë vend i lirë, por, pas hyrjes në fuqi të ligjit, në këtë pozicion është emëruar punonjësja *****, me urdhrin nr. 24, datë 26.03.2014 të drejtuesit të institucionit .

Konkluzion: Sa më sipër, konstatohet se aktet për fillimin e marrëdhënieve të punës, që kanë lidhje me momentin e emërimit të punonjësve *****, *****, ***** dhe ***** kanë dalë në kundërshtim me ligjin dhe si të tillë duhet të revokohen, pasi për pozicionet e shërbimit civil, për çdo marrëdhënie pune e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm. Pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil të konstatohen të lira dhe të plotësohen në përputhje me kërkesat e ligjit.

Në përgjigje të këtyre rekomandimeve, njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës ka marrë masat për rregullimin e ligjshmërisë. Rezulton se :

- ✓ Punonjësi *****, me aktin nr. 33474/1, dt. 16.11.2016, të njësisë përgjegjëse të Bashkisë së Tiranës, është liruar nga detyra për shkak se emërimi i tij në një pozicion të shërbimit civil është bërë në kundërshtim me procedurat e pranimit në shërbimin civil. (Më pas ky punonjës i është nënshtruar procedurave të konkurrimit, dhe është emëruar me aktin nr. 37998, dt. 12.12.2016).
- ✓ Punonjësi *****, me urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016, është transferuar në pozicionin “Specialist Taksash”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore , me dëshirën e tij, pozicion që nuk përfshihet në shërbimin civil.
- ✓ Punonjësi *****, me urdhrin nr. 33475, dt. 03.11.2016, është larguar nga puna, nëpërmjet revokimit të kontratës së punës nr. 735, dt. 26.03.2014, si dhe revokimit të aktit nr. 4495/1, dt. 10.02.2016 “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, për shkak se emërimi në një pozicion të shërbimit civil është bërë në kundërshtim me procedurat e pranimit në shërbimin civil.

- ✓ Punonjësi *****, me urdhrin nr. 33476, dt. 03.11.2016, është larguar nga puna, nëpërmjet revokimit të kontratës së punës nr. 24, dt. 26.03.2014 si dhe revokimit të aktit nr. 4495, dt. 10.02.2016 “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, për shkak se emërimi në një pozicion të shërbimit civil është bërë në kundërshtim me procedurat e pranimit në shërbimin civil.

(Aktet e deklaramit të statusit të punësimit “nëpunës civil”/“nëpunës civil në periudhë prove”, si dhe të dhënat individuale, lidhur me kohëzgjatjen e punësimit në të njëjtin vend pune dhe plotësimin e kushteve për të qenë nëpunës civil sipas ligjit, janë të materializuara si anekse më vete në Aneksi nr. 1 dhe Aneksi nr. 2, të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti).

c) Punonjës që nuk iu është deklaruar statusi i punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, për 3 punonjës, që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk e ka deklaruar statusin e punësimit. Në këtë grup përfshihen 3 punonjës që nuk plotësojnë kriterin e diplomës së arsimit të lartë:

Në mënyrë më të detajuar, këta punonjës paraqiten si më poshtë:

- ✓ *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “*Specialist Kadastro*”. Marrëdhëniet e punësimit me këtë pozicion pune i vazhdojnë edhe në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes.
- ✓ *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “*Specialist për Taksat Vendore*”. Marrëdhëniet e punësimit me këtë pozicion pune i vazhdojnë edhe në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes.
- ✓ *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “*Specialist për Taksat Vendore*”. Marrëdhëniet e punësimit me këtë pozicion pune i vazhdojnë edhe në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes.

Punonjësit *****, ***** dhe *****, janë me arsim të mesëm, e për këtë arsye, nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil sipas ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Plotësimi i kërkesave lidhur me nivelin dhe profilin e arsimit, për pozicionin përkatës, është parashikuar nga neni 21, shkronja “e” e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar si një prej kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.

Më tej, vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*”, i ndryshuar, në pikën 7 përcakton se, “*Në rastin kur punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës”.

Në këtë rast, konstatohet se, për punonjësit me arsim të mesëm, të cilët kanë vijuar të punojnë në pozicione të shërbimit civil, njësia përgjegjëse, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi për këta punonjës duhet të kishin dalë aktet për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Për këtë arsye, që të rregullohet situata e paligjshmërisë, në projektraport është lënë detyrë që, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punës për këta punonjës, duke evidentuar faktin se, ata nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë për shkak të nivelit arsimor (*arsimi i mesëm*) dhe pozicionet e punës të shpallen të lira për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Në përgjigje të këtyre rekomandimeve, në momentin e hartimit të raportit përfundimtar rezulton se:

- ✓ punonjësi *****, me kontratën nr. 6729, dt. 29.02.2016 është emëruar në detyrën “*Topograf*”, pranë Njesisë Administrative Vaqar, pozicion pune i cili nuk është pjesë e shërbimit civil.
- ✓ punonjësit *****, me urdhrin nr. 5887, dt. 23.02.2016, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye të mosplotësimit të kriterit të nivelit të arsimit.
- ✓ Punonjësit *****, me urdhrin nr. 5888, dt. 23.02.2016, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye të mosplotësimit të kriterit të nivelit të arsimit.

d) Punonjës që nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në 4 raste punonjës të cilët në momentin e fillimit të efekteve të ligjit ishin të punësuar në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Më konkretisht këto raste janë për punonjësit si më poshtë:

- 1) *****, me detyrë, “*Përgjegjës Zyre, Sekretari Arkivi*”, Zyra e Administratës.

Sipas dokumenteve që përmban dosja e personelit, vëmë re se, punonjësja *Elona Taku*, është punësuar në këtë njësi me kontratën e punësimit nr. 10, dt. 04.01.2012 si “*Përgjegjës Zyre + Protokoll*”, në Zyrën e Administratës. Në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës për vitin 2014, emërtesa e pozicionit të punës ka ndryshuar duke u bërë “*Përgjegjës Zyre Sekretari Arkivi*”. Në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, në dt. 26.02.2014, periudha e punësimit në të njëjtin vend pune është më e madhe se një vit. Niveli i arsimit i lartë. (Në momentin e hartimit të raportit përfundimtar rezulton se, punonjësja *****, me kontratën nr. 6729/6, dt. 29.02.2016 është emëruar në detyrën “*Arkiv - Protokoll*”, pozicion pune të cilin, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, për njësitë administrative, nuk e konsideron pjesë të shërbimit civil. Ky problem do të trajtohet ashtu si e kemi orientuar më sipër).

- 2) *****, me detyrë “*Arkivist*”.

Nga verifikimi i dokumenteve të vëna në dispozicion, vëmë re se, punonjësja *Mirena Koçi* është punësuar në këtë njësi, që në vitin 2011. Në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, në dt. 26.02.2014, periudha e punësimit në të njëjtin vend pune është më e madhe se një vit. Niveli i arsimit i lartë. (Aktualisht, rezulton se punonjësja *****, me aktin nr. 4495/8, dt. 10.02.2016 “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*” është transferuar në

pozicionin “Specialist i Shërbimeve Publike në Sektorin e Shërbimeve Publike”, pranë Njesisë administrative Vaqarr. Pra këtë punonjëse, komisioni i ristrukturimit e ka trajtuar si nëpunës civil).

Bazuar në faktet si më sipër, arrihet në përfundimin se:

- Pozicioni i punës “Përgjegjës Zyre, Sekretari Arkivi”, në Zyrën e Administratës, (që mbante punonjësja *****), nisur nga emërtesa, rezulton se ai ishte i dedikuar për “Përgjegjës i Zyrës së Administratës”, pasi fokusi kryesor i tij ishte kryerja e detyrave si përgjegjës i administratës, ndërsa “Sekretari Arkivi” ishte detyrë shtesë. Për këtë arsye, ky pozicion pune duhet të ishte trajtuar si pozicion i shërbimit civil.
- Për pozicionin e punës “Arkivist”, nënvizojmë se, grupet e punës së specialistëve që hyjnë në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, janë të renditura në lidhjen nr. 3 “Klasifikimi i pozicioneve të punës/ sipas profesioneve të punës”, që i bashkëlidhet si pjesë e tij vendimit nr. 142, dt. 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Në ndarjen me numër rendor 26, në kolonën e dytë dhe të pestë përmendet në mënyrë të shprehur emërtesa e pozicionit të punës specialist i arkivave/arkivist, në njësitë vendore në përputhje me legjislacionin përkatës të arkivave.
- Njësia përgjegjëse të rivlerësojë pozicionin e punës “Arkiv - Protokoll”, në njësitë administrative, ashtu si e kemi analizuar më sipër. Në varësi të vendimmarrjes së institucionit për këto raste, duhet të vijojnë edhe procedurat e verifikimit, lidhur me plotësimin e kriterëve të përcaktuara në nenin 67 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe vendimin nr. 116, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- 2 punonjës nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit, për shkak se, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me njësinë e mbikëqyrur.

Bëhet fjalë për punonjësit:

- ✓ *****, me detyrë, ish “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit në dt. 29.09.2014, larguar me dorëheqje.
- ✓ *****, me detyrë, ish “Specialist i Mirëmbajtjes së Rrjetit të Ujësjetës”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punësimit në dt. 01.06.2014, për shkak të mbushjes së moshës për pension.

Konkluzion: Vlerësojmë se, përfundimi i marrëdhënieve të punës për këtë grup punonjësish është bërë nëpërmjet pranisë së shkaqeve të parashikuara nga neni 65 shkronja “c” dhe 66, shkronja “dh” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konstatim:

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes në Njësinë Administrative Vaqarr, u konstatua se, aktet e deklarimit të statusit, për 19 nëpunësit që janë përfshirë në procesin e deklarimit, janë protokolluar me nr. 982 prot., dt.17.04.2014, pra janë regjistruar në regjistrin e korrespondencës me të njëjtin numër protokoll dhe në të njëjtën datë. Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të kishte parasysh faktin se ky akt, është një akt administrativ individual, pasi për secilin nëpunës, rregullon një çështje të posaçme, që në rastin konkret është deklarimi i statusit të punësimit, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit.

Regjistrimi me të njëjtin numër protokoll dhe në të njëjtën datë, i të gjithë akteve të deklarimit, sjell vështirësi në individualizimin dhe identifikimin e tyre.

Gjithashtu, mënyra se si këto akte janë protokolluar (*regjistruar në regjistrin e korrespondencës*) nuk është në përputhje me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në mbështetje të nenit 15, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "*Për arkivat*".

Ky përfundim arrihet për faktin se, kjo rregullore përcakton qartë rregullat bazë për organizimin, funksionimin dhe punën në arkivat në veprim të subjekteve shtetërore. Konkretisht, në pikën 1, të nenit 19, të kësaj rregulloreje, ndër të tjera, përcaktohet se *të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror evidencohen në regjistrin e korrespondencës. Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror. Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Nuk lejohet evidencimi në një numër i dy ose më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre, sipas objektit.*

Organizimi i burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes:

Njësia administrative objekt mbikëqyrje, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 41, dt. 12.12.2014 të Këshillit të Komunës Vaqarr, "*Mbi strukturën organizative, numrin e personelit dhe nivelin e pagës të punonjësve të komunës për vitin 2015*".

Në mbështetje të këtij vendimi ka dalë urdhri nr. 1, datë 05.01.2015 i drejtuesit të komunës "*Për emërimin e punonjësve të administratës së Komunës Vaqarr për vitin 2015*", me të cilin ka miratuar strukturën analitike të administratës dhe emrat e punonjësve për çdo pozicion pune.

Në këtë proces, vihet re se, struktura dhe organika e vitit 2015, ka rikonfirmuar numrin e përgjithshëm të vendeve të punës dhe mënyrën e organizimit të tyre sipas strukturës dhe organikës së miratuar për vitin 2014. Pra, në momentin e mbikëqyrjes, numri i pozicioneve të punës dhe mënyra e organizimit të tyre i krahasuar me numrin e pozicioneve të punës dhe mënyrën e organizimit të tyre në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, (*të cilin e kemi prezantuar në fillim të materialit*) nuk ka pësuar asnjë ndryshim.

Në këto kushte, konkludohet se, në momentin e mbikëqyrjes njësia e mbikëqyrur kishte 37 pozicione pune, ku 25 prej tyre ishin pozicione të shërbimit civil.

Konstatim:

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, u konstatua se, **1** vend pune, për “*Specialist i Mirëmbajtjes së Rrjetit të Ujësjellësit*” ishte i plotësuar nga punonjës me kontratë pune, periudha e punësimit fillon pas hyrjes në fuqi të ligjit 152/2013. Bëhet fjalë për punonjës in *****”, i punësuar me kontratën nr. 17 prot, dt. 05.01.2015. (*Kontrata e punësimit si dhe të dhënat individuale janë pasqyruar në anekset bashkëlidhur raportit*).

Në këto kushte, në projektraport është konstatuar se, plotësimi i pozicionit të punës për “*Specialist i Mirëmbajtjes së Rrjetit të Ujësjellësit*”, është bërë në kundërshtim me ligjin, për pasojë punonjësit të emëruar në këtë pozicion, duhet t’i revokohet akti i emërimit, pasi për çdo marrëdhënie të re pune, në pozicione që janë pjesë e shërbimit civil, e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm. Pozicioni i punës të konstatohet i lirë dhe të plotësohet në përputhje me kërkesat ligjore.

Aktualisht, rezulton se, punonjësi ***** është transferuar pranë Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizimeve sh.a., njësi në varësi të Bashkisë së Tiranës, e cila nuk është pjesë e shërbimit civil.

Bazuar në gjithë sa sipër, konstatohet se institucioni i mbikëqyrur i ka marrë masat për rivendosjen e ligjshmërisë në këtë rast.

10. Komuna Kashar, aktualisht Njësia Administrative Kashar

Subjekti është përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në këtë moment, kjo njësi e qeverisjes vendore, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me vendimin nr. 7, dt. 24.01.2013, të Këshillit të Komunës “*Për miratimin e strukturës organizative dhe rregulloren bazë të administratës, nivelin e pagave të administratës dhe punonjësve të tjerë të Komunës Kashar*”. Në mbështetje të këtij vendimi, ka dalë urdhri nr. 5, datë 21.02.2013 i drejtuesit të komunës “*Për strukturën organizative të administratës dhe punonjësve të tjerë të Komunës Kashar*”, me të cilin ka miratuar strukturën analitike të administratës dhe emrat e punonjësve për çdo pozicion pune. Me këtë urdhër, strukturës organizative të komunës i është shtuar një njësi me emërtesën “*Ndërmarrja e Shërbimeve Publike*”/“*Zyra e Shërbimeve*”, të cilës i janë miratuar 6 punonjës. (*Kjo strukturë ka qenë në fuqi deri në miratimin e strukturës për vitin 2014 sipas vendimit nr. 16, dt. 10.04.2014 të këshillit të komunës, vendim i cili ka hyrë në fuqi 10 ditë pas shpalljes*).

Nga verifikimi i këtyre akteve rezulton se kjo njësi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit (në dt. 26.02.2014), kishte gjithsej **78** pozicione pune, nga të cilat, **51** pozicione pune kryejnë funksione të shërbimit civil.

(*Ndërsa 27 pozicione pune nuk janë pjesë e shërbimit civil. Këto pozicione janë: 5 pozicione pune që kryejnë funksione politike (1 kryetar; 1 zv/kryetar; 1 sekretar organizativ dhe këshilltar i*

kryetarit; 2 sekretar i këshillit të komunës); 7 pozicione pune që kryejnë funksione administrative (1 arkëtar; 1 sekretare; 5 ndihmësa (shofer, sanitare, posta); 8 pozicione pune i përkasin Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik; 5 pozicione pune kryejnë funksione të policisë komunare dhe kontrollit të territorit; 2 pozicione pune janë të Zyrës së Gjendjes Civile (funksione të deleguara).

Konstatohet se, **51 pozicionet e shërbimit** civil janë të kategorisë ekzekutive, dhe kanë të njëjtën kategori page, *III-b*. Këto pozicione përfshijnë pozicionet me emërtesën “Përgjegjës Zyre” (9 pozicione pune); “Specialist” (30 pozicione pune); “Inspektor” (5 pozicione pune) “Jurist” 4 pozicione pune; “Audit i brendshëm ” 1 pozicion pune; “Protokoll” + personel 1 pozicion pune; “Arkiv” + magazinë 1 pozicion pune.

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së punonjësve për periudhën 01-28 shkurt 2014 rezulton se 45 pozicione të shërbimit civil kanë qenë të plotësuara ndërsa, 6 pozicione ishin vende të lira. Më konkretisht, vende të lira kanë qenë:

- 1 vend për “Jurist për Menaxhimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, në Zyrën juridike;
- 1 vend për “Specialist në Zyrën e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit”;
- 1 vend për “Specialist në Zyrën e shërbimit me një ndalesë”;
- 1 vend për “Specialist në Zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pyjeve, veprave ujore dhe asetëve bujqësore”;
- 1 vend për “Inspektor Ushqimi”, në Zyrën e shërbimit dhe inspektoriatit veterinar dhe ushqimit;
- 1 vend për “Specialist operator zyre”, në Zyrën e promovimit të projekteve.

Në zbatim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 e 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kreut III, pika 2 e 7 të vendimit nr. 116, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse ka proceduar si më poshtë:

Së pari, njësia përgjegjëse e institucionit të mbikëqyrur ka evidentuar punonjësit, që në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil.

Bazuar në strukturën organizative, që ishte në fuqi në muajin shkurt 2014, si dhe listëprezencën dhe listëpagesën e punonjësve për muajin shkurt 2014, konstatohet se:

- Njësia përgjegjëse ka konsideruar si pjesë të shërbimit civil edhe njësinë organizative me emërtesën “Zyra e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik”.
- Njësia përgjegjëse nuk ka konsideruar si pjesë të shërbimit civil 2 pozicione pune (1 pozicion pune me emërtesën “Protokoll” + personel dhe 1 pozicion pune me emërtesën “Arkiv”+magazinë).

Së dyti, njësia përgjegjëse ka verifikuar periudhën e punësimit në të njëjtin vend pune, (nëse periudha e punësimit ishte më shumë se një vit apo më pak se një vit) si dhe plotësimin e kriterit të nivelit të arsimit (nëse punonjësit e punësuar në pozicione të konsideruara pjesë e shërbimit civil e kishin ose jo diplomën e arsimit të lartë sipas ligjit për arsimin e lartë).

Në datën 25.09.2014, njësia përgjegjëse ka përfunduar procesin e verifikimit, rast pas rasti, të kriterit të punësimit në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se një vit apo më pak se një vit dhe ka konkluduar si më poshtë:

- **33** punonjës, janë deklaruar me statusin “Nëpunës civil”, (aktualisht 6 prej tyre janë larguar);
- **1** punonjës, është deklaruar me statusin “Nëpunës civil në periudhë prove”, (bëhet fjalë për ***** i cili me vendimin nr. 31, dt. 03.03.2014 është emëruar në pozicionin “Inspektor Ushqimi” në Zyrën e shërbimit dhe inspektoriatit veterinar).
- **1** punonjësi, i është shtyrë deklarimi i statusit të punësimit me kushtin që, brenda një afati 2 vjeçar, të plotësojë kriterin e diplomës së arsimit të lartë, (bëhet fjalë për *****).
- **Në 6** raste, punonjësve nuk iu është deklaruar statusi i punësimit për mosplotësim të kriterit arsimor, (në këtë rast punonjësit kanë rezultuar me arsim të mesëm).
- **Në 5** raste, punonjësit nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, (bëhet fjalë për 1 punonjës të punësuar në pozicionin “Protokoll” + personel, 1 punonjës të punësuar në “Arkiv” + magazinë dhe 3 punonjës të larguar, bëhet fjalë për punonjësit ***** , ***** dhe *****).

Për të arritur në një konkluzion të saktë, nëse njësia përgjegjëse e institucionit i ka kryer procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe brenda afatit të përcaktuar, u verifikuan dhe analizuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet e shërbimit civil, si struktura dhe organika e institucionit që ishte në fuqi në dt. 26.02.2014, listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve për muajin shkurt 2014; dosjet individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (aktet e emërimit si dhe të dhënat lidhur me nivelin e arsimit) si dhe plotësimi i kriterëve për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

a) Punonjës ekzistues të deklaruar “Nëpunës civil” për shkak të ligjit.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për **33** punonjësit e deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil” vërejmë se:

- Për **32** punonjës të deklaruar me statusin “Nëpunës civil”, procedurat e deklarimit të statusit të punësimit janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në këtë grup përfshihen “punonjës ekzistues”, të cilët në dt. 26.02.2014, ishin të punësuar në vende pune, të konsideruar pjesë e shërbimit civil, për një periudhë më shumë se një vit.

Për **1** punonjës, njësia përgjegjëse, në procedurat e ndjekura për deklarimin e statusit të punësimit, nuk ka respektuar kërkesat e ligjit dhe konkretisht bëhet fjalë për punonjësen ***** , me aktin nr. 2099, dt. 25.09.2014, është deklaruar “Nëpunës civil” në pozicionin “Specialist”, në Zyrën e Teknologjisë së Informacionit dhe Shërbimit me një Ndalesë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen individuale të kësaj punonjëseje, u konstatua se, me vendimin nr. 108, dt. 27.03.2013 të titullarit të institucionit, ajo është emëruar në detyrën “Specialist”, pranë Zyrës së Shërbimit me një Ndalesë. Pra, në datën 26.02.2014,

periudha e punësimit për këtë punonjëse ishte më pak se një vit. Për këtë arsye, deklarimi i statusit të punësimit, duhet të ishte “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.

Për këtë arsye me qëllim që të rregullohet situata në këtë rast, në projektraport njësia përgjegjëse është rekomanduar që të kryejë veprimet e mëposhtme:

- Të revokojë aktin nr. 2099, dt. 25.09.2014, për deklarimin e statusit të punësimit si “*Nëpunës civil*” për punonjësen *****, dhe të deklarojë statusin e saj të punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.
- Njësia e burimeve njerëzore si njësia përgjegjëse, të kujdeset për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji për nëpunësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), caktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori pas përfundimit të periudhës së provës dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.

Në vazhdim të mbikëqyrjes pranë këtij institucioni, në momentin e hartimit të raportit përfundimtar konstatohet se, punonjësja ***** me aktin nr. 25070/1 prot., dt. 16.08.2016, në kuadër të ristrukturimit, është transferuar në pozicionin “*Specialist në Zyrën e Informimit*”, Sektori i Shërbimeve Publike, në Njësinë Administrative Kashar, duke u trajtuar nga komisioni i ristrukturimit si nëpunës civil.

Konstatim: Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes nga 33 punonjës të deklaruar me statusin “*Nëpunës civil*”, 26 prej tyre vazhdojnë marrëdhënien e punës me njësinë e mbikëqyrur, ndërsa 6 prej tyre janë larguar me transferim dhe dorëheqje.

(Aktet e deklarimit të statusit për 26 punonjësit që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punës me njësinë e mbikëqyrur si dhe të dhënat individuale lidhur me kohëzgjatjen e punësimit në të njëjtin vend pune dhe plotësimin e kushteve për të qenë nëpunës civil sipas ligjit janë të materializuara si anekse më vete në Aneksi nr. 1 dhe Aneksi nr. 2 të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti. Konstatimet për 6 nëpunësit e larguar janë trajtuar si pikë e veçantë në vijim të këtij materiali).

b) Punonjës ekzistues të deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove” për shkak të ligjit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se,

- Vetëm në një rast, 1 punonjës është deklaruar me statusin “*Nëpunës civil në periudhë prove*”.

Në këtë rast, bëhet fjalë për punonjësin ***** i cili me aktin nr. 2107, dt. 25.09.2014 është deklaruar “*Nëpunës civil në periudhë prove*” në pozicionin “*Inspektor Ushqimi*”, në Zyrën e shërbimit veterinar, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Nga këqyrja e akteve konstatohet se, pozicioni “*Inspektor Ushqimi*”, në Zyrën e shërbimit veterinar, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka qenë vend i lirë, por, pas hyrjes në fuqi të ligjit, në këtë pozicion është emëruar punonjësi ***** me vendimin nr. 31, datë 03.03.2014, të drejtuesit të institucionit.

Në lidhje me këtë rast në projektraport është konstatuar se akti nr. 31, datë 03.03.2014 që ka lidhje me momentin e emërimit të punonjësit ***** ka dalë në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë duhet të revokohet, pasi për pozicionet e shërbimit civil, për çdo marrëdhënie pune e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Ndërkohë, nisur nga observacionet që ka dërguar institucioni, si dhe materialet shkresore bashkëlidhur, në momentin e hartimit të këtij raporti rezulton se punonjësi ***** ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me institucionin në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së re, fakt i cili provohet me urdhrin nr. 7002, dt. 02.03.2016, të drejtuesit të Bashkisë Tiranë.

Punonjës të cilëve nuk i është deklaruar statusi i punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, për 7 punonjës, që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk e ka deklaruar statusin e punësimit, për shkaqet si më poshtë:

- Në 1 rast, punonjësiti i është shtyrë deklarimi i statusit të punësimit me kushtin që, brenda një afati 2 vjeçar, të plotësojë kriterin e diplomës së arsimit të lartë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen individuale të punonjësiti, ***** u konstatua se, me vendimin nr. 15, dt. 06.02.2014 të titullarit të institucionit, ai është emëruar në detyrën, “Specialist në Zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pyjeve, veprave ujore dhe aseteve bujqësore”. Pra, në dt. 26.02.2014 ky punonjës ishte i punësuar në një pozicion pune të konsideruar pjesë e shërbimit civil. Kohëzgjatja e periudhës së punësimit në këtë pozicion ishte më pak se 1 vit, por në lidhje me kriterin e nivelit të arsimit të lartë rezulton se ai ka paraqitur vërtetimin nr. 1893 prot., dt. 09.12.2011 të Universitetit Politeknik Tiranë, Inxhinieria e Ndërtimit, me të cilin vërtetohet se është student diploman pranë këtij fakulteti, në degën “Gjeodezi”. Në këto kushte njësia përgjegjëse me shkresën nr. 2153/1, dt. 01.10.2014, ka njoftuar punonjësin në fjalë, që brenda një afati 2 vjeçar, të plotësojë kushtin e diplomës së arsimit të lartë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion vërehet se, konstatimi i njësisë përgjegjëse lidhur me nivelin e arsimit, që ka punonjësi, përputhet me dokumentet e përfshira në dosjen e personelit.

Në rastin e punonjësiti ***** njësia përgjegjëse i është referuar pikës 6/1, kreu III, të vendimit nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në mënyrë më konkrete kjo pikë përcakton: “Punonjësiti e institucioneve të varësisë, pjesë e administratës shtetërore, të cilët bëhen pjesë e shërbimit civil, si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe që në momentin e deklarimit të statusit nuk plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, të pozicionit të punës ku janë emëruar, të vazhdojnë të punojnë në pozicionet ku janë të emëruar, me kushtin

që, brenda një afati 2-vjeçar, t'i plotësojnë këto kushte". Pra, subjekt i këtij rregullimi janë punonjësit e institucioneve të varësisë, pjesë e administratës shtetërore.

Për punonjësin në fjalë, njësia përgjegjëse duhet të zbatonte përcaktimet e pikës 7, të vendimit si më sipër, pikë e cila rregullon rastin e komunave. Në paragrafin e dytë të kësaj pike, përcaktohet se: *"Në rastin kur punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës"*.

Bazuar në faktet e përmendura më sipër, arrihet në përfundimin se, punonjësi *****; bazuar në dokumentet që përmban dosja personale, nuk e plotëson kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë. Plotësimi i kërkesave lidhur me nivelin dhe profilin e arsimit, për pozicionin e punës në të cilin një punonjës është i emëruar, është përfshirë në listën e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar .

Për këtë arsye, që të rregullohet situata e paligjshmërisë, në projektraport është rekomanduar njësia e burimeve njerëzore, që të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punës për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, ai nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civilë për shkak të nivelit arsimor (*ky punonjës nuk zotëron një diplomë sipas legjislacionit të arsimit të lartë*), dhe pozicioni i punës të shpallet i lirë për t'u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Në përgjigje të këtyre rekomandimeve, sipas observacioneve të dërguara nga institucioni dhe akteve administrative bashëlidhur me të, rezulton se, njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës, me urdhrin nr. 33477, dt. 03.11.2016, ka vendosur revokimin e aktit nr. 15, dt. 06.02.2014, për emërimin e punonjësit *****; në pozicionin *"Specialist në Zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pyjeve, veprave ujore dhe asetëve bujqësore"*, pranë Komunës Kashar si dhe revokimin e aktit nr. 4512/3, dt. 10.02.2016 *"Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit"*, për shkak se emërimi në një pozicion të shërbimit civil është bërë në kundërshtim me procedurat e pranimit në shërbimin civil. Në këto rrethana, është rivendosur edhe gjendja e ligjshmërisë në lidhje me këtë rast.

- Për 6 punonjës, të cilët fillimi i efekteve juridike të ligjit, i gjeti të punësuar në pozicione të shërbimit civil, institucioni nuk ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit, për shkak se nuk plotësonin kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë (*ky grup punonjësish kanë rezultuar me arsim të mesëm*).

Këta punonjës janë:

- 1) *****; me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën, *"Specialist në Zyrën e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit"*, i cili ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 09.01.2015.
- 2) *****; me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën *"Specialist për Kontabilizim të ardhurash dhe ndjekje debitorësh"* në Zyrën e Tatim Taksave, i cili ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 31.12.2014.
- 3) *****; me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën *"Inspektor i kontrollit në terren"* në Zyrën e Tatim Taksave, i cili ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 31.12.2014.

- 4) *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën, “*Specialist në Zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pyjeve, veprave ujore dhe aseteve bujqësore*”, i cili ka përfunduar marrëdhëniet e punës në fund të vitit 2014.
- 5) *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën, “*Specialist në Zyrën e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pyjeve, veprave ujore dhe aseteve bujqësore*”, i cili ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 30.11.2014.
- 6) *****, me arsim të mesëm, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “*Specialist Koordinator Projektsh*” në Zyrën e promovimit të projekteve, i cili ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 22.09.2015.

Konkluzion: Vlerësojmë se, njësia e burimeve njerëzore, në nxjerrjen e akteve të njoftimit, për mosplotësimin e kriterëve për të qenë nëpunës civil dhe më pas, të akteve përkatëse për përfundimin e marrëdhënieve të punës, për këtë grup punonjësish, ka vepruar në mbështetje të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, neni 21, shkronja “e” dhe vendimit nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pika 7 e cila përcakton se “*Në rastin kur punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës”.

c) Punonjës që nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në 5 raste, punonjës të cilët në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit ishin të punësuar në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Më konkretisht këto raste, janë si më poshtë:

Për **dy** punonjës njësia përgjegjëse, ka patur perceptimin se, pozicionet e punës ku ata janë të punësuar nuk konsiderohen pjesë e shërbimit civil. Bëhet fjalë për 1 punonjës të punësuar në pozicionin “*Protokoll*”, Lumturi Çausi, aktualisht ka dalë në pension, 1 punonjës të punësuar në “*Arkiv*”, ku ka qenë e punësuar punonjësja *****.

Aktualisht, njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës, ka informuar Komisionerin, përmes observacioneve të dërguara në këtë rast, për faktin se me kontratën nr. 5765/1, dt. 22.02.2016, punonjësja *****, është emëruar për një periudhë pa afat në pozicionin “*Arkivist-Protokollist*”, në Njësinë Administrative Kashar.

Ky rast do të zgjidhet sipas orientimeve që janë dhënë më sipër, në lidhje me këtë pozicion pune në njësitë administrative.

- 3 punonjës nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, pasi kanë përfunduar marrëdhëniet e punës, për shkaqet e parashikuara nga neni 65, i ligjit.

Këta punonjës janë:

- ✓ *****, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën, “Specialist në Zyrën e Shërbimeve”, ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 22.05.2014, për shkak se ka dalë në KEMP.
- ✓ *****, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën, “Specialist në Zyrën e Shërbimeve”, ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 10.09.2014, për shkak se ka dalë në Kemp.
- ✓ *****, në dt. 26.02.2014 kryente detyrën, “Specialist në Zyrën e Shërbimeve”, ka përfunduar marrëdhëniet e punës në dt. 18.02.2015, pasi ka dalë në pension.

Konkluzion: Vlerësojmë se, përfundimi i marrëdhënieve të punës për këtë grup punonjësish, është bërë për arsye të pranisë së shkaqeve të parashikuara nga neni 65, shkronja “c” dhe 66, shkronja “e” të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konstatim: Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes nga 32 punonjës të deklaruar me statusin “Nëpunës civil”, 6 prej tyre janë larguar me transferim/dorëheqje.

Tabelë:

Nëpunës civil të larguar me transferim/dorëheqje:

Nr.	Emër/Mbiemër Pozicionit i punës që mbante në dt. 26.02.2014	Akti i fillimit të marrëdhënieve të punës, nr./dt.	Akti i deklarimit të statusit, nr./dt.	Akti i largimit nr./ dt.	Shkaku i ndërprerjes së marrëdhënies të punës
1	*****/ Specialist i prokurimeve publike, Zyra Juridike	Akti nr. 2905, dt. 04.11.2008	Akti nr.2092, dt. 25.09.2014	Akti nr. 2571/4, dt. 01.10.2015	Akti nr. 12139/1, dt. 22.09.2015 i Bashkisë Tiranë transferohet në Bashkinë Vorë.
2	*****/ Specialist infrastrukture rrugore, Zyra e Punëve Publike	Akti nr. 2982 , dt. 25.09.2009	Akti nr. 2080, dt. 25.09.2014	Akti nr. 2607/3, dt. 22.09.2015	Akti nr. 12139/1, dt. 22.09.2015 i Bashkisë Tiranë transferohet në Bashkinë Pogradec.
3	*****/ Jurist, Zyra e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit	Akti nr. 1143, dt. 03.05.2007	Akti nr.2091, dt. 25.09.2014	Akti nr. 1810, dt. 05.06.2015	Lirohet nga detyra me kërkesën e saj.
4	*****/Përgjegjës Zyre IT, Zyra e Administratës	Akti nr.1187, dt. 31.05.2012	Akti nr. 2103, dt. 25.09.2014	Akti nr. 2583, dt. 08.09.2015	Lirohet nga detyra me kërkesën e tij
5	*****/Përgjegjës Zyre, Zyra e Shërbimeve	Akti nr. 2448, dt. 18.09.2008	Akti nr.2106, dt. 25.09.2014	Akti nr. 2850, dt. 20.10.2015	Lirohet nga detyra me kërkesën e tij
6	*****/ Specialist në Zyrën e Teknologjisë së Informacionit dhe Shërbimit me një Ndalesë	Sipas librezës së punës fillon në dt.01.04.2006, si “Specialist” informatike	Akti nr. 2102, dt. 25.09.2014	Akti nr. 15506/1, dt. 23.10.2015	Lirohet nga detyra me me kërkesën e saj

Vlerësojmë se, në këtë rast, njësia e burimeve njerëzore, ka vepruar në mbështetje të kërkesave të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku parashikohet dorëheqja si institut i ligjit, duke respektuar procedurat ligjore.

Organizimi i burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se njësitë administrative të Bashkisë së Tiranës (*ish komunat*) në fillim të çdo viti kalendarik/viti financiar, kanë miratuar strukture të re organizative për administratën dhe punonjësit e tyre.

Njësia administrative objekt mbikëqyrje, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 59, dt. 20.12.2014 të këshillit komunal, “Për miratimin e strukturës organizative, nivelin e pagave të administratës dhe punonjësve të tjerë të Komunës Kashar”.

Në këtë proces, vihet re se, me strukturën dhe organikën e vitit 2015 numri i përgjithshëm i punonjësve të administratës është pakësuar me 10 punonjës (*ishin 78 punonjës dhe në momentin e verifikimit janë 68 punonjës të administratës*).

Në këto kushte, konkludohet se, në momentin e verifikimit njësia e mbikëqyrur ka **53** pozicione të shërbimit civil, nga të cilët:

- 7 pozicione të shërbimit civil, janë plotësuar sipas procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Vendet e punës të plotësuara sipas procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë si më poshtë:

Tabelë: Pozicione pune të plotësuara nëpërmjet procedurës së konkurrimit

Nr.	Emërtesa e pozicionit të punës	Punonjësi emër/mbiemër	Data e fillimit të marrëdhënieve financiare	Procedura e ndjekur për marrjen në punë
1	Specialist për taksat vendore për familjarët	*****	Dt. 20.02.2015	Konkurrim sipas ligjit nr. 152/2013
2	Specialist për taksat vendore për familjarët	*****	Dt. 20.02.2015	Konkurrim sipas ligjit nr. 152/2013
3	Specialist për taksat vendore për familjarët	*****	Dt. 23.02.2015	Konkurrim sipas ligjit nr. 152/2013
4	Specialist për taksat vendore për familjarët	*****	Dt. 20.02.2015	Konkurrim sipas ligjit nr. 152/2013
5	Specialist/Zyra e Çështjeve Sociale, Ndhmës Ekonomike dhe Punësimit	*****	Dt. 09.01.2015	Konkurrim sipas ligjit nr. 152/2013
6	Specialist Koordinator Projektesh	*****	Dt. 18.06.2015	Konkurrim sipas ligjit nr. 152/2013
7	Specialist/Zyra e			Konkurrim sipas

	Teknologjisë së Informacionit dhe Shërbimit me një Ndalesë	*****	Dt. 09.03.2015	ligjit nr. 152/2013
--	--	-------	----------------	---------------------

- *3 pozicione të shërbimit civil*, mbahen nga punonjës të sistemuar në kundërshtim me procedurat e ligjit për nëpunësin civil.

Më konkretisht, këta nëpunës janë:

- ✓ *****, me vendimin nr. 73, dt. 02.06.2015, është emëruar në pozicionin “*Arkivist*”, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, kryente detyrën “*Operator i arkivës teknike*”, pozicion pune ky, që nuk përfshihet në shërbimin civil.
- ✓ *****, me vendimin nr. 60, dt. 09.06.2014, është emëruar “*Specialist Ujësjiellësi*”, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, kryente detyrën “*Inspektor*” në Zyrën e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik, pozicion pune ky, që nuk përfshihet në shërbimin civil.
- ✓ *****, me vendimin nr. 92, dt. 12.09.2014 është emëruar “*Specialist për mirëmbajtjen e rrugëve dhe kanalizimeve*”. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, kryente detyrën “*Inspektor*” në Zyrën e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik, pozicion pune ky, që nuk përfshihet në shërbimin civil.

Konkluzion: Vërejmë se, plotësimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, si më sipër, është bërë në kundërshtim me ligjin. Në kushte të tilla, në projektraport është rekomanduar njësia përgjegjëse që, për punonjësit ***** dhe ***** të revokohen aktet e emërimit, pasi për çdo marrëdhënie të re pune në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm. Pozicionet e punës të konstatohen të lira dhe të plotësohen në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndërkohë, nisur nga observacionet e institucionit dhe akteve bashkëlidhur tij, rezulton se:

- ✓ Punonjësi *****, me aktin nr. 4441, dt. 10.02.2016, është liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Nga përmbajtja e këtij akti rezulton se, si bazë ligjore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës është përmendur neni 50, pika 6, e 7 dhe neni 66, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dispozita të cilat parashikojnë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit.

Konstatohet se, në këtë rast, njësia përgjegjëse e institucionit ka zbatuar gabim ligjin në lidhje me motivacionin e përdorur për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, pasi duhet të ishte argumentuar ndërprerja e marrëdhënies së punës për shkak të emërimit në kundërshtim me procedurat konkurruese të pranimit, të parashikuara nga ligji dhe jo ristrukturimi i institucionit.

- ✓ Punonjësja *****, për të cilën me urdhrin nr. 33478, dt. 03.11.2016, është vendosur revokimi i urdhrin nr. 60, dt. 09.06.2014, për emërimin e saj, në pozicionin e punës “*Specialist Ujësjiellësi*”, pranë Komunës Kashar, si dhe revokimin e aktit nr.4512/1, dt. 10.02.2016 “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, për

shkak se emërimi në një pozicion të shërbimit civil, është bërë në kundërshtim me procedurat e pranimit në shërbimin civil.

- ✓ Punonjësi *****, me urdhrin nr. 6644, dt. 29.02.2016, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, për shkelje të rregullave të etikës gjatë ushtrimit të detyrës.

Bazuar në gjithë sa sipër, në këtë rast, njësia përgjegjëse ka vepruar, rrethanat kanë ndryshuar dhe nuk ekzistojnë shkeljet e evidentuara në projekt raport.

11. Komuna Pezë, aktualisht Njësia Administrative Pezë

Komuna Pezë, aktualisht Njësia Administrative Pezë, është një subjekt i përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të këtij ligji, kjo njësi e qeverisjes vendore, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me vendimin nr. 3, datë 24.01.2014 të këshillit të komunës “Për miratimin e strukturën organike të administratës për vitin 2014”.

Bazuar në këtë strukturë organizative, Njësia Administrative Pezë, në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit (në dt.26.02.2014) kishte 61 pozicione pune, të organizuara në këtë mënyrë:

- 22 pozicione pune konsiderohen pozicione të shërbimit civil.
- ✓ 39 pozicione pune klasifikohen si pozicione ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për shërbimin civil. (Në këtë grupim përfshihen 3 pozicione pune që kryejnë funksione politike; 2 pozicione pune që kryejnë funksione administrative si arkëtar dhe magazinier; 3 pozicione pune i përkasin Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Vendor; 1 pozicion pune Zyra e policisë, 1 pozicion pune Ambulanca Varosh; 5 pozicione pune punonjës të tjerë; 9 pozicione pune punonjës ujësjellësi; 15 pozicione pune punonjës për shërbime, rrugë, menaxhim).

Konstatohet se, 22 pozicionet e shërbimit civil, përfshijnë pozicionet me emërtesën “Drejtor i Drejtorisë së Financës” (1 pozicion pune); “Përgjegjës Zyre” (8 pozicione pune); “Specialist” (5 pozicione pune); “Inspektor” (5 pozicione pune); “Jurist” + Përgjegjës Administrate (1 pozicion pune); “Arkitekt ” (1 pozicion pune); “Veteriner” (1 pozicion pune).

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së punonjësve për periudhën 01-28 shkurt 2014, rezulton se nga 22 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, që kishte struktura në fuqi, 19 prej tyre ishin të plotësuar, ndërsa 3 pozicione pune ishin vende të lira.

Më konkretisht, vende pune të lira ishin:

- 1 vend, për “Përgjegjës në Zyrën e Urbanistikës”;
- 1 vend, për “Përgjegjës në Zyrën e Shërbimeve”;
- 1 vend, për “Inspektor Pyjor”;

Njësia përgjegjëse e institucionit, ka kryer verifikimet lidhur me periudhën e punësimit në të njëjtin vend pune, (nëse periudha e punësimit ishte më shumë se një vit apo më pak se një vit), si dhe, plotësimin e kriterit të nivelit të diplomës së arsimit të lartë.

Pas kryerjes së këtyre verifikimeve në datën 31.03.2014, njësia përgjegjëse ka lëshuar aktet e deklarimit të statusit të punësimit duke vendosur:

- 7 punonjës, të deklarohen me statusin e punësimit “Nëpunës civil”.
- 2 punonjës, të deklarohen me statusin “Nëpunës civil në periudhë prove” (një punonjës i përfshirë në këtë grup e ka filluar marrëdhënien e punësimit me vendin e punës pas hyrjes në fuqi të ligjit).
- 5 punonjësve, nuk iu është deklaruar statusi i punësimit, për arsye se, nuk plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionet e punës ku ata janë të punësuar (niveli më i lartë i arsimit të tyre është i mesëm).
- Në 5 raste, punonjësit nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, (në këtë grup përfshihen 1 punonjës me detyrë “Specialist Finance”, i punësuar si person me aftësi të kufizuar dhe 4 punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me njësinë e mbikëqyrur, raste të cilat janë trajtuar në mënyrë më të detajuar në vijim të materialit).

Për të arritur në një konkluzion të saktë, nëse njësia përgjegjëse e institucionit i ka kryer procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit u verifikuan dhe analizuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si struktura dhe organika e institucionit që ishte në fuqi në dt. 26.02.2014, listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve për muajin shkurt 2014; dosjet individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (aktet e emërimit, të dhënat lidhur me nivelin e arsimit) si dhe, plotësimi i kriterëve për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

a) Punonjës ekzistues të deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil”

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, për 7 punonjësit e deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil”, vërejmë se:

- Për 7 punonjës të deklaruar me statusin “Nëpunës civil”, procedura e deklarimit të statusit të punësimit është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Këta punonjës, në dt. 26.02.2014, ishin të punësuar në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil; periudha e punësimit në të njëjtin pozicion pune ishte më e madhe se një vit dhe plotësojnë kriterin e nivelit të arsimit të lartë. (Në momentin e mbikëqyrjes, u konstatua se, punonjësi Ketjana Shaphasa, deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil” (me aktin nr. 248/11, dt. 31.03.2014), ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në dt. 23.04.2014 dhe punonjësi Albert Bulku deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil” (me aktin nr. 248/6, dt. 31.03.2014), ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në dt. 01.10.2015 me urdhër të titullarit të bashkisë).

b) Punonjës ekzistues të deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove” për shkak të ligjit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, nga 2 punonjës të deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil në periudhë”, në 1 rast, procedurat e deklarimit të statusit të punësimit janë kryer

në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Bëhet fjalë për punonjësin:

*****, me detyrë “Arkitekt”, e punësuar me urdhrin nr. 4, dt. 03.02.2014. Periudha e punësimit më pak se një vit.

Konkluzion:

- Procedura e deklarimit të statusit të punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”, për këtë punonjëse, është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Njësia e burimeve njerëzore si njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji për nëpunësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASP), caktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori pas përfundimit të periudhës së provës dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.

Sipas observacioneve të institucionit, lidhur me këtë rast, si dhe akteve bashkëlidhur tÿj, Komisioneri informohet për masat e marra në përgjigje të rekomandimeve të lëna në projektraport.

Më konkretisht rezulton se, për punonjësen *****, janë kryer detyrimet e periudhës së provës siç janë trajnimi i detyrueshëm në ASPA, vlerësuar me 21/26 pikë, është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën e provës, vlerësuar në nivelin “Mirë” (2), dhe me vendimin nr. 594/2, dt. 14.07.2016, të eprorit direkt, është konfirmuar si nëpunës civil.

Ndërkohë, konstatohet se në 1 rast, njësia e burimeve njerëzore nuk ka respektuar kërkesat e ligjit, konkretisht bëhet fjalë për punonjësin *****, i cili me aktin nr. 248/7 prot., dt. 31.03.2014, i është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin “Përgjegjës në Zyrën e Shërbimeve”.

Nga verifikimi i listëpagesës së muajit shkurt 2014 konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, pozicioni i punës “Përgjegjës në Zyrën e Shërbimeve”, ka qenë vend i lirë. Punonjësi *****, i ka filluar marrëdhëniet e punës me këtë pozicion në dt. 03.03.2014. Mbështetur në përcaktimet e pikës 3 dhe 4 të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ky punonjës nuk mund të konsiderohet “punonjës ekzistues”. (Punonjësi U. Bala, me urdhrin nr. 1432, dt. 01.10.2015 të titullarit të bashkisë, aktualisht ka ndërprerë marrëdhëniet e punës).

c) Punonjës të cilëve nuk i është deklaruar statusi i punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, për 5 punonjës, që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk e ka deklaruar statusin e punësimit. Në këtë grup përfshihen punonjës që nuk plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë (nivele më i lartë i arsimit të këtyre punonjësve është arsimit i mesëm).

Në mënyrë më të detajuar, këta punonjës paraqiten si më poshtë:

- 1) *****, me arsim të mesëm, e cila në dt. 26.02.2014, kryente detyrën “*Specialist finance*”. Marrëdhëniet e punës me këtë pozicion pune i vazhdojnë edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.
- 2) *****, me arsim të mesëm; e cila në dt. 26.02.2014, kryente detyrën “*Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave*”. Marrëdhëniet e punës me këtë pozicion pune i vazhdojnë edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.
- 3) *****, me arsim të mesëm; i cili në dt. 26.02.2014, kryente detyrën “*Specialist në Zyrën e Bujqësisë*”. Marrëdhëniet e punës me këtë pozicion pune i vazhdojnë edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.
- 4) *****, me arsim të mesëm; i cili në dt. 26.02.2014, kryente detyrën “*Inspektor Pyjor*” (*Specialist*) në Inspektoriatin Pyjor. Marrëdhëniet e punësimit me këtë pozicion pune i vazhdojnë edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.
- 5) *****, me arsim të mesëm; i cili në dt. 26.02.2014, kryente detyrën “*Inspektor Taksash*” (*toke*) në Zyrën e Taksave. Ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në dt. 01.10.2015, me urdhër të titullarit të bashkisë.

Punonjësit *****, *****, ***** dhe *****, janë me arsim të mesëm, e për këtë arsye nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Plotësimi i kërkesave lidhur me nivelin dhe profilin e arsimit, për pozicionin përkatës, është parashikuar nga neni 21, shkronja “e” të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar si një prej kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.

Më tej, vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në pikën 7 përcakton se “Në rastin kur punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës”.*

Në këtë rast, konstatohet se, për punonjësit që arsimit i mesëm është niveli më i lartë i arsimimit të tyre, dhe kanë vijuar të punojnë në pozicione të shërbimit civil edhe pas fillimit të efekteve juridike të ligjit, njësia përgjegjëse, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi për këta punonjës duhet të kishte vendosur përfundimin e marrëdhënies së punës.

Për këtë arsye, që të rregullohet situata e paligjshmërisë, në projektraport është rekomanduar njësia e burimeve njerëzore, që të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punës për këta punonjës, duke evidentuar faktin se, ata nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civil për shkak të nivelit arsimor (*janë me arsim të mesëm*) dhe pozicionet e punës të shpallen të lira për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Në vazhdim të mbikëqyrjes pranë Bashkisë së Tiranës, në momentin e përgatitjes së raportit përfundimtar rezulton se punonjësit:

- ✓ *****, me aktin nr. 3255/6, dt. 01.02.2016 i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare për mosplotësim të kriterit të nivelit të arsimit për vendin e punës.
- ✓ *****, me urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016 të drejtuesit të bashkisë është transferuar në pozicionin “*Inspektor Taksash*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave

dhe Tarifave Vendore, instituon në varësi të Bashkisë së Tiranës i cili nuk është pjesë e shërbimit civil.

- ✓ ***** , me aktin nr. 3255/7, dt. 01.02.2016 i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së re të institucionit.
- ✓ ***** , me aktin nr. 927/1, dt. 18.01.2016 i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me kërkesë të tij.

Në këto kushte, rrethanat kanë ndryshuar pas veprimit të njësisë përgjegjëse dhe nuk evidentohen akte të kundërligjshme.

d) Punonjës që nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, **në 5 raste** punonjës të cilët në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit ishin të punësuar në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Në këtë grup përfshihen 4 punonjës të cilët kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me njësinë e mbikëqyrur dhe 1 punonjës i punësuar si person me aftësi të kufizuar.

Më konkretisht këto raste janë si më poshtë:

- *Punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me njësinë e mbikëqyrur.*

- ✓ ***** , në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “Drejtor i Drejtorisë së Financës”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në dt. 16.12.2014, me anë të dorëheqjes.
- ✓ ***** , në dt. 26.02.2014, kryente detyrën “Inspektor Taksash” (troje) në Zyrën e Taksave. Ka ndërprerë marrëdhëniet e punës, në kuadër të miratimit të organikës për vitin 2015.
- ✓ ***** , në dt. 26.02.2014, kryente detyrën “Specialist në Zyrën e Ndhmës Ekonomike”. Ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në dt. 01.09.2014 me anë të dorëheqjes.
- ✓ ***** , në dt. 26.02.2014 kryente detyrën “Veteriner në Zyrën e Veterinarisë”. Ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në dt. 01.10.2015, me urdhër të titullarit të bashkisë.

- *Punonjës i punësuar si person me aftësi të kufizuar.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, në pozicionin “Specialist finance”, është punësuar si person me aftësi të kufizuar, punonjësi *****. Punësimi në këtë pozicion është bërë, me kontratën e punës datë 03.06.2013, niveli i arsimimit të tij është i mesëm.

Arsimi i lartë, vërtetuar me diplomë të lëshuar nga universiteti përkatës, është përcaktuar si kërkesë ligjore nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si kërkesë minimale për t’u punësuar në një pozicion pune të shërbimit civil.

Punonjësi në fjalë, është me arsim të mesëm, e për këtë arsye ai nuk mund të punësohet në pozicionin “Specialist finance”, pasi nuk plotëson kriterin e arsimit të lartë, të përcaktuar si kërkesë minimale për një pozicion të shërbimit civil.

Për këtë arsye, në projektraport është rekomanduar njësia përgjegjëse që, për punonjësinnen *****; të përfundojnë marrëdhëniet e punës në pozicionin “*Specialist finance*”, dhe të shikohet mundësia e sistemimit të tij, në një pozicion tjetër jashtë shërbimit civil.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, me urdhrin nr. 6726, dt. 29.02.2016, nëpunësit në fjalë i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare për mosplotësim të kriterit të nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionin e punës ku ai ishte i emëruar.

- ***Organizimi i burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes***

Njësia administrative objekt mbikëqyrje, në momentin e kryerjes së verifikimit funksiononte në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 3, dt. 27.01.2015 të Këshillit të Komunës Pezë, “*Për miratimin e strukturës organike të administratës për vitin 2015*”. Struktura dhe organika e vitit 2014 kishte 61 pozicione pune gjithsej nga të cilët 22 konsiderohen pjesë e shërbimit civil, ndërsa struktura dhe organika e vitit 2015, ka miratuar 58 vende pune gjithsej + 1 pozicion gjendja civile funksion i deleguar.

Në këtë proces, vihet re se, pozicione të shërbimit civil nga 22 që kishte struktura e vitit 2014, në strukturën e vitit 2015 janë miratuar 19 pozicione të shërbimit civil, (në këtë mënyrë janë shkurtuar 3 pozicione të shërbimit civil). Pozicionet e shërbimit civil kanë emërtesën “*Përgjegjës Zyre*” (4 pozicione); “*Specialist*” (7 pozicione); “*Inspektor*” (4 pozicione); me emërtesën e profesionit “*Jurist*”, “*Arkitekt*”, “*Veteriner*” (3 pozicione) dhe 1 pozicion kryen disa funksione “*Sekretari – Arkivë - Protokoll*”.

Në momentin e verifikimit, njësia e mbikëqyrur ka 19 pozicione të shërbimit civil, ku 1 pozicion (pozicioni “*Përgjegjës në Zyrën e Financës*”), është plotësuar nga punonjës me kontratë pune, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013. Bëhet fjalë për punonjësinnen *****; punësuar me kontratën e punës dt. 19.01.2015.

Plotësimi i pozicionit të punës “*Përgjegjës në Zyrën e Financës*” është bërë në kundërshtim me ligjin, për pasojë punonjësines së emëruar në këtë pozicion, duhet t’i revokohet akti i emërimit, pasi për çdo marrëdhënie të re pune në pozicione që janë pjesë e shërbimit civil, e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm. Pozicioni i punës të shpallet i lirë dhe të plotësohet në përputhje me kërkesat ligjore.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, me urdhrin nr. 2841, dt. 22.09.2016, për punonjësinnen *****; është vendosur revokimi i kontratës së punës si dhe revokimi i aktit nr. 10359/1, dt.06.04.2016 “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, për shkak se emërimi në një pozicion të shërbimit civil është bërë në kundërshtim me procedurat e pranimit në shërbimin civil.

12. Komuna Ndroq, aktualisht Njësia Administrative Ndroq

Komuna Ndroq, aktualisht Njësia Administrative Ndroq, është një subjekt i përfshirë për herë të parë në fushën e veprimtimit të shërbimit civil, me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Kjo njësi e qeverisjes vendore, në këtë moment, ka qenë e organizuar në bazë të strukturës dhe organigramës së miratuar me vendimin nr. 7, datë

28.02.2014 të këshillit të komunës “Mbi miratimin e organikës së punonjësve të Komunës Ndroq”. Në pikën 3 të këtij vendimi është përcaktuar se efektet financiare fillojnë nga data 01.01.2014.

Bazuar në këtë strukturë dhe organigramë, njësia objekt mbikëqyrje, në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit (në dt. 26.02.2014) kishte 26 pozicione pune, të organizuara në këtë mënyrë:

- **18** pozicione pune janë pozicione të shërbimit civil.
- ✓ **8** pozicione pune klasifikohen si pozicione, ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për shërbimin civil. (Në këtë grupim përfshihen 3 pozicione pune, që kryejnë funksione politike; 2 pozicione pune, që kryejnë funksionet e policisë ndërtimore; 1 pozicion pune, që kryen funksione administrative (shofer); 2 pozicione pune, punonjës policie).

Konstatohet se, 18 pozicionet e shërbimit civil, përfshijnë pozicionet me emërtesën “Përgjegjës Zyre” (5 pozicione pune); “Specialist” (7 pozicione pune); “Jurist” (1 pozicion pune); “Administrator i ndihmës ekonomike” (1 pozicion pune); “Inspektor veterinar” (1 pozicion pune); 3 pozicione pune kryejnë më shumë se një funksion (pozicionin e punës “Sekretare + Arkiviste”, pozicionin e punës “Specialist i zyrës së shërbimeve” + arka dhe pozicionin e punës “Specialist i zyrës së ndihmës ekonomike” +magazina.

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së aparatit të njësisë, për periudhën **01-28 shkurt 2014**, rezulton se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, të gjitha vendet e punës që kryenin funksione të shërbimit civil (18 vende pune) ishin të plotësuara.

Njësia përgjegjëse e institucionit, ka kryer verifikimet lidhur me, periudhën e punësimit nëse ishte më shumë se një vit apo më pak se një vit, si dhe, plotësimin e kriterit të nivelit të diplomës së arsimit të lartë.

Pas kryerjes së këtyre verifikimeve në datën 24.04.2015, njësia përgjegjëse, ka lëshuar aktet e deklaramit të statusit të punësimit duke vendosur:

- **10** punonjës, të deklarohen me statusin e punësimit “Nëpunës civil”.
- **1** punonjës, të deklarohet me statusin “Nëpunës civil në periudhë prove” (bëhet fjalë për punonjës *****, me detyrë “Inspektor Veterinar”, i punësuar në këtë pozicion në dt. 08.01.2014).
- Për **4** punonjës, që në dt. 26.02.2014, kryenin funksione të shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk i ka përfunduar procedurat e deklaramit të statusit të punësimit. Për këtë grup punonjësish procedura ka nisur dhe ka mbetur në fazën e verifikimit.
- Në **3** raste punonjësit nuk janë përfshirë në procedurat e deklaramit të statusit të punësimit, (bëhet fjalë për 1 punonjës të punësuar në pozicionin “Sekretare dhe Arkiviste”, në këtë rast pozicioni i punës nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil; 2 punonjës të tjerë janë larguar para se të kryeshin procedurat e deklaramit të statusit të punësimit (bëhet fjalë për *****, “Specialist në Zyrën e Tatim-Taksave” larguar me dorëheqje dhe Ilir Skilja, “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”, ka dalë në pension).

Për të arritur në një konkluzion të saktë, nëse njësia përgjegjëse e institucionit i ka kryer procedurat e deklaramit të statusit të punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe brenda

afatit të përcaktuar, u verifikuan dhe analizuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si struktura dhe organika e institucionit që ishte në fuqi në dt. 26.02.2014, listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve për muajin shkurt 2014; dosja individuale e çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (*aktet e emërimit dhe të dhënat lidhur me nivelin e arsimit*), si dhe plotësimi i kriterëve për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

a) Punonjës ekzistues të deklaruar “Nëpunës civil” për shkak të ligjit

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për 10 punonjësit e deklaruar me statusin e punësimit “Nëpunës civil” vëmë re se, në dt. 26.02.2014, ata ishin të punësuar në pozicione pune, të konsideruara pjesë e shërbimit civil; periudha e punësimit në të njëjtin pozicion pune ishte më shumë se një vit dhe se ata e plotësojnë kriterin e nivelit të arsimit të lartë.

Në këto rrethana, arrijmë në **konkluzionin** se:

- Për 10 punonjës të deklaruar me statusin “Nëpunës civil”, procedura e deklarimit të statusit të punësimit, është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar .
- Në 1 rast, (për punonjësen *****, “Specialist i Zyrës së Financës”, deklaruar me statusin “Nëpunës civil”, me aktin nr. 23, dt. 24.04.2015), u konstatua se, në dosjen e personelit të saj nuk është përfshirë diploma e shkollës së lartë. Për këtë arsye në projektraport është rekomanduar njësia përgjegjëse që:
 - Të administrojë kopjen e diplomës së arsimit të lartë që zotëron punonjësja bashkë me listën e notave. Dokumentet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara nga noteri dhe të bëhen pjesë përbërëse e dosjes së personelit.
 - Një kopje e dokumenteve të konstatuara në mungesë t’i dërgohen Komisionerit bashkë me observacionet përkatëse, me qëllim që Komisioneri të arrijë në konkluzione sa më të sakta për këtë punonjëse.

Aktualisht, në momentin e hartimit të raportit përfundimtar, konstatohet se punonjësja ***** me urdhrin nr. 1802/1, dt. 05.02.2016, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me anë të dorëheqjes, e për këtë arsye, dosja e personelit duhet të plotësohet vetëm për efekt dokumentacioni.

b) Punonjës ekzistues të deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove” për shkak të ligjit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se vetëm 1 punonjës është deklaruar me statusin “Nëpunës civil në periudhë prove” dhe bëhet fjalë për punonjësin *****, i cili me aktin nr. 30, dt. 24.04.2015, është deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Inspektor Veterinar”.

Nga dokumentacioni i administruar në dosjen individuale të këtij punonjësi, u konstatua se, ai është punësuar në këtë pozicion me urdhrin nr. 4, dt. 08.01.2014. Pra, ka qenë i punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më pak se 1 vit. Ka përfunduar arsimin e lartë, në Institutin e

Lartë Bujqësor, Fakulteti i Veterinarisë. Rezulton se nuk janë kryer detyrimet që rrjedhin gjatë kryerjes së periudhës së provës.

Në këto rrethana, në projekt raport është materializuar **konkluzioni** se :

- Procedura e deklarimit të statusit të punësimin “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, për punonjësin *****, është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Njësia e burimeve njerëzore si njësia përgjegjëse, duhet të kujdeset për të zbatuar të gjitha kërkesat që parashikon ligji për nëpunësit në periudhë prove, duke përfshirë përfundimin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), caktimin e një punonjësi më të vjetër për t’u kujdesur, si dhe vlerësimin e punës nga eprori pas përfundimit të periudhës së provës dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin ose jo në këtë pozicion.

Ndërkohë, gjatë procesit të mbikëqyrjes në këtë institucion, në momentin e hartimit të raportit përfundimtar, kanë ndryshuar rrethanat dhe konstatohet se punonjësi *****, me urdhrin nr.6684, dt. 29.02.2016, në kuadër të miratimit të strukturës së re, i është zgjidhur kontrata e punës.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse e institucionit ka zbatuar gabim ligjin, pasi punonjësi në fjalë ishte nëpunës civil në periudhë prove dhe në pamundësi të sistemimit të tij në kuadër të ristrukturimit, duhet të ishin zbatuar përcaktimet e nenit 50, pika 6 e 7 dhe neni 66 pika 1.a/1 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Por, nga ana tjetër, aktualisht, rezulton se ky punonjës, me aktin nr. 18841 prot., dt. 10.06.2016, pasi i është nënshtruar procedurave të konkurrimit, është emëruar në pozicionin “*Specialist për Shërbimet Publike në Sektorin e Shërbimeve Publike*”, në Njësinë Administrative Ndroq, në periudhë prove dhe gëzon të drejtat e nëpunësit civil.

(*Aktet e deklarimit të statusit “nëpunës civil”/“nëpunës civil në periudhë prove”, për 11 rastet si më sipër, si dhe, të dhënat individuale lidhur me kohëzgjatjen e punësimit dhe plotësimin e kushteve për të qenë nëpunës civil sipas ligjit, janë të materializuara si anekse më vete në Aneksi nr. 1 dhe Aneksi nr. 2 të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti*).

c) Punonjës për të cilët nuk është deklaruar statusi i punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, për 4 punonjës që në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, procedura e deklarimit të statusit të punësimit nuk është përfunduar, (procedura ka nisur por ka mbetur në fazën e verifikimit). Për secilin nga këta punonjës, njësia përgjegjëse ka plotësuar aktin e verifikimit dhe ka bërë shënimin: “Mospërfitim statusi”, pozicioni i punës nuk përputhet me arsimin e punonjësit. Verifikimi i dokumenteve të përfshira në dosjen e personelit të secilit punonjës është bërë në prill të vitit 2015.

Në mënyrë më të detajuar, këta punonjës paraqiten si më poshtë:

- ✓ *****, në dt. 26.02.2014 ishte i punësuar në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*” + *magaznier*, periudha e punësimit në këtë pozicion që nga dt. 02.05.2013. Në dt. 06.08.2014, ka kaluar në pozicionin “*Specialist i Zyrës së Tatim Taksave*”, ky është pozicioni i punës që mban në momentin e mbikëqyrjes. Ka diplomë të arsimit të lartë në Fakultetin e Shkencave Natyrore, DNP në Kimi Ushqimore dhe “*Master i Shkencave*” në Kimi Industriale dhe Mjedisore.
- ✓ *****, ka filluar në këtë njësi si “*Përgjegjës i Zyrës së Bujqësisë*”. Nga dt. 01.06.2012 deri në dt. 06.08.2014 ka kryer detyrën “*Specialist në Zyrën e Tatim Taksave*”, këtë pozicion pune mbante në dt. 26.02.2014. Me urdhrin nr. 40, dt. 06.08.2014 ka kaluar në detyrën “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*” + *magaznier*, ky është pozicioni i punës që mban edhe në momentin e mbikëqyrjes. Ka diplomë të arsimit të lartë në Institutin e Lartë Bujqësor, Dega Agronomi e Përgjithshme.
- ✓ *****, në dt. 26.02.2014 ishte i punësuar në pozicionin “*Specialist i Zyrës së Bujqësisë*”, periudha e punësimit në këtë pozicion, që nga dt. 12.07.2011, ky është pozicioni i punës që mban edhe në momentin e mbikëqyrjes. Ka diplomën e arsimit të lartë në UPT, DIND, në Fakultetin e Gjeologji Minerave.
- ✓ *****, në dt. 26.02.2014 ishte i punësuar në pozicionin “*Specialist i Zyrës së Urbanistikës*”, periudha e punësimit në këtë pozicion që nga dt. 01.03.2012, ky është pozicioni i punës që mban edhe në momentin e mbikëqyrjes. Ka diplomën e arsimit të lartë në UPT, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, dega Energjetikë.

Në momentin e hartimit të projektraportit, në lidhje me këtë rast, është arritur në konkluzionin se:

- Procedura e deklarimit për këta punonjës ka mbetur në fazën e verifikimit, pasi njësia e personelit vetëm ka konstatuar se këta punonjës nuk plotësojnë kriteret e veçanta. Shkresa që materializon verifikimin e kryer, është nënshkruar vetëm nga punonjësi i burimeve njerëzore. Më tej nuk ka një vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës.
- Në rastin e punonjësve në fjalë, njësia përgjegjëse, kishte detyrimin që t'i kryente procedurat sipas radhës, procedura të cilat fillojnë me evidentimin e pozicioneve që kryejnë funksione të shërbimit civil, hartimin e përshkrimeve të punës për çdo pozicion apo grup pozicionesh dhe pastaj të verifikonte përputhshmërinë e të dhënave individuale të punonjësit me kërkesat e veçanta të vendit të punës. Nëse pas kësaj, do të rezultonte se punonjësit nuk i plotësonin kërkesat e posaçme të vendit përkatës, atëherë të procedohej me ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Për këto arsye, në projektraport është rekomanduar njësia përgjegjëse që, për punonjësit *****, ***** dhe ***** të hartohen përshkrimet e punës, për pozicionet e shërbimit civil ku ata janë të emëruar dhe pas kësaj, të vendosë nëse këta punonjës, i

plotësojnë ose jo kriteret për të qenë nëpunës civilë sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Ndërkohë, me rrethanat e reja të krijuara gjatë periudhës që institucionit i është lënë kohë për observacione, rezulton se për punonjësit:

- ✓ ******, me urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016, është transferuar në pozicionin “*Specialist Taksash*”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, institucion varësie i Bashkisë së Tiranës, i cili nuk është pjesë e shërbimit civil.
- ✓ ******, me urdhrin nr. 33174, dt. 01.11.2016 të njësisë përgjegjëse, për mosplotësim të kërkesave të veçanta të vendit të punës, është vendosur revokimi i aktit nr. 40, dt.06.08.2014, për emërimin në pozicionin “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*” dhe magazinier, revokimi i aktit nr. 4513/8, dt. 10.02.2016, për transferimin në pozicionin “*Specialist i Përkrahjes Sociale*” në Zyrën e Shërbimeve Sociale, pranë Njesisë Administrative Ndroq dhe revokimi i aktit nr. 20396/1, dt. 06.07.2016, për deklarimin e statusit si nëpunës civil.
- ✓ ******, në momentin e përgatitjes së raportit përfundimtar, nga materialet shkresore bashkëlidhur sqarimeve të dërguara nga institucioni, vihet re se, me aktin nr. 6277, dt. 25.02.2016 “*Për lirim nga shërbimi civil*”, punonjësi në fjalë, është liruar nga shërbimi civil në momentin e ristrukturimit të institucionit.
- ✓ ******, me aktin nr. 4513/5, dt. 10.2.2016, në kuadër të ristrukturimit është transferuar në pozicionin “*Specialist për Infrastrukturën në Zyrën e Urbanistikës dhe Infrastrukturës në Sektorin e Shërbimeve Publike*”, në Njësine Administrative Ndroq. Më pas, nëpërmjet konkurrimit për ngritje në detyrë, me aktin nr. 17707, dt. 8.6.2016, është emëruar “*Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve Publike*” në Njësine Administrative Ndroq. Në këtë rast, punonjësi në fjalë është trajtuar si nëpunës civil.

Sa më sipër, rezulton se janë kryer veprimet e duhura për të rivendosur gjendjen e ligjshmërisë në këtë rast.

d) Punonjës që nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në 3 raste punonjësit nuk janë përfshirë në procedurat e deklarimit të statusit të punësimit dhe bëhet fjalë për këta punonjës:

- 1) ******, e punësuar në pozicionin “*Sekretare & Arkiviste*”, pozicioni i punës nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil.

Në lidhje me këtë rast, ashtu si është analizuar edhe më sipër, njësia përgjegjëse duhet të sqarojë rolin e këtij pozicioni në njësitë administrative, në raport me shërbimin civil, pasi veprimtarinë e mirëfilltë të Arkivës në këtë institucion, e mbulon pozicioni i punës në bashkinë qendër.

Nisur nga sqarimet e dërguara nga institucioni, në pikën 5 të tyre, rezulton se, në momentin e hartimit të raportit të mbikëqyrjes, punonjësja ******, me kontratën nr. 6735, dt. 29.02.2016, është emëruar për një afat të pacaktuar në pozicionin “*Arkivist-Protokoll*”, për arsye të situatës së sqaruar më sipër.

- 2) ******, “*Specialist i Zyrës së Tatim-Taksave*”, në dt. 02.06.2014, ka përfunduar marrëdhëniet e punës me dorëheqje.
- 3) ******, “*Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës*”, në dt. 05.05.2014, ka përfunduar marrëdhënien e punës, pasi ka mbushur moshën për pension.

Në rastin e dy punonjësve më sipër, vlerësojmë se, përfundimi i marrëdhënieve të punës për këtë grup punonjësish është bërë për shkaqe ligjore, të parashikuara nga neni 65, shkronja “c” dhe neni 66, shkronja “ë”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- **Organizimi i burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes**

Njësia administrative objekt mbikëqyrje, në momentin e kryerjes së verifikimit funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 8, dt. 26.01.2015 të Këshillit të Komunës Ndroq, “Mbi miratimin e organigramës së punonjësve të Komunës Ndroq për vitin 2015”.

Në këtë proces, vihet re se, struktura dhe organika e vitit 2015 ka rikonfirmuar numrin e përgjithshëm të vendeve të punës dhe mënyrën e organizimit të tyre sipas strukturës dhe organikës së miratuar për vitin 2014. Pra, në momentin e verifikimit, numri i pozicioneve të punës dhe mënyra e organizimit të tyre i krahasuar me numrin e pozicioneve të punës dhe mënyrën e organizimit të tyre në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, (të cilin e kemi prezantuar në fillim të materialit) nuk ka pësuar asnjë ndryshim.

Në këto kushte, në momentin e verifikimit, njësia e kontrolluar ka gjithsej **26** pozicione pune, nga të cilat, **18** prej tyre janë pozicione të shërbimit civil.

Në momentin e kryerjes së verifikimit në institucion, rezulton se në **2** raste, pozicione të shërbimit civil, janë të plotësuar nga punonjës me kontratë pune, të cilëve periudha e punësimit, i fillon pas fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil.

Bëhet fjalë për punonjësit:

- ✓ *****, me detyrë “Specialist i Zyrës së Tatim Taksave”, fillon marrëdhëniet e punës në këtë pozicion në dt.16.06.2014.
- ✓ *****, me detyrë “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”, fillon marrëdhëniet e punës në këtë pozicion në dt.03.11.2014.

Konkluzion: Vërejmë se, plotësimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, si më sipër, është bërë në kundërshtim me ligjin, për pasojë për punonjësit ***** dhe ***** , e për këtë arsye në projektraport, është rekomanduar njësia përgjegjëse që të revokojë aktet e emërimit, pasi për çdo marrëdhënie të re pune, në pozicione të shërbimit civil, e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore, nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm. Pozicionet e punës që konstatohen të lira duhet të plotësohen në përputhje me kërkesat ligjore.

Në përgjigje të institucionit, si dhe mbështetur në aktet ligjore që na janë dërguar, Komisioneri konstaton ndryshim të rrethanave të verifikuara më parë. Aktualisht, rezulton se punonjësit :

- ✓ ******, me urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016, është transferuar në pozicionin “*Specialist Taksash*”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, institucion varësie i Bashkisë së Tiranës, i cili nuk është pjesë e shërbimit civil.
- ✓ ******, me urdhrin nr. 33175/2, dt. 18.11.2016, është liruar nga detyra për arsye se emërimi në një pozicion të shërbimit civil është bërë në kundërshtim me procedurat e pranimit në shërbimin civil.

Aktualisht, ky punonjës, me aktin nr. 37999, dt. 12.12.2016 të njësisë përgjegjëse, nëpërmjet konkurrimit është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i Urbanistikës, Zyra e Urbanistikës dhe Infrastrukturës*” në Sektorin e Shërbimeve Publike, në Njësinë Administrative, Ndroq.

Në këto kushte, çmohet se, nga ana e institucionit, janë marrë masa për zbatimin e ligjshmërisë në këtë rast.

13. Komuna Zall-Herr, aktualisht Njësia Administrative Zall-Herr

Ky subjekt është përfshirë për herë të parë në fushën e veprimit të shërbimit civil, me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të këtij ligji, kjo njësi e qeverisjes vendore, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës të miratuar me vendimin nr. 3, dt. 28.01.2014 të Këshillit të Komunës “*Për miratimin e strukturës së aparatit të Komunës Zall-Herr për vitin 2014*”. Në mbështetje të këtij vendimi, ka dalë urdhri nr. 12, datë 03.02.2014, i drejtuesit të komunës, “*Për emërim në punë*”, me të cilin ka bërë emërimin e punonjësve për çdo pozicion pune të miratuar.

Mbështetur në këto akte rregullative, struktura organizative e Njësisë Administrative Zall-Herr, në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit (në dt.26.02.2014), kishte 27 pozicione pune, ku **19 prej tyre konsiderohen pjesë e shërbimit civil**.

Mënyra e organizimit të pozicioneve të punës paraqitet si më poshtë:

- **3** pozicione pune kryejnë funksione politike (*kryetar + zv/kryetar + sekretar këshilli*).
- **2** pozicione pune kryejnë funksionet e Inspektoriatit Ndërtimor Vendor.
- **2** pozicione shërbimesh (*polic i komunës dhe roje i komunës*).
- **1** pozicion pune i përket Zyrës së Gjendjes Civile (*funksion i deleguar*).
- **19** pozicione pune kryejnë funksione të shërbimit civil.

Konstatohet se, të gjitha pozicionet e shërbimit civil janë të kategorisë ekzekutive dhe paraqiten me emërtesën “*Përgjegjës Zyre/Shef Zyre*” (**8** pozicione pune); “*Specialist*” (**11** pozicione pune).

Vërejmë se, pozicionet e shërbimit civil nuk janë të ndara nga pozicionet e tjera të punës. Gjithashtu, emërtesat e pozicioneve të shërbimit civil nuk janë në përputhje me ligjin.

Në rastin e kësaj mbikëqyrje, janë verifikuar dhe këqyruar në subjekt akte të tilla si: urdhri i drejtuesit të komunës, me të cilin është miratuar emërimi i punonjësve sipas çdo pozicioni pune të miratuar; të gjitha materialet shkresore të përfshira në dosjet e personelit si dhe listëprezenca

dhe listëpagesa e punonjësve për muajin shkurt 2014. Nisur nga këto të dhëna rezulton se, në dt. 26.02.2014, të gjitha pozicionet e shërbimit ishin të plotësuar.

Mbështetur në këto të dhëna, si dhe nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se:

- Për **16** punonjës ekzistues, periudha e punësimit në pozicionin ku ata janë të emëruar, është më shumë se 1 vit.
- Për **3** punonjësit ekzistues, periudha e punësimit në pozicionin ku ata janë të emëruar, është më e vogël se 1 vit. Në këtë rast, bëhet fjalë për punonjësit e mëposhtëm:
 - ***** , emëruar në pozicionin e punës “*Specialist për Pyjet dhe Kullotat*”, me kontratën e dt.02.12.2013;
 - ***** , emëruar në pozicionin e punës “*Specialist për Prokurimet Publike*”, me kontratën e dt.03.02.2014;
 - ***** , emëruar në “*Zyrën e informacionit*”, me kontratën e datës 03.02.2014 .

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, njësia përgjegjëse, e Komunës Zall-Herr, e cila ka patur detyrë për t’u shprehur në lidhje me aktin e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësit e punësuar në pozicione të shërbimit civil, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt, ç’ka do të thotë se nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me realizimin e këtij procesi.

Në momentin e kryerjes së verifikimit konstatohet se:

- **5** punonjës, të cilët në dt. 26.02.2014 ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare. Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit:
 - ✓ ***** , “*Shef i Zyrës së Urbanistikës*”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me aktin nr. 63, dt.02.06.2014.
 - ✓ ***** , “*Specialist Urbanistike*”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës.
 - ✓ ***** , “*Shef i Zyrës Juridike*”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me aktin nr. 11314/1, dt.01.10.2015.
 - ✓ ***** , “*Zyra e Informacionit*”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me aktin nr. 128, dt.01.12.2014.
 - ✓ ***** , “*Specialiste taksash*”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të ligjit, të parashikuar në pikën 1/a të nenit 65 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Bazuar në faktet e përmendura si më sipër, për **14** punonjësit që fillimi i efekteve të ligjit i gjeti në pozicione të shërbimit civil, të cilët në momentin e verifikimit, vazhdonin marrëdhëniet e punës me institucionin, në projektraport i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse të Bashkisë së Tiranës, si më poshtë:

1. Të plotësojë dosjet individuale të punonjësve me të gjitha të dhënat, ashtu si parashikohet në nenin 17, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe vendimin

nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

2. Të kryejë verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë statusin e punësimit për secilin prej punonjësve të punësuar në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil.

Në përgjigjen e institucionit, në lidhje me këto raste, si dhe nga shkresat e dërguara si pjesë të observacioneve, rezulton se aktualisht punonjësit :

- ***** , me aktin nr. 4511/1, dt. 10.02.2016, në kuadër të ristrukturimit, është transferuar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”, në Njësinë Administrative Zall-Herr.
- ***** , me aktin nr. 4511/2, dt. 10.02.2016, është transferuar në pozicionin “Specialist Finance në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse”, në Njësinë Administrative Zall-Herr. Më tej, në përfundim të trajnimit të detyrueshëm në ASPA dhe pas kryerjes së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës, me aktin nr. 18661/2, dt.06.07.2016, punonjësja në fjalë është deklaruar nëpunës civil.
- ***** , me aktin nr. 4431, dt. 10.2.2016, është liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit, duke iu njohur edhe e drejta e dëmshpërblimit në këtë rast.
- ***** , aktualisht nuk është punonjës i njësisë së mbikëqyrur.
- ***** , me dëshirën e saj, sipas urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016, është transferuar në pozicionin “Përgjegjës Zyre Taksash”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore , subjekt që nuk përfshihet në shërbimin civil.
- ***** , me dëshirën e saj, me urdhrin nr. 3026, dt. 01.02.2016, është transferuar në pozicionin “Specialist Tatim Taksash”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore , subjekt që nuk përfshihet në shërbimin civil.
- ***** , me aktin nr. 4511/7, dt. 10.02.2016, në kuadër të ristrukturimit, është transferuar në pozicionin “Përgjegjës Zyre në Zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, në Sektorin e Shërbimeve Publike, në Njësinë Administrative Zall-Herr.
- ***** , me aktin nr. 4511/5, dt. 10.02.2016, në kuadër të ristrukturimit, është transferuar në pozicionin “Specialist për Infrastrukturën në Zyrën e Urbanistikës dhe Infrastrukturës”, në Sektorin e Shërbimeve Publike, në Njësinë Administrative Zall-Herr. Më tej, me aktin nr. 18661/3, dt. 06.07.2016, punonjësi në fjalë është deklaruar nëpunës civil.
- *****a, me aktin nr. 4511/8, dt. 10.02.2016, në kuadër të ristrukturimit, është transferuar në pozicionin “Specialist në Zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës”, në Sektorin e Shërbimeve Publike, në Njësinë Administrative Zall-Herr.
- ***** , me aktin nr. 4511/6, dt. 10.02.2016, në kuadër të ristrukturimit, është transferuar në pozicionin “Specialist i Përkrahjes Sociale në Zyrën e Shërbimeve Sociale”, në Sektorin e Shërbimeve Publike, në Njësinë Administrative Zall-Herr.
- ***** , me aktin nr. 4430, dt. 10.2.2016, është liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit, duke iu njohur edhe e drejta e dëmshpërblimit në këtë rast.
- ***** , me aktin nr. 4511/3, dt. 10.02.2016, në kuadër të ristrukturimit, është transferuar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve Publike”, në Njësinë Administrative Zall-Herr.

- ***** , me aktin nr. 4429, dt. 10.2.2016, është liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit, duke iu njohur edhe e drejta e dëmshpërblimit në këtë rast.
 - ***** , në momentin e hartimit të raportit të mbikëqyrjes, kryen detyrën “*Arkivist-Protokoll*”, të cilën njësia përgjegjëse e Bashkisë së Tiranës nuk e konsideron si pjesë të shërbimit civil dhe që në të ardhmen do të trajtohet sipas orientimeve që janë dhënë më lart, në këtë material.
- Mënyra e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil, në momentin e verifikimit

Në momentin e verifikimit, Komuna Zall-Herr, aktualisht Njësia Administrative Zall-Herr, funksiononte në bazë të strukturës së vitit 2015, të miratuar me vendimin nr. 12, datë 20.02.2015, të Këshillit të Komunës “*Mbi miratimin e strukturës së aparatit të Komunës Zall-Herr, për vitin 2015*”. Kjo strukturë, nuk ka sjellë ndryshime në numrin e pozicioneve të shërbimit civil.

Nga verifikimi i listëprezencës dhe listëpagesës së punonjësve në momentin e verifikimit, konstatohet se pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, institucioni i kontrolluar ka patur lirime nga detyra dhe emërimet e reja.

- Në **5** raste, punonjës të cilët në dt. 26.02.2014 ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare. Konkretisht bëhet fjalë për:
 - ✓ ***** , “*Shef i Zyrës së Urbanistikës*”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me aktin nr. 63, dt.02.06.2014.
 - ✓ ***** , “*Specialist Urbanistike*”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës.
 - ✓ ***** , “*Shef i Zyrës Juridike*”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me aktin nr. 11314/1, dt.01.10.2015.
 - ✓ ***** , “*Zyra e Informacionit*”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me aktin nr. 128, dt.01.12.2014.
 - ✓ ***** , “*Specialiste taksash*”, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të ligjit, të parashikuar në pikën 1/a të nenit 65 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Në 3 raste, janë kryer emërimet pas fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, pa u respektuar procedurat ligjore për pranimin në shërbimin civil.

Bëhet fjalë për punonjësit:

- ✓ ***** , “*Shef i Zyrës së Urbanistikës*”, emëruar me aktin nr. 63, dt.02.06.2014.
 - ✓ ***** , “*Specialist Urbanistike*”, emëruar me aktin nr. 1, dt. 05.01.2015.
 - ✓ ***** , “*Zyra e Informacionit*”, emëruar me aktin nr. 128, dt. 01.12.20014.
- 2 pozicione pune, rezultojnë vende të lira (pozicioni “*Specialist Taksash*” dhe pozicioni “*Shef i Zyrës Juridike*”).

Në këtë rast, në projektraport është arritur në **konkluzionin** se, aktet, që kanë lidhje me momentin e emërimit të këtyre punonjësve (***** , ***** dhe *****), kanë dalë në kundërshtim me ligjin dhe si të tillë duhet të revokohen, pasi për çdo marrëdhënie të re pune

në pozicione pjesë e shërbimit civil, e cila lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas nenit 22 e vijues të këtij ligji, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore nëpërmjet konkurrimit të hapur, apo duke respektuar sistemin e karrierës. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm. Pozicionet e punës që konstatohen të lira duhet të plotësohen në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndërkohë, nisur nga observacionet e dërguara nga institucioni, si dhe aktet administrative, pjesë e tij, konstatohet se kanë ndryshuar rrethanat, që nga momenti i verifikimit të akteve në subjekt. Aktualisht rezulton se punonjësit:

- ***** me aktin nr. 4428, dt. 10.2.2016, është liruar nga shërbimi civil në momentin e ristrukturimit të institucionit.
- ***** me aktin nr. 6732, dt. 29.02.2016, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare për arsye se emërimi në një pozicion të shërbimit civil është bërë në kundërshtim me procedurat e pranimit në shërbimin civil.
- ***** me aktin nr. 30107, dt. 10.10.2016, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare për arsye se emërimi në një pozicion të shërbimit civil është bërë nëkundërshtim me procedurat e pranimit në shërbimin civil.

Bazuar në faktet si më sipër, çmohet se, nga ana e institucionit, janë marrë masa për rivendosjen e ligjshmërisë.

*
* * *

Këto ishin rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin, Bashkia e Tiranës dhe ish komunat, aktualisht njësi administrative, në përbërje të saj (*Bashkia e Tiranës, Njësitë Administrative Petrelë, Farkë, Dajt, Zall-Bastar, Bërzhitë, Krrabë, Baldushk, Shëngjergj, Vaqarr, Kashar, Pezë, Ndroq dhe Zall-Herr*), në lidhje me zbatimin e ligjit gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në aspektin e deklarimit të statusit të punonjësve dhe nëpunësve aktualë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Aktet administrative që e dokumentojnë këtë proces, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat:

Aneksi nr. 1: “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar (data 26.02.2014)”.

Aneksi nr. 2: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”.

Njësia përgjegjëse dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri, në vendimin e paralajmërimit, brenda afatit të vendosur në vendim, për të rregulluar situatën e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur.

K O M I S I O N E R I

Pranvera STRAKOSHA